Integriteti dhe Kodi Etik	një (1) ditë	Stafin administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial	një (1) ditë	Stafin administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve	një (1) ditë	Stafin administrativ prokurorial	Trajnim	Akademia e Drejtësisë
Totali: 13	13 dite trajnimi			
TOTALI: 194 Aktivitete trajnuese me 214 Ditë (84 aktivitete trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë 76 për Bashkëpunëtorë Profesional, zyrtar Ligjor 21 për stafin administrativ të gjykatave dhe 13 për stafin administrative të prokurorive)				

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA
PENALE***

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese, 25 korrik 2024
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti i trajnuesve me rekomandime pas trajnimit

1. Tryezë diskutimi, për ndryshimet në legjislacionin penal (Prokuroria e Apelit dhe Prokuroritë Themelore)

Me dispozitat e reja të KPPK-ës respektivisht neni 84 dhe 156 tani të dëmtuarit si palë në procedurë kanë të drejtën e paraqitjes së ankesës ndaj vendimit të prokurorit të shtetit të shkallës së parë për hudhje të kallëzimit penal dhe pushimit të hetimit si dhe në rastet kur prokurori i shtetit nga shkalla e parë nuk e trajton rastin brenda afatit 6 mujor nga dita e paraqitjes së kallëzimit penal. E drejta e të dëmtuarit për të paraqitur ankesë në raste konkrete është një mbrojtje e rëndësishme për të siguruar që viktimat e një veprë penale të kenë një mjet për të sfiduar vendimet e prokurorive të shkallës së parë kur këto vendime nuk përputhen me pritshmëritë e tyre për drejtësi. Kjo e drejtë e mbështet viktimën në ruajtjen e balancës midis autoritetit të prokurorisë dhe kërkesës për drejtësi nga ana e të dëmtuarve. Kush ka të drejtë të parashtrimit të ankesës ndaj vendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal dhe pushimit të hetimit, Kush vendos për ankesën e të dëmtuarit, Afati për paraqitjen e ankesës dhe afatin për vendosje lidhur me ankesën. Përmbajtja e ankesës, vendimet e Prokurorisë së Apelit lidhur me ankesën, aspekti ligjor për mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Arsyeimi ligjor i vendimeve për hedhjen poshtë të kallëzimit penal dhe pushimin e hetimeve, Arsyeja dhe bazat ligjore për kthimin e lëndës në rivendosje nga Prokuroria e Apelit në ato Themelore dhe PSRK. Udhëzimet e Prokurorisë së Apelit me rastin e kthimit të lëndës në prokuroritë e shkallës së parë, Statusi i palës së dëmtuar, Kur konsiderohet lënda e kryer me rastin e apelimit të vendimit të prokurorive të shkallës së parë. Identifikimi i dilemave, diskutimit lidhur me sfidat e zbatimit të udhëzimeve të prokurorisë së apelit, analizën ligjore, shpërndarja e vendimeve nga raste praktike, rekomandimet.

Objektivat

- ⇒ Kuptojnë saktë të drejtat e viktimave në procedurë penale;
- ⇒ Baza ligjore për të drejtën në ankesë ndaj aktvendimit për hedhje poshtë të kallëzimit penal dhe pushimit të hetimit;
- ⇒ Procedura e ankesës në Prokurori.

Përmbajtja

- E drejta në ankesë e të dëmtuarit;
- Bazat ankimore;
- Vendimet e prokurorit të shtetit në raport me ankesën;
- Zbatimi i udhëzimeve të Prokurorisë së Apelit nga prokurorët e prokurorive të shkallës së parë.

Metodologjia

Diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës.

Përfituesit

Prokurorë, bashkëpunëtor profesionale, zyrtar ligjor, mbrojtësit e viktimave

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Formulari për vlerësim të nevojave për trajnime 2025, pas trajnimit
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme

2. Masat e fshehta hetimore, mundësia hetuese e veçantë, marrja në pyetje dhe marrja e deklaratës

Masat e fshehta hetimore përveç se trajtohen në kuptim të sigurimit të provave këto veprime procedurale po ashtu me rastin e zbatimit shpesh here mund të cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut si kategori e të drejtave kushtetuese, andaj me rastin e trajtimit do të synohet që të diskutohet për kushtet ligjore që përcaktohen si standard për lëshimin e tyre, a duhet në çdo rast të ndërmerren veprimet e tilla procedurale, kur mund të konsiderohen provat e tilla si prova të papranueshme, kur shërbejnë provat që sigurohen përmes këtyre masave edhe në raport me të dyshuar tjerë që nuk ka pasur nja procedure të filluar ndaj tyre. Po ashtu në kuadër të kësaj teme do të synohet sqarimi edhe për veprimet hetimore të mundësisë hetuese të veçantë që është nga veprimet procedurale që duhet përmbushur disa kushte duke qenë se veprimi i tillë nga njëra anë mundëson marrjen e provës dhe zbatimin e parimit të kontradiktoritetit mirëpo e njëjta vlerësohet në shqyrtim gjyqësor pa i dhënë mundësi të drejtpërdrejt gjyqtarit që ta ekzaminojë dëshmitarin. Në këtë kuadër të trajnimit po ashtu rolë të rëndësishëm do të zë edhe marrja në pyetje dhe marrja e deklaratës që për nga natyra janë prova që sigurohen në fazën e procedurës paraprake mirëpo nga vlera provuese dhe nga mënyra e përdorimit në shqyrtim gjyqësor kanë dallime thelbësore për tu përdorur dhe mbështetur te provuarit e fakteve.

Përdorimi i provave nga masat e fshehta nga një rast tjetër penal. Kohëzgjatja e urdhrave në rast të pamundësisë së marrjes së të dhënave për shkak të ndryshimit të mjetit që mbikëqyret me masat e fshehta. A lëshohet urdhri ndaj personit apo ndaj mjetit. Kur mund të lexohet marrja në pyetje apo deklarata në shqyrtim gjyqësor.

Qasja në adresimin e këtyre dilemave përmes pyetjeve dhe interpretimit të dispozitave si dhe aplikim nga rastet praktike, duke siguruar mos cenimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth zbatimit unik në interpretim dhe aplikim të dispozitave për masat e fshehta teknike të hetimit;
- ⇒ Të kuptojmë rastet se kur janë situatat e rëndësishme që duhet zbatuar marrja e deklaratës dhe jo marrja në pyetje;
- ⇒ Të kuptojmë vlerësimin e drejt të deklaratës që merret me mundësin hetuese të veçantë në shqyrtim gjyqësor.

Përmbajtja

- Llojet e masave të fshehta teknike të hetimit;
- Kompetenca për lëshimin e masave;
- Kushtet ligjore për lëshimin e masave;
- Panueshmëria e provave të siguruara përmes këtyre masave;
- Standardet ligjore dhe respektimi i të drejtave të njeriut;
- Kushtet e marrjes së deklaratës përmes mundësisë hetuese të veçantë dhe të provuarit e fakteve;
- Dallimet e marrjes në pyetje me marrjen e deklaratës, shmangia e parimit të drejtpërdrejt dhe vlerësimi për të provuarit e fakteve.

Metodologjia

Organizimi i trajnimit përmes prezantimit në PowerPoint, trajtimit të rasteve praktike, diskutimet mbi dilemat.

Përfituesit

Gjyqtarë, Prokurorë dhe Bashkëpunëtor Profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Rekomandim nga KGJK
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Formulari për vlerësim të nevojave për trajnime 2025, pas trajnimit

3. Roli i Gjykatës në kontrollin e ligjshmërisë së aktakuzës

Faza e ngritjes së aktakuzës është njëra ndër fazat me të rëndësishme në procedurën penale sipas KPPRK-se duke qene se në këtë fazë prokurori i shtetit i përfundon hetimet dhe ngritë aktakuze kur konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, pra konsiderohet se ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale, me obligimin që aktakuzën ta përpiloj në pajtim me dispozitat përkatëse të KPPRK-se. Në këtë fazë fillon edhe kontrolli i ligjshmërisë së aktakuzës nga Gjykata si në aspektin formalo juridik të përpilimit të aktakuzës po ashtu edhe në aspektin e besueshmërisë së ngritjes së aktakuzës, ashtu që Gjykata pas pranimit të aktakuzës, verifikon se a është përpiluar aktakuza në pajtim me KPPRK, me mundësinë që nëse nuk është në pajtim me dispozitat e KPPRK-se t'ia kthen prokurorit të shtetit për ta përmirësuar brenda afatit të caktuar nga gjykata, ndërsa nëse prokurori i shtetit nuk e respekton afatin, konsiderohet se ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe aktakuza konsiderohet e tërhequr. Pas vlerësimit të aktakuzës në aspektin formal Gjykata kalon në fazën shqyrtimit fillestare ku Gjykata mes tjerash vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo zbatuar masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit, siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave po ashtu informohet i pandehurin dhe avokatin mbrojtës që ata mund të paraqesin kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës, në rastet kur i pandehuri nuk e pranon fajësinë. Në këtë fazë asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë shqyrtimit fillestar, përveç nëse është e nevojshme për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit.

Çka nënkuptim plotësim i aktakuzës? Kthimi i aktakuzës në plotësim, kur mund të bëhet, A mund të kthehet aktakuza në plotësim lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale? A mundet të kthehet aktakuza për nxjerrjen e provës? Cilat vendime gjykata i merr nëse prokuroria në përgjigjeje e saj nuk e bën plotësimin e aktakuzës por shprehimisht thotë se qëndron pranë aktakuzës së ngritur?

Qasja në adresimin e këtyre dilemave bëhet përmes identifikimit të dilemave, analizës ligjore, trajtimi i rasteve praktike.

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë drejtë procedurën lidhur me kthimin e aktakuzës në plotësim;
- ⇒ Te marrin vendimit adekuate pas kthimit të aktakuzës në plotësim dhe përgjigjes eventuale të prokurorit;
- ⇒ Te marrin vendime adekuate lidhur me kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës.

Përmbajtja

- Ngritja e aktakuzës dhe përmbajtja e saj;
- Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës;
- Shqyrtimi Fillestar;
- Kundërshtimi i provave;
- Kërkesa për hedhjen e aktakuzës;
- Përgjigjet e Prokurorit të shtetit;
- Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve;
- Hedhja e Aktakuzës dhe Pushimi i Procedurës.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit përmban një kombinim metodash që synojnë prezantime nga trajnuesit, diskutim i rasteve studimore, diskutime të hapura dhe interaktive. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga:

- Rekomandim nga KGJK
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Formulari për vlerësim të nevojave për trajnime 2025, pas trajnimit
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime për gjyqtarë 2026
- Pyetësori për vlerësim të nevojave për trajnime për prokurorë 2026

4. Veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe krimi i organizuar me theks të veçantë të prokurimi publik

Veprat penale kundër detyrës zyrtare kanë si qëllim ruajtjen e integritetit të institucioneve dhe zyrtarëve që t'iu pamundësojnë atyre abuzimin me detyrën për qëllime të përfitimit. Në kuadër të kësaj teme fokus i veçantë duhet te jete shtjellimi i Keqpërdorimit kundër detyrës zyrtare, marrja e ryshfetit, konflikti i interesit, keqpërdorimi apo mashtrimi ne prokurimin publik, si këto vepra penale mund të kryhen në kuadër të formës së krimit të organizuar, dhe kur këto vepra penale kryhen përmes veprimeve që rrjedhin nga prokurimi publik ku e mira publike që cenohet është buxheti i vendit. Me rëndësi të veçantë do të trajtohet aspekti praktik i elementit subjektiv – mens rea, që duhet të trajtohet aspekti i standardeve që duhet ndërtuar për tu konsideruar se ekziston dashja dhe qëllimi, cilat janë aspektet rrethanore për tu provuar elementi i qëllimit dhe dashjes, a duhet te këtë dashje specifike apo është e mjaftueshme shfaqja e dashjes me moskujdesin e detyrave te tije ne përmbushje ku përmes moskujdesit mundëson përfitimin apo shkaktimin dëmit. Njëkohësisht duhet trajtuar konfliktin e interesit ku zyrtari publik përfshihet për qëllim të përfitimit në marrjen e vendimeve të caktuara cilat janë elementet dhe kur mund të konsiderohet se janë përmbushur elementet e figurës se veprës penale dhe kur trajtohet veprimi si aspekt i shkeljes administrative qe ne dukje reflekton se ka një konflikt te interesit por nuk përbën vepër penale. Cilat janë mënyrat qe këto vepra penale paraqiten edhe në kryerjen e krimit te organizuar si duhet te vërtetohet organizimi i grupit kriminal cilat janë elementet qe duhet te përmbushen për tu trajtuar se veprat kundër detyrës zyrtare janë kryer ne kuadër te grupit te organizuar kriminal. Kur këto vepra penale kryhen qe rrjedhin nga veprimet e procedurës se prokurimit publik cilat janë fazat e zhvillimit te prokurimit publik, cilat janë pikat kyçe ne faza e prokurimit publik qe duhet pasur kujdes vlerësimi se a janë shmangur dispozitat për te arritur kryerjen e një vepre te caktuar.

Standardet e dashjes dhe qëllimit dhe aspektet rrethanore për mbështetjen e elementeve subjektive. Sfidat e prokurimit publik dhe veprimet mashtruese e te fshehta qe bëhen ne faza te ndryshme për qëllim të kryerjes së veprës penale kundër detyrës zyrtare. Veprat penale kundër detyrës zyrtare që kryhen në kuadër të grupit të organizuar kriminal elementet e veçantë të veprës dhe elementet e veçantë te grupit që duhet provuar.

Qasja në adresimin e këtyre dilemave bëhet përmes diskutimeve dhe interpretimeve përmes rasteve te studimeve si dhe përmes përdorimit të rasteve praktike do të adresohen dilemat e tilla praktike.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth aspekteve rrethanore për elementin subjektiv të veprat penale kundër detyrës zyrtare;
- ⇒ Te kuptojnë format e kryerjes së këtyre veprave penale nga aspekti praktik dhe standardet e të provuarit të figurës së veprës penale;
- ⇒ Ndërlidhja e veprave penale kundër detyrës zyrtare me krimin e organizuar dhe lidhshmërinë e tyre në procesin e prokurimit publik.

Përmbajtja

- Personat zyrtarë dhe kategorizimi i tyre;
- Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar;
- Konflikti i interesit;
- Mashtrimi në prokurimin publik dhe procedurat në prokurimin publik;
- Marrja e ryshfetit;
- Elementet subjektive të këtyre veprave penale;
- Ndërlidhja e veprave penale kundër detyrës zyrtare me krimin e organizuar.

Metodologjia

Prezantim në PowerPoint, diskutime trajtim të rasteve hipotetike dhe trajtim nga praktika gjyqësore.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimit do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Rekomandim nga KGJK
- Agjenda Evropiane
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime për prokurorë 2026
- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- KE/ Projekti CYBERKOP

5. Krimi Kibernetik

Me zhvillimin e hovshëm dhe avancimeve të teknologjisë, me rritjen e përdorimit të internetit dhe teknikave të sofistikuara, lirisht mund të thuhet se gjendemi në një revolucion teknologjik, prandaj edhe krimi Kibernetikë është sfidë për shoqërinë e sotme.

Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe veçanërisht i internetit ka marrë një rëndësi të madhe në jetën e përditshme. Ky fenomen prek jo vetëm aktivitetet e një organizimi qoftë ai shtetëror apo privat, implikuar në sferën e biznesit apo të një aktiviteti jo fitimprurës, tani me prekë dhe njeriun e thjeshtë në aktivitetin e tij të përditshëm, në sferën e tij private dhe profesionale. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime por në të njëjtën kohë edhe një sërë sfidash e problemesh. Lufta kundër krimit kibernetikë është tepër sfiduese Për shkak të natyrës dinamike të zhvillimit të teknologjisë, aktivitetet ilegale të individëve të përfshirë në këto aktivitete kriminale ndryshon shpesh, duke i bërë më të vështirë për tu ndaluar. Hapësira kibernetike sot është një nga sfidat më të mëdha ligjore e cila ka nxitur një formë tjetër të krimit, duke krijuar një mjedis për metodat e reja të krimit, tani pothuajse të gjitha krimet mund të kryhen me përdorimin e rrjeteve dhe teknologjisë. Krimi kibernetikë është një fenomen që prek një sërë kompetencash, si ato në fushën e informatikës, energjetikës, kriminologjisë, ekonomisë, mjekësisë, drejtësisë si dhe shumë fusha tjera. Krimi kibernetikë përfshin veprat penale tradicionale (p.sh. mashtrimi, falsifikimi dhe thyerja e identitetit), veprat në lidhje me përmbajtjen (p.sh. shpërndarja në internet e pornografisë së fëmijëve apo nxitja e urrejtjes racore), si dhe veprat që janë unike për kompjuter dhe sisteme informative (p.sh. sulmet ndaj sistemeve informative, mohimi i shërbimit dhe mallrave).

Bazuar në zhvillimin e madh që ka teknologjia informative, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jenë të përgatitur për të gjykuar krimin kibernetikë dhe shqyrtuar provat elektronike. Po ashtu Kriptoalutat janë bërë një temë shumë e spikatur dhe e diskutueshme edhe në mesin e profesionistëve duke ngjallur shumë interesim posaçërisht për faktin se mediat vazhdojnë të merren me një numër të hetimeve dhe të ndjekjeve me profil të lartë në tërë botën. Ky trajnim ka për qëllim që t'i adresohet audiencës së agjencive për zbatimin e ligjit, prokurorëve dhe përfaqësuesve të Njesisë së Inteligjencës Financiare (NjIF) që janë të angazhuar në hetime financiare, ndjekje penale që përfshijnë krim ekonomik dhe rikuperimin e pasurive të paligjshme. Trajnimi do të eksplorojë dhe do të thellojë eksperiencën dhe ekspertizën e praktikuesve nga, zyrat e prokurorisë dhe NjIF në përcjelljen e rrjedhave të paligjshme financiare të kanalizuar përmes kriptoalutave. Qasja në adresimin e këtyre dilemave gjatë trajnimit do të bëhet përmes analizës ligjore lidhur me provat elektronike dhe provueshmëria e këtyre provave, trajtimi i rasteve praktike.

Objektivat

- ⇒ Zgjerojnë njohuritë për Krimin Kibernetikë sipas legjislacionit të brendshëm;
- ⇒ Identifikojnë fushën e krimit kibernetikë – tendencat dhe instrumentet;
- ⇒ Avancojnë njohuritë rreth teknologjisë të përfshirë në krimin kibernetik;
- ⇒ Zbatojnë drejtë legjislacionin, procedurat dhe praktika në lidhje me provat elektronike;
- ⇒ Ligji procedural/masat hetimore në legjislacionin e brendshëm;
- ⇒ Njohin Legjislacionin ndërkombëtar dhe Bashkëpunimin ndërkombëtar
- ⇒ Avancojnë njohuritë rreth Kriptovalutave.

Përmbajtja

- Njohurit lidhur me krimin kibernetikë;
- Konventa e Budapestit;
- Mbrojtja e informatave të klasifikuara për mbrojtjen e sigurisë shtetërore;
- Veprat penale lidhur me krimin kibernetikë;
- Provat elektronike në procedurë penale dhe pranueshmeria e tyre;
- Sigurimi dhe ruajtja e provave elektronike;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Sigurimi i provave ne rrjet (online);
- Sekuestrimi.

Metodologjia

Prezantim nga trajnuesit, diskutimi interaktiv, prezantimi i rasteve nga praktika gjyqësore e Kosovës rasteve studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ.

Përfituesit

Gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Formulari për VNT 2025 pas trajnimit
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Agjenda Evropiane
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026

6. Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e veprës penale të shpëlarjes së parave dhe hetimin financiar. Fokusi i veçantë do të jenë dispozitat e veprës penale të shpëlarjes së parave kur ajo para buron nga vepra konkrete penale apo kur paraja buron nga aktiviteti kriminal. Do të trajtohet konkretisht se në çka konsiston aktiviteti kriminal a duhet të ketë një ndërlidhje burimi i pasurisë me veprën konkrete apo fakti se ka qene i proceduar për ndonjë vepër dhe gjendet paraja ajo para duhet trajtuar si para që rrjedhë nga aktiviteti kriminal, si duhet provuar përmes aspektit rrethanor paraja nga aktiviteti kriminal dhe si duhet provuar në mënyrë të drejtpërdrejt paraja që rrjedhë nga vepra penale e cila pra është përdorur për tu shpërla. Cilat janë fazat e pastrimit të parave apo cikli që kalohet për pastrim, si duhet identifikuar pasuria që ka rezultuar nga shpëlarja e parave, çfarë metodash përdoren dhe janë të njohura në shpëlarjen e parave, si mundësohet shpëlarja e parave përmes kriptovalutave si duhet hetuar dhe gjurmuar kriptovalutat. Konfiskimi i pasurisë që buron nga shpëlarja e parave cilat janë standardet për konfiskim. Dilemat e burimit të pasurisë nga aktiviteti kriminal dhe mënyra e të provuarit? Si bëhet dallimi në pasurinë pa mbulesë të ligjshme dhe kur konsiderohet si pasuri që rrjedhë nga aktiviteti kriminal? Cilat janë metodat e pastrimit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar posaçërisht hetimi i kriptovalutave dhe mundësia e ngrirjes? Dilemat do të zgjidhen përmes diskutimeve dhe trajtimit të rasteve praktike për zbatimin e dispozitave ligjore duke bërë interpretimet e drejta sipas qëllimit të normave që janë në fuqi.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive për shpëlarjen e parave që rrjedhë nga vepra penale dhe nga aktiviteti kriminal dhe si duhet të provohet lidhmëria e asaj pasurie;
- ⇒ Të kuptojmë fazat e shpëlarjes së parave dhe metodat e shpëlarjes së parave si me të shfaqura në aktivitetet kriminale;
- ⇒ Të kuptojmë identifikimin e pasurisë dhe rendësin e hershme të identifikimit me qëllim konfiskimin e asaj pasurie.

Përmbajtja

- Shpëlarja e parave dhe hetimi financiar në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Burimet e parave të paligjshme, metodat e shpëlarjes dhe zbulimi i pastrimit të parave;
- Konfiskimi i pasurisë që rrjedhë nga shpëlarja e parave.

Metodologjia

Prezantim në PowerPoint, raste hipotetike dhe raste praktike gjyqësore, diskutim në grupe zhvillim strategjie të hetimit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Rekomandim nga KGJK
- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Strategjia për sundimin e ligjit
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Agjenda Evropiane
- Raportet e organizatave që monitorojnë sistemin e drejtësisë
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026

7. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Trajnimi synon ndërtimin e kapaciteteve të prokurorëve dhe gjyqtarëve në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Kodi i procedurës penale i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2023 ka paraparë procedura të reja sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit me qëllim të evitimit të sfidave dhe problemeve që janë hasur në praktikë. Po ashtu edhe Kodi Penal i aplikueshëm në nenin 92 ka paraparë ndryshime sa i përket konfiskimit të pasurisë përkatësisht të dobisë pasurore. Po ashtu edhe aplikimi i LKZK-ës ka pasur vështirësi në zbatimin e saj në praktikë dhe është identifikuar nevoja e zbatimit më të theksuar në të gjitha rastet ku plotësohen kushtet ligjore. Sendet që i nënshtrohen Konfiskimit automatik a duhet ti nënshtrohet urdhrave ndalues përfundimtar nga ana e gjykatave. Kur konfiskimi nuk është i mundur gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose të konfiskoj çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlershme. Dallimi midis sekuestrimit, konfiskimit dhe urdhrave ndalues, në cilat raste mund të zbatohet LKZK-ja, Kërkesat për shitje të aseteve të sekuestruara gjatë procedurës penale, masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar, trajtimi i sendeve që mund të shërbejnë si provë në procedurë penale dhe si pasuri e specifikuar. Adresimi i këtyre dilemave gjatë trajnimit do të bëhet përmes identifikimit të sfidave dhe dilemave në praktikë si: në cilat raste bëhet aprovimi retroaktiv i kontrollit dhe sekuestrimit, çfarë cilësohet pasuri e specifikuar, në cilat raste parashtrahet urdhri ndalues i përkohshëm dhe urdhri ndalues përfundimtar, si veprohet me sendet që shërbejnë si provë në procedurë penale, a duhet ti nënshtrohen urdhrave ndalues përfundimtar, sendet që automatikisht konfiskohen a duhet ti nënshtrohen urdhrave ndalues përfundimtar?

Objektivat

- ⇒ Identifikimi i risive ligjore të Kodit të Ri të Procedurës penale për sekuestrimin dhe konfiskimin;
- ⇒ Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat në të gjitha nivelet;
- ⇒ Identifikimi i rasteve të vazhdimet të procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit edhe pas ngritjes së aktit akuzues;
- ⇒ Identifikimin i problemeve lidhur me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë;
- ⇒ Adresimi i problemeve përmes praktikës së njësuar gjyqësore si përfundim;
- ⇒ Adresimi i sfidave rreth zbatimit të LKZ, për konfiskim dhe sekuestrim.

Përmbajtja

- Bazat e konfiskimit me theks të veçante neni 92 i KPRK-së;
- Kontrolli, sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi;
- Urdhri ndalues i përkohshëm dhe përfundimtar;
- Zëvendësimi i vlerës së pasurisë;
- Konfiskimi i pasurive shtese;
- Hetimi për konfiskim;
- Kërkesat dhe urdhrat për kufizim dhe kërkesat për verifikim të pasurisë sipas LKZK-së.

Metodologjia

Interpretimi i dispozitave ligjore, diskutimi interaktiv, trajtimi i rasteve nga praktika gjyqësore vendore.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional dhe hetuesit policor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Strategjia për sundimin e ligjit
- Formulari për VNT 2025-pas trajnimit
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti i trajnuesve me rekomandime pas trajnimit
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën

8. Krimet e Luftës

E drejta penale ndërkombëtare përfaqëson një fushë të specializuar të së drejtës që trajton përgjegjësinë penale individuale për krimet më të rënda, të cilat cenojnë paqen, sigurinë dhe rendin ndërkombëtar. Këto janë krime që nuk kufizohen vetëm brenda juridiksionit të një shteti të caktuar, por konsiderohen si shqetësim për gjithë bashkësinë ndërkombëtare. Statuti i Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare Nuremberg janë përcaktuar tri kategori të veprave penale ndërkombëtare: krimet kundër paqes, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Statuti krijoi një formë të re të së drejtës penale ndërkombëtare, e cila themelet i kishte në konventat ndërkombëtare dhe me marrëveshjet tjera. Gjithashtu, statuti përcaktoj parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare penale. Këto parime ishin: a) udhëheqësit, organizatorët, nxitësit apo bashkëpunëtorët të cilët kanë marrë pjesë në përbërjen apo kryerjen e ndonjë plani të përbashkët apo komploti me qëllim të kryerjes së veprës penale, janë përgjegjës për të gjitha veprat e kryera në zbatimin e atij plani apo komploti, prej cilit do person; b) pozita zyrtare e kryerësit të veprës penale qoftë si shef i shtetit apo të organit përgjegjës në administratën shtetërore, nuk do të paraqet bazë për lirim nga përgjegjësia apo për zbutjen e dënimit; c) fakti që kryerësi i veprës ka punuar sipas urdhrit të qeverisë së vet apo të eprorit, nuk është bazë për lirim nga përgjegjësia por mund të konsiderohet si arsye për zbutjen e dënimit, nëse gjykata gjen se kjo kërkon drejtësi.

Kategorizimi i këtyre veprave penale është thelbësor për trajtimin e duhur juridik dhe për mbrojtjen e viktimave. Kategoritë kryesore janë: Krimet e luftës, Krimet kundër njerëzimit dhe Gjenocidi. Këto janë të njohura dhe të rregulluara nga instrumente ndërkombëtare si Statuti i Romës, Konventat e Gjenevës, si dhe nga jurisprudenca e tribunaleve ndërkombëtare, përfshirë Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY), që ka pasur rëndësi të veçantë për kontekstin e Kosovës. Kosova ka qenë vetë subjekt i proceseve që lidhen ngushtë me të drejtën penale ndërkombëtare, për shkak të luftërave të armatosura të viteve '90 dhe pasojave të tyre. Gjatë luftës së viteve 1998–1999, në Kosovë janë kryer vepra që potencialisht përbëjnë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, dhe një pjesë e tyre janë trajtuar nga:

- ICTY, që ka ndjekur penalisht disa raste të krimeve të kryera në territorin e Kosovës,
- Misioni i UNMIK-ut, i cili kishte autoritet të përkohshëm për ndjekjen e krimeve ndërkombëtare,
- EULEX, që ka ushtruar funksione hetuese dhe gjyqësore për krime të natyrës ndërkombëtare,

Ndërkohë, edhe sistemi gjyqësor vendor në Kosovë ka përgjegjësi të qarta për të ndjekur penalisht veprat penale ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmban dispozita që kriminalizojnë krimet e luftës dhe veprat tjera të ndërlidhura me të drejtën ndërkombëtare humanitare. Për gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë, njohja e thelluar e klasifikimit të këtyre krimeve dhe aplikimi i drejtë i normave ndërkombëtare në praktikën vendore është thelbësor për forcimin e sundimit të ligjit dhe ofrimin e drejtësisë për viktimat e konfliktit.

Ky trajnim synon të rrisë kapacitetet profesionale të pjesëmarrësve përmes analizës së rasteve praktike vendore dhe ndërkombëtare të krimeve të luftës, mbi bazën e mangësive të identifikuara në praktikë, përfshirë edhe rastet që kanë marrë epilog gjyqësor.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive për kategorizimin e veprave penale që përbëjnë shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare;
- ⇒ Thellimi i njohurive për figurën dhe elementet specifike të secilës kategori të veprave penale që përbëjnë shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare;
- ⇒ Avancimi i njohurive për veprën penale Gjenocid;
- ⇒ Thellimi i njohurive për veprën penale Krime kundër njerëzimit dhe krim i luftës kundër popullsisë civile;
- ⇒ Zgjerimi i njohurive mbi format e përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- ⇒ Thellimi i njohurive për bashkëkryerja si formë e përgjegjësisë penale në rastet e krimeve të luftës;
- ⇒ Zgjerimi i njohurive për përgjegjësinë individuale në rastet e krimeve të luftës;
- ⇒ Thellimi i njohurive për përgjegjësinë e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale (NPK) në raste e krimeve të luftës;
- ⇒ Njohin përgjegjësinë komanduese si një formë specifike e përgjegjësisë penale.

Përmbajtja

- Kategorizimi i veprave penale që përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës nacionale;
- Vepra penale Gjenocid; Vepra penale Krim kundër njerëzimit;
- Vepra penale Krim i luftës kundër popullsisë civile;
- Format e zbatueshme të përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- Bashkëkryerja si formë e përgjegjësisë penale;
- Përgjegjësia individuale në rastet e krimeve të luftës;
- Përgjegjësia e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale (NPK) në raste e krimeve të luftës;
- Përgjegjësisë komanduese si një formë specifike e përgjegjësisë penale;
- Praktika gjyqësore: Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit të Kosovës.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të ketë ligjërimit teorik, praktik dhe të kombinuar, ushtrime praktike nga rastet e trajtuara në prokurori dhe do të kërkohet që të analizojnë dhe prezantojnë çështjet e evidentuara.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor, policët hetues.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Formulari për VNT 2025 pas trajnimit

9. Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë-ndërtimi pa leje dhe punimet ndërtimore të kundërligjshme

Këto vepra penale shkaktojnë rrezik të madh për jetën e njerëzve si dhe dëm të konsiderueshëm pasuror, duke marrë parasysh faktin se ndërtimet e kryera pa leje të organeve kompetente dhe në kundërshtim me të gjitha rregullat dhe legjislacionin përkatës në fuqi prekin drejtpërsëdrejti jetën, pasurinë, sigurinë e përgjithshme dhe hapësirat publike të cilat janë në interes të përgjithshme të qytetarëve. Këto vepra zakonisht kryhen duke mos vepruar sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror. Në vendin tone këto vepra kryesisht kryhen në pronë publike apo shtetërore, në zonat e mbrojtura, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura, zonat me interes të veçantë ekonomik, zonat sanitare për përdorimin e ujit ose zonat e mbrojtur për qëllime strategjike, pasojat e të cilave janë të konsiderueshme dhe shpesh here te pa riparueshme për faktin që shpesh herë organet ligj zbatuese hasin në vështirësi të mëdha në shkatërrimin e ndërtime pa leje. Kur manifestohen elementet e këtyre veprave penale? Dallimi në mes të Ndërtimi pa leje dhe punimet ndërtimore të kundërligjshme, Rrënimi i objektit të ndërtuar pa leje, ku është kufiri ndarës në mes të aspektit administrative dhe atij penal të këto raste? A duhet propozimi i prokurorit për rrënimin e objektit pa leje. Adresimin i këtyre dilemave gjatë trajnimit do të bëhet përmes analizave a ligjore lidhur me këto vepra penale, trajtimi i rasteve praktike, rrënimi i objektit të ndërtuar pa leje.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë për përcaktimin e saktë elementet e këtyre veprave penale;
- ⇒ Bëjnë dallimin në mes të veprimeve administrative dhe veprimeve hetimore penale të këto vepra penale;
- ⇒ Përcaktojnë cilat janë kompetencat e Prokurorit të shtetit të këto vepra penale në raport me kompetencat e organeve tjera administrative;

Përmbajtja

- Hetimi i këtyre veprave;
- Sigurimi i provave rreth ndërtimit pa leje;
- Ngritja e aktakuzës.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit përmban një kombinim metodash që synojnë prezantime nga trajnuesit, diskutim i rasteve studimore, diskutime të hapura dhe interaktive, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti me gjetjet për mjedisin në Kosovë
- Propozimi nga trajnuesi i përhershëm i AD-së

10. Veprat penale kundër Ambientit

Krimi mjedisor, krimi kundër natyrës dhe krimi kundër pyjeve në Republikën e Kosovës, prej vitesh tashmë është mjaft i formatuar si nga ana e parashikimeve ligjore për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave të këtyre fushave, ashtu edhe nga lloji i veprave penale që janë shfaqur dhe shfaqen çdo ditë me evoluimin e shoqërisë në përgjithësi dhe të teknologjisë në veçanti. Në vendin tonë, po vërehet gjithnjë e më tepër ndotja dhe degradimi i ambientit, pastaj prerja ilegale e pyjeve, djegia e pyjeve apo zjarrvënës. Kjo gjë ndryshon florën dhe faunën e sipërfaqes së cenuar në mënyrë të pakthyeshme kështu dëmtohet mjedisi, pyjet dhe natyra. Kodi Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin 27 rregullon veprat penale kundër mjedisit, si “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit”; “shkretërimi i pyjeve”; “Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme”; “Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin”; dhe shumë vepra tjera penale. Në një epokë ku ndotja e mjedisit është bërë një sfidë globale, mbrojtja e mjedisit ka fituar një rëndësi të jashtëzakonshme në botën bashkëkohore. Studimet dhe hulumtimet e kësaj sfide tregojnë se përpjekjet për të ruajtur dhe promovuar mjedisin janë të domosdoshme për të garantuar të ardhmen tonë dhe të brezave të ardhshëm. Në përpjekje për të arritur këtë synim të rëndësishëm, shumë shtete bashkëkohore kanë penalizuar një mori veprimesh që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit, duke i parashikuar si vepra të kundërligjshme, qoftë në formë të veprave penale (kundërvajtjeve penale), kundërvajtjeve, shkeljeve administrative dhe shkeljeve të tjera. Këto masa kanë për qëllim të kujdesen për të drejtën e qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Në këtë mënyrë, trajtimi i këtyre çështjeve mjedisore në tryeza dhe forume të ndryshme në mes të gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjetër vlerësohet se është i një rëndësie të veçantë.

A ka Kosova mekanizma të mjaftueshëm për mbrojtjen e ambientit? Dilemat e kualifikimit juridik midis shkeljes administrative dhe penale? Sekuestrimi mjeteve të kryesve të veprave penale kundër mjedisit? Përgjegjësia penale e personave juridik (kompanive) Ekspertizat lidhur me shkallën e dëmit të shkaktuar.

Objektivat

- ⇒ Identifikojnë veprat penale kundër ndotjes dhe degradimit të mjedisit;
- ⇒ Aplikojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që i referohen veprave penale kundër mjedisit;
- ⇒ Kuptojnë në mënyrë sa më të qartë elementet e figurave të veprave penale kundër mjedisit, duke pasur parasysh edhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi;

Përmbajtja

- Kuptimi i veprave penale në fushën e mjedisit, pyllit dhe natyrës;
- Legjislacioni vendor për mbrojtjen e mjedisit pyllit dhe natyrës;
- Llogaritja e dënimit të shqiptuar për kundërvajtje në dënimin e shqiptuar për vepra penale;
- Konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit;

- Organizmat ndërkombëtare që veprojnë në luftën kundër krimeve mjedisore;
- Konventat e Këshillit të Evropës mbi Mjedisin;
- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut për çështjet mjedisore.

Metodologjia

Metodat e kombinuara të shpjegimit dhe diskutimit të çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me veprat penale kundër mjedisit. Në këtë drejtim, do të ketë diskutime interaktive dhe elaborim të rasteve nga praktika gjyqësore, punë në grupe.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, hetues policor dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Rekomandim nga KGJK
- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale

11. Udhëzuesi për politiken ndëshkimore

Procesi gjyqësor ka dy qëllime themelore që ndiqet nga detyrimi i gjykatës që është: a) Konstatimi i fajësisë së të akuzuarit dhe b). Çështja e sanksionit penal. Në këtë kuptim përmes këtyre dy qëllimeve duhet të arrihet edhe trajtimi i barabartë para ligjit në procedurën penale, që përveç detyrimit që gjykata e ka për të shqiptuar një dënim ndaj kryerësit që ai të risoializimet që ka të bëjë me individualizimin e dënimit njëkohësisht duhet që në rrethana dhe raste të ngjashme të trajtohen para ligjit njësoj të akuzuarit. Andaj me qëllim që të arrihen si individualizimi ashtu edhe trajtimi i barabartë dhe të arrihet qëllimi i dënimit në kuadër të kësaj tryezë duhet të vlerësohen edhe problemet praktike që shpesh herë cenohen individualizimi, trajtimi i barabartë dhe qëllimi i dënimeve. Fokusi i tryezës do të jetë diskutimi nga praktika gjyqësore për të arritur që të eliminohen problemet praktike në zbatimin e udhëzuesit për qëllimin e dënimit si atij të përgjithshëm ashtu edhe atyre të veçanta. Dilemat që shtrohen janë, identifikimi i rrethanave në rastet konkrete, shmangia si vlerësim i elementeve të veprës penale si rrethana renduese apo lehtësuese, peshimi i rrethanave që merren për bazë për shqiptimin e dënimit. Qasja do të jetë ekskluzivisht ndarja si model e disa rasteve praktike të vendimeve gjyqësore në të cilat janë konstatuar shkelje gjegjësisht vendime gjyqësore që kanë marrë për bazë udhëzuesin dhe vendime që nuk kanë marrë për bazë udhëzuesin.

Objektivat

- ⇒ Të arrihet një unifikim dhe konsistencë në zbatimin e udhëzuesit për politiken e dënimit;
- ⇒ Të kuptohet drejtë mos përdorimi i elementeve të veprës penale si rrethana qofshin renduese apo lehtësuese;
- ⇒ Avancimi i njohurive rreth faktorëve që e bëjnë një rrethanë me peshë.

Përmbajtja

- Përcaktimi i pikës fillestare të dënimit;
- Identifikimi i rrethanave;
- Peshimi i rrethanave;
- Shmangia e vlerësimit të elementeve të veprës si rrethana qofshin lehtësuese apo renduese.

Metodologjia

Duhet të ketë tryezë diskutimi mbi praktiken e ndjekur dhe evidentimin e rasteve që janë në përputhje me udhëzuesin si dhe atyre që nuk janë në përputhje. Diskutimi mbi rastet praktike ngritja e diskutimit si të shmangen të metat në rastet e ardhshme praktike.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Formulari për VNT 2025-pas trajnimit
- Rekomandimet nga trajnuesi pas trajnimit
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme

12. Aktakuza

Rol me rëndësi në këtë fazë të procedurës penale është hartimi i aktakuzës që paraqet aktin përfundimtar të një procesi hetimor. Aktakuza prezanton procesin e hetimit dhe rezultatet e arritura nga ky hetim. Aktakuza duhet të jetë e hartuar mirë, qartë dhe përmbajtësore në mënyrë që ti mundësojë gjykatës procedimin e çështjes. Qëllimi i trajnimit është të aftësojë prokurorët dhe gjyqtarët për të kuptuar më thellë përpilimin e aktakuzës, kontrollin gjyqësor të saj, procesin e zgjerimit, ndryshimit dhe tejkalimit të aktakuzës në shqyrtim gjyqësor. Përpilimi i aktit akuzues sipas kërkesave ligjore dhe standardeve ligjore dhe sigurimi i cilësisë së aktakuzës përmes arsytimit të qartë dhe të qëndrueshëm është e rëndësishme veçanësisht. Qëllimi i trajnimit është edhe forcimi i rolit të gjyqtarit në kontrollimin e ligjshmërisë dhe përmbajtjes së aktakuzës, nëse është përpiluar konform Kodit të Procedurës Penale. Qëllimi është edhe mësimi i praktikave dhe teknikave të ndryshimit dhe zgjerimit të aktakuzës dhe kufijtë dhe mundësitë ligjore, procedura ligjore për zgjerim dhe ndryshim të aktakuzës. Po ashtu me rëndësi është edhe të sqarohet parimi se gjykata është e lidhur me aktakuzën dhe nuk mund të gjykojë jashtë saj, përveç atëherë se gjykata sipas Kodit të Procedurës Penale nuk është e lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale në aktakuzë. Të kuptohet se tejkalimi i aktakuzës cenon parimin e ligjshmërisë dhe të drejtën për mbrojtje të të pandehurit. Të analizohet dallimi në mes ndryshimit dhe tejkalimit të aktakuzës nga gjykata dhe të elaborohen rastet praktike kur gjykatat kanë tejkaluar aktakuzën dhe pasojat e saj, si dhe të forcohet respektimi i balancimit në mes të tejkalimit të aktakuzës dhe mbrojtjes së të pandehurit në procedurë penale.

Çfarë duhet të përmbajë aktakuza në raport me kërkesat ligjore? Si përpilohet dhe çfarë përmban dispozitivi i aktakuzës dhe arsytimi i saj, Kur lejohet ligjërisht ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor? A mund të ndryshohet vetëm kualifikimi juridik apo edhe faktet esenciale të aktakuzës, A mund të ndryshohet aktakuza me vepra të reja gjatë gjykimit, A mund të ndryshohet apo zgjerohet aktakuza pa prova të reja vetëm mbi gjendjen faktike ekzistuese, Deri ku shtrihet e drejta e prokurorit në ndryshimin dhe zgjerimin e aktakuzës, Cili është roli i gjyqtarit në zgjerimin dhe ndryshimin e aktakuzës, A rrezikohet e drejta e mbrojtjes në rast të ndryshimit dhe zgjerimit të aktakuzës? Çfarë kuptohet me tejkalim të aktakuzës dhe çfarë përmban tejkalimi i aktakuzës, a përfshinë vetëm ndryshimin e kualifikimit juridik apo edhe përmbajtjen e gjendjes faktike të saj.

Qasja në adresimin e këtyre dilemave gjatë trajnimit do të bëhet përmes analizës së dispozitave ligjore, studimit të rasteve praktike, shkëmbimit të përvojave, diskutimit të rasteve dhe dilemave praktike.

Objektivat

- ⇒ Identifikojnë burimin e informacioneve dhe të ndërtojnë standardin e dyshimit të arsyeshëm;
- ⇒ Njohin metodat dhe tekniken e hetimit penal;
- ⇒ Vlerësojnë se kur dhe si informacionet shndërrohen në prova të pranueshme në procedurë penale;
- ⇒ Avancimi i njohurive lidhur me hartimit të aktakuzës.

Përmbajtja

- Hartimi i aktakuzave, përmbajë aktakuza në raport me kërkesat ligjore;
- Si përpilohet dhe çfarë përmban dispozitivi (gjendja faktike) i aktakuzës dhe arsyetimi i saj;
- Kur lejohet ligjërisht ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- A mund të ndryshohet vetëm kualifikimi juridik apo edhe faktet esenciale të aktakuzës;
- A mund të ndryshohet dhe zgjerohet aktakuza me vepra të reja gjatë gjykimit;
- A mund të ndryshohet apo zgjerohet aktakuza pa prova të reja vetëm mbi gjendjen faktike ekzistuese;
- E drejta e prokurorit në ndryshimin dhe zgjerimin e aktakuzës;
- Cili është roli i gjyqtarit në zgjerimin dhe ndryshimin e aktakuzës;
- E drejta e mbrojtjes në rast të ndryshimit dhe zgjerimit të aktakuzës;
- Çfarë kuptohet me tejkallim të aktakuzës dhe çfarë përmban tejkallimi i aktakuzës, a përfshinë vetëm ndryshimin e kualifikimit juridik apo edhe përmbajtjen e gjendjes faktike të saj.

Metodologjia

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

13. Përgjegjësia penale e personave juridik

Përveç personave fizik, si kryes të veprave penale mund të jenë edhe personat juridik. Personat juridik mund të përgjigjen për vepra penale nga pjesa e veçantë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës edhe për vepra tjera penale, nëse janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e personit juridik të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridik për vepra penale. Sipas ligjit të lartcekur, personi juridik është përgjegjës për vepër penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer vepër penale me qëllim që për atë, personi juridik të realizoj ndonjë dobi ose ka shkaktuar dëme. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste mapo urdhrat e personit juridik. Mirëpo, edhe përkundër këtyre dispozitave ligjore, në praktikën gjyqësore paraqiten probleme të shpeshta në përcaktimin e përgjegjësisë penale të personave juridik. Çfarë është përgjegjësia penale e personave juridik? Cili është kufiri i kësaj përgjegjësie? Cilat janë sanksionet që mund të shqiptohen ndaj personave juridik? Ky program trajnimi pra, adreson pyetjet duke analizuar institutin e përgjegjësisë penale të personave juridike si dhe dispozitat ligjore që i referohen këtij instituti përmes rasteve praktike

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë drejtë institutin e përgjegjësisë penale të personave juridik sipas ligjit;
- ⇒ Kuptojnë në mënyrë të drejtë se në cilat raste dhe çfarë lloji të sanksioneve mund t'u shqiptohen personave juridik;
- ⇒ Interpretojnë drejtë normat ligjore përgjegjësinë penale të personave juridik;

Përmbajtja

- Baza dhe kufiri i përgjegjësisë penale të personave juridik;
- Procedura ligjore për shqiptimin e sanksioneve kundër personave juridik;
- Llojet e sanksioneve që mund të shqiptohen ndaj personave juridik.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren prezantime të materialeve në PowerPoint, metoda interaktive të trajnimit duke i shoqëruar me raste praktike dhe hipotetike për situata të ndryshe gjatë të cilave janë gjendur gjyqtarët dhe prokurorët me rastin e vendosjes lidhur me përgjegjësinë penale të personave juridik.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë e nivelit themelor dhe të apelit.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

14. Procedurat alternative

Qëllimi kryesor i procedurave alternative sipas Kodit të Procedurës Penale është të ofrojnë një zgjidhje më të shpejtë dhe më efikase për çështjet penale, duke reduktuar kështu ngarkesën në punën e prokurorëve dhe gjyqtarëve, si edhe duke mundësuar rehabilitimin më të shpejtë të të akuzuarit dhe drejtësinë restorative / riparimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Qëllimet e rëndësishme të procedurës së ndërmjetësimit dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë përfshijnë: Shmangia e mbingarkesës së lëndëve në prokurori dhe gjykata: Proceset alternative mund të zgjidhin raste pa seanca të plota gjyqësore, e rrjedhimisht duke lehtësuar ngarkesën e punës në prokurori dhe gjykata; Inkurajimi i pajtimit dhe marrëveshjeve: Ky proces mund të inkurajojë pajtimin mes palëve dhe mund të përmirësojë marrëdhëniet sociale dhe personale pas një konflikti. Përmirësimi i rehabilitimit dhe riparimit të dëmit: Procedura që ofrojnë drejtësi restorative si dhe mundësia që i akuzuari-dënuari të marrë pjesë në aktivitete rehabilituese si punë publike ose kurse të edukimit për të shmangur përsëritjen e veprave penale. Trajnimi do të sigurojë gatishmërinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve për të aplikuar këto procedura në mënyrë të drejtë dhe të balancuar, komunikimit efektiv me palë, koordinimit dhe komunikimit efektiv ndërinstitucional. Trajtimi i dilemave përgjatë trajnimit dhe shkëmbimi i përvojave do të ndihmojë në përgatitjen e profesionistëve që të përballen me sfida të mundshme në aplikimin e këtyre mekanizmave/procedurave.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive mbi procedurat alternative;
- ⇒ Aftësimi për menaxhimin e pajtimit dhe negociatave;
- ⇒ Avancimi i njohurive për vlerësimin e rasteve dhe përzgjedhjen e procedurës më të përshtatshme;
- ⇒ Avancimi i praktikës në marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe dënimet që mund të rekomandohen në marrëveshje;
- ⇒ Përmirësimi i qasjes ndaj viktimave dhe të akuzuarve.

Përmbajtja

- Ndërmjetësimi;
- Marrëveshja për pranimin e fajësisë.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit do të jetë interaktive, praktike dhe e fokusuar në zhvillimin e aftësive për aplikimin e këtyre procedurave në praktikë: Shpjegim i detajuar i dispozitave ligjore; Studim rasti, rast studimi nga praktika gjyqësore e GJEDNJ dhe grupet e punës.

Përfituesit

Prokurorë, gjyqtarë, zyrtarë për ndërmjetësim.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

15. Intervistimi i palëve, qasja ndaj viktimave dhe dëshmitarëve okular, gjetja e provave, përgatitja e palëve në procedurë për paraqitje para gjykatës

Qëllimi i këtij trajnimi është të përgatisë prokurorët dhe gjyqtarët me njohuri të avancuara teorike dhe praktike për mënyrat më efektive të intervistimit të palëve, viktimave dhe dëshmitarëve okular në procedurë penale. Trajnimi synon të forcojë aftësitë për qasjen e ndjeshme ndaj viktimave, për sigurimin e dëshmiave të besueshme dhe të ligjshme, si dhe përgatitjen profesionale të dëshmitarëve për paraqitjen në gjykim, në mënyrë që procesi gjyqësor të zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Si intervistohen palët, dëshmitarët okular? Si trajtohen viktimat e krimit në procedurë penale? Sigurimi i provave të ligjshme dhe të pranueshme, Kush i cakton dëshmitarët bashkëpunues? Cilësia e dëshmitarëve bashkëpunues? Qasja në adresimin e këtyre dilemave do të bëhet përmes Analizës së dispozitave ligjore, studimi i rasteve praktike, shkëmbimi i përvojave, diskutimi i rasteve dhe dilemave praktike

Objektivat

- ⇒ Të kuptoj parimet ligjore dhe etike të intervistimit të palëve dhe dëshmitarëve në procedurë penale;
- ⇒ Të zbatoj teknika praktike të intervistimit apo marrjes në pyetje për të siguruar dëshmi të qarta dhe të pranueshme;
- ⇒ Të aplikoj qasje të sigurt ndaj viktimave të krimit;
- ⇒ Të identifikojë dhe mbledh provat materiale në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- ⇒ Të vlerësoj besueshmërinë e dëshmitarëve dhe të menaxhoj kontradiktat gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përmbajtja

- Bazat ligjore dhe parimet e intervistimit dhe marrjes në pyetje të palëve në procedurë penale;
- Marrëveshja me dëshmitarët bashkëpunues, përfitimet ligjore dhe procedurale;
- Trajtimi, menaxhimi i dëshmitarëve bashkëpunues, zvogëlimi i dënimit për dëshmitarët bashkëpunues;
- Mbledhja dhe sigurimi i provave;
- Qasja ndaj viktimave dhe dëshmitarëve okular;
- Teknikat dhe metodat e intervistimit dhe marrjes në pyetje të palëve;
- Përgatitja e dëshmitareve për gjykim.

Metodologjia

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit

Prokurorë, gjyqtarë, hetuesit policor, bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Pyetësori për VNT për gjyqtarë 2026
- Raporti i trajnuesve me rekomandime pas trajnimit
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

16. Gjykimi në mungesë

Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), në rastet kur prezenca e të pandehurit nuk mund të sigurohet edhe pas përpjekjeve të arsyeshme, gjykimi mund të mbahet edhe pa praninë e tij. Ky institucion është paraparë edhe me Direktivën (BE) 2016/343 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 9 mars 2016. Gjykimi në mungesë është inkorporuar për shkak të vështirësive të shpeshta për sigurimin e pranisë së të pandehurit, çka në disa raste ka çuar deri në parashkrimin e ndjekjes penale. Në raste të tjera, të pandehurit janë shmangur me qëllim nga drejtësia, sidomos kur bëhet fjalë për veprat penale të gjenocidit, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, vepra të tjera që nuk parashkruhen sipas të drejtës ndërkombëtare, si dhe për veprën e vrasjes së rëndë.

Gjykimi në mungesë mund të aplikohet për çdo vepër penale, për aq kohë sa plotësohen kushtet ligjore. Këto kushte përfshijnë prezencën e të pandehurit në shqyrtim të paktën një herë (në shqyrtimin fillestar ose gjatë shqyrtimit gjyqësor), si dhe njoftimin paraprak për detyrimin e tij për të qenë i pranishëm. Po ashtu, i pandehuri duhet të jetë informuar se gjykimi mund të vazhdojë edhe në mungesën e tij, nëse ai shmanget me vullnet. Përfundimisht, për veprat penale që nuk parashkruhen sipas nenit 104 të Kodit Penal të Kosovës, nuk kërkohet kushti i pranisë paraprake të të pandehurit. Në këto raste, në bazë të nenit 303 paragrafi 7 të KPP-së, i gjykuari gëzon të drejtën e rigjykimit të pakushtëzuar, automatik dhe të plotë, me kërkesën e tij. Si sigurohet balanca ndërmjet të drejtës së të pandehurit për një proces të drejtë dhe interesit publik për funksionalitetin e drejtësisë? Cilat janë përpjekjet që duhet ndërmarrë organi procedues për të konsideruar se i pandehuri është shmangur me vullnet? A garanton sistemi ligjor vendor mbrojtje të mjaftueshme për të pandehurit që gjykohen në mungesë?

Trajnimi do të zhvillohet përmes diskutimeve interaktive, analizës së praktikës gjyqësore dhe krahasimeve ndërmjet legjislacionit vendor e atij ndërkombëtar, rasteve konkrete dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Objektivat

- ⇒ Të kuptohen kushtet ligjore për mbajtjen e gjykimit në mungesë;
- ⇒ Të vlerësohet domosdoshmëria e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin fillestar ose gjyqësor;
- ⇒ Të analizohet legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar lidhur me këtë institut procedural.

Përmbajtja

- Kushtet ligjore për mbajtjen e gjykimit në mungesë (nenet 303–308 të KPPK-së);
- Prezenca e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe gjyqësor;
- Seanca dëgjimore për të konstatuar mungesën e të akuzuarit;
- Përpjekjet e arsyeshme për gjetjen e të akuzuarit dhe dokumentimi i këtyre përpjekjeve;

- Njoftimi i të pandehurit për aktgjykimin dhe të drejtat që i garantohen;
- Rigjykimi në rastet e gjykimit në mungesë;
- E drejta e të pandehurit për mbrojtës gjatë gjithë procedurës;
- Përcaktimi i kriterëve ligjore për vlerësimin e mungesës së justifikuar apo të pajustificuar;
- Analiza e jurisprudencës vendore dhe ndërkombëtare mbi gjykimin në mungesë.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara trajnuese, diskutime interaktive, raste praktike, punë në grupe, analizë e vendimeve të GJEDNJ-së.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë ligjorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Strategjia shtetërore kundër drogave 2024-2028
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

17. Veprat penale të narkotikëve dhe substancave tjera

Trajnimiti synon të ofrojë njohuri të avancuara mbi metodat e hetimit, përdorimin e provave të veçanta dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në luftimin e trafikimit të narkotikëve. E rëndësishme është kuptimi dhe aplikimi i dispozitave ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar nga veprimtaria kriminale. Përmes trajnimit, prokurorët dhe gjyqtarët forcojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të identifikuar, analizuar dhe adresuar praktikën e sofistikuar të operimit të grupeve kriminale. Harmonizimi i praktikave gjyqësore dhe sigurimi i qasjes së unifikuar në zbatimin e ligjit ka rëndësi shumë të madhe edhe në zbatimin e politikës ndëshkimore. Qëllimi i trajnimit është rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në parandalimin e përfitimeve të paligjshme dhe forcimi i kapaciteteve hetimore në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Identifikimi i sfidave dhe dilemave në praktikë? Dallimi në mes të posedimit me qëllim të përdorimit dhe shitjes? Cili është standardi provues për të provuar qëllimin e shitjes dhe shpërndarjes? Si duhet të menaxhohen rastet me informatorët? Si zhvillohet hetimi pro aktiv?, Zbatimi i dispozitave ligjore të sekuestrimit dhe konfiskimit?

Objektivat

- ⇒ Identifikojnë elementet e veprave penale lidhur me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope;
- ⇒ Kryejnë hetime pro aktivë penale dhe financiare, në rastet që lidhen me trafikimin e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- ⇒ Identifikojnë llojet e narkotikëve dhe pasojat e përdorimit të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope.

Përmbajtja

- Elementet e veprave penale lidhur me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope;
- Hetimet proaktive penale dhe financiare, në rastet që lidhen me trafikimin e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- Identifikimi i llojeve të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope
- Kompetencat dhe bashkëpunimi me Njësinë për inteligjencë financiare;
- Pasojat e përdorimit të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;

Metodologjia

Gjatë trajnimit, do të përdoren metodat interaktive, simulim i rasteve, punë në grupe, pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.

Përfituesit

Prokurorët dhe gjyqtarët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Raporti i OSHC
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

18. Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë

Qëllimi i trajnimit për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit është të pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe aftësi për të kuptuar, zbatuar dhe vlerësuar në mënyrë efektive këto masa në përputhje me legjislacionin penal dhe standardet ndërkombëtare për të. Të kuptohet rëndësia e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procesin penal dhe roli i tyre në procedurë. Të analizohen llojet e masave që mund të merren, si: Thirrja, Urdhër arresti, Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, Ndalimi për t'iu afuar vendit ose personit, Paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, paraburgimi, Çështje për diskutim në trajnim: Kur është masa "arrest në burg" e justifikuar dhe kur jo? Si balancon gjykata mes rrezikut për arratisje dhe të drejtës për liri? Si ndikojnë rrethanat personale të të pandehurit në vendimmarrje? Si trajtohen ankesat ndaj vendimeve për masat e sigurimit?

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive për të vlerësuar proporcionalitetin dhe nevojshmërinë e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit, në bazë të rrezikut të ikjes, rrezikut për përsëritje të veprës penale apo pengimit të hetimeve;
- ⇒ Avancojnë njohuritë për respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe parimin e prezumimit të pafajësisë;
- ⇒ Të rritet kapaciteti profesional për të justifikuar dhe dokumentuar vendimmarrjen në lidhje me këto masa para gjykatës dhe palëve të interesuara.

Përmbajtja

- Interpretimi i dispozitave të Kodit Procedurës Penale dhe Nenit 5 të Konventës Evropiane për te Drejtat e njeriut- E Drejta për Liri dhe Siguri

Metodologjia

Trajtimi i rasteve nga praktika gjyqësorë, lidhur me masat e sigurisë së pranisë së të pandehurit me theks të veçantë paraburgimi si masa më e rëndë e sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurë.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

19. Veprat penale kundër jetës dhe trupit – vrasja, vrasja e rëndë dhe vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore

Veprat penale kundër jetës dhe trupit veçanërisht ato kundër jetës janë vepra penale të cilat në praktikën gjyqësore në vazhdimësi paraqesin probleme në kualifikimin e saktë dhe të mirëfilltë. Për më tepër, e drejta e njeriut për jetë është e drejta më e rëndësishme në grupin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe kjo e drejtë është absolute. Për këtë arsye, kjo e drejtë është e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare, por garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mbrojtja e të jetës është e sanksionuar edhe me dispozitat e KPRK, duke përcaktuar formën themelore të saj dhe disa forma të kualifikuara dhe të privileguara të kësaj vepre penale. Gjatë këtij trajnimi do të flitet hollësisht për përkufizimin dhe elementet kualifikuese të vrasjes së rëndë, rrethanat, mënyrat dhe format e kryerjes së kësaj vepre, problemet praktike me rastin e kualifikimit të vrasjes së rëndë dhe vrasjet e privileguara ne veçanti për vrasjen e kryer në gjendje të tronditjes së rëndë trupore. Këto dhe çështje tjera do të adresohen përmes këtij trajnimi duke zbërthyer dispozitat ligjore dhe duke analizuar rastet praktike.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë për veprat penale të vrasjes, format e kualifikuara dhe të privileguara të saj;
- ⇒ Identifikojnë format, rrethanat dhe aspekte tjera të veprat penale të vrasjeve të rënda;
- ⇒ Analizojnë rastet praktike të këtyre veprave penale.

Përmbajtja

- Veprat penale kundër jetës si vrasja, vrasjen e rëndë dhe vrasjet e privileguara;
- Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit do të fokusohet të diskutimi interaktiv me pjesëmarrësit, gjithashtu pjesëmarrësve, do t'ju ofrohen për të diskutuar në grupe edhe rastet nga praktika gjyqësore me qëllim të kualifikimit të drejtë juridik të veprave penale të këtij kapitulli, e ne veçanti rastet e elementeve kualifikuese të vrasjes së rëndë.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë e nivelit themelor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave
- Plani Kombëtar për të drejtat e njeriut
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

20. Procedura penale ndaj kryesve me çrregullime mendore

Procedura penale ndaj kryesve me çrregullime mendore përveç se sipas legjislacionit është e veçantë njëkohësisht edhe masat për shqiptimin ndaj kryerësve me çrregullime mendore janë të veçanta. Në praktiken gjyqësore ka probleme si për sa i përket vlerësimit të ekspertizave, ndarjes së kategorive të kryesve me çrregullime mendore lidhur me çështjen e paaftësisë, përgjegjësisë së zvogëluar dhe përgjegjësisë së plotë penale, për çka përmes këtij trajnimi do të arrihet që të trajtohen nga aspekti praktike çështjet e tilla ligjore dhe praktike. Po ashtu edhe mënyra dhe natyra e vendimmarrjes diktohet varësisht nga rrethanat se kryerësi a është në gjendje të paaftësisë mendore apo aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore e kjo ndërlidhet në kohën e kryerjes së veprës penale mirëpo çështje thelbësore praktike përbën edhe fakti i konstatimit nëse kryerësi është i aftë për t'iu nënshtruar gjykimit që behet një ekzaminim në fazën e vonshme pas kryerjes së veprës penale, andaj përmes trajnimit edhe këto probleme ligjore dhe praktike do të trajtohen. Në kuadër të kësaj procedure rol të rëndësishëm duhet të zë edhe caktimi i masës së paraburgimit ndaj kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale, urdhri për ekzaminim psikiatrik qoftë kur bëhet me ndalim ekzaminimi apo kur behet në liri, si dhe rastet praktike kur i dyshuari refuzon ekzaminimin psikiatrik, të gjitha këto aspekte ligjore dhe praktike do të jenë në fokus të qëllimit të këtij trajnimi.

Si çështje thelbësore është konstatimi i gjendjes së kryerësit në kohën e kryerjes së veprës penale që bëhet nga ekspertet, kjo efektivisht e përcakton edhe aspektin nëse kryerësi është penalisht përgjegjës apo është kryes me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore, në këtë kontekst ka rëndësi trajtimi i kësaj dileme nga se në një formë rezulton se është eksperti që e përcakton natyrën e përgjegjësisë, gjë që sistemet rajonale dhe evropiane nuk e trajtojnë në këtë mënyrë por këtë konstatim e bëjnë vetëm gjykata në proces të vlerësimit. Aspekt tjetër rezultojnë masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe në liri apo në ndalim që kanë aspekte të rëndësishme ligjore e që shfaqen si probleme në praktiken gjyqësore si për sa i përket kohëzgjatjes apo kushteve që duhet përmbushur për shqiptimin e tyre, po ashtu urdhrat për ekzaminim kanë një rol vendimtar duke qenë se praktika gjyqësore lëshon urdhër të përgjithësuar e që duhet kërkuar konkretisht nga ekspertët çështje për sqarim lidhur me aspektin e gjendjes mendore të dyshuarit, dhe njëkohësisht edhe natyra e vendimmarrjes që ka rëndësi si në mënyrën e vendosjes ashtu edhe në llojin e vendimit të sqarohet nga aspekti praktik.

Diskutim mbi aspektet praktike të rasteve gjyqësore në këndvështrim me dispozitat ligjore, aspekti i praktikës gjyqësore që ekziston në nivelin e rajonit dhe interpretim i dispozitave ligjore duke krijuar pyetje konkrete nga situata praktike.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë për rolin e ekspertit në rastin e ekzaminimit dhe kompetencën e tij;
- ⇒ Të kuptojmë domosdoshmërinë e kërkesave specifike që përfshihen në urdhrin për ekzaminim;

- ⇒ Të kuptojmë kushtet ligjore të masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik në liri apo në ndalim;
- ⇒ Të kuptojmë standardet e GJEDNJ-se për masat e paraburgimit ndaj kryesve me çrregullime mendore.

Përmbajtja

- Paaftësia mendore dhe aftësia esencialisht e zvogëluar mendore;
- Roli i gjykatës në përcaktimin e paaftësisë apo aftësisë së zvogëluar mendore;
- Cilat janë kriteret që duhet pasur për baze për vlerësim nga gjykata nëse një kryes është i paaftë mendërisht apo në aftësi esencialisht të zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale;
- Si duhet të kërkohet sqarime dhe deri ku duhet lejuar kompetencën e ekspertit për ta ndihmuar gjykatën;
- Cilat janë kushtet për shqiptimin e masave dhe sa mundë të zgjasin;
- Cilat janë natyra e vendimmarrjes në procedurën penale të kryesve me çrregullime mendore.

Metodologjia

Prezantim në PowerPoint duke diskutuar për raste praktike dhe praktiken e gjykatave në rajon si të avancohet zbatimi i dispozitave ligjore, diskutim në grupe për rastet hipotetike si dhe pyetje e përgjigje me pjesëmarrësit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimit do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Propozimi nga trajnuesi i përhershëm i AD-së
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

21. Ekstremizmi, Radikalizmi dhe Terrorizmi

Sistemi Gjyqësor dhe ai Prokurorial duhet të jete në gjendje që të zhvillojë kapacitete efektive dhe profesionale për të trajtuar veprat penale të natyrës së ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit, marrë për bazë se këto vepra penale cenojnë ende vlerat demokratike të një vendi dhe krijojnë përveç dëmeve konkrete edhe një frikë permanente në shoqëri e që në thelb trajtimi efektiv përbën edhe siguri publike dhe shtetërore. Andaj në këtë trajnim synohet që të trajtohen çështjet e elementeve të ekstremizmit dhe radikalizmit, kur këto dyja dallojnë dhe kur hyjnë në nivel të zonës që përbëjnë veprime kriminale dhe jo kategorizime të lirisë së shprehjes, si këto aspekte të radikalizmit dhe ekstremizmit përbëjnë element të dukshëm të rrezikut për terrorizëm, cilat janë masat që duhet krijuar dhe zbatuar në raport me ekstremizmin dhe terrorizmin për të parandaluar në shkaktim të akteve dhe veprimeve terroriste. Si funksionon aspekti i grupit terrorist dhe cilat janë kushtet ligjore për të konsideruara se kemi të bëjmë me vepra terroriste. Si bëhet financimi i terrorizmit dhe si bëhet ndërlidhjen grupet e organizuara kriminale në kryerjen e akteve të terrorizmit apo në financimin e terrorizmit.

Dallimi i aspekteve ligjore në elementet e shfaqjes së ekstremizmit dhe shprehjes së lirë, kriteret evidencuese të ekstremizmit me radikalizmin dhe dallimi i radikalizmit dhe ndikimi në terrorizëm. Mënyrat e funksionimit të grupeve terroriste dhe grupeve të organizuara kriminale dhe financimi i tyre në ndërveprime kriminale. Pranueshmëria e provave kur ato janë marrë për shkak të detyrueshmërisë së urgjencës për ndërhyrje në rastet e parandalimit të sulmeve terroriste.

Trajtimi i rasteve praktike për të bërë dallimet e elementeve ekstrem, radikal dhe të terrorizmit, trajtimi i rasteve hipotetike për zbatim efektiv të hetimeve të veprave dhe financimit të terrorizmit, zhvillim i rasteve hipotetike të strategjisë së hetimit për veprat penale të terrorizmit, prezantim në Power point në interpretim të dispozitave nga aspekti ligjor dhe procedural lidhur me pranueshmërinë e provave.

Objektivat

- ⇒ Te kuptojmë dallimet ndërmjet shprehjes së lirë dhe ekstremizmit në veprime që mund të kualifikohen si nxitje e urrejtjes dhe përçarjes;
- ⇒ Te kuptojmë ekstremizmin dhe radikalizmin në elementet dallues të tyre;
- ⇒ Te kuptojmë terrorizmin dhe veprat penale që kryhen në të gjitha format e saj, duke përfshirë grupin dhe individin si terrorist.

Përmbajtja

- Legjislacioni ndërkombëtar dhe vendor për luftimin e terrorizmit;
- Strategjia kombëtare kundër terrorizmit dhe masat që zhvillohen për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit;

- Terrorizmi si vepër penale, Grupi terrorist dhe individ në kryerjen e veprimeve terroriste;
- Mënyrat e financimit të terrorizmit dhe ndërveprimet me grupet e organizuara kriminale;
- Pranueshmeria e provave si raste specifike për shkak të natyrës urgjente, sanksionet penale dhe rëndësia për seancën për caktimin e dënimit.

Metodologjia

Trajtimi i rasteve praktike dhe hipotetike, Prezantim me PowerPoint, diskutim në grupe pyetje dhe përgjigje.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë tri (3) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KPK
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Punësoria për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

22. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Permes këtij trajnimi synohet avancimi i njohurive të pjesëmarrësve me sferën e bashkëpunimit juridik në çështjet penale dhe njohuritë me legjislacionin e brendshëm, marrëveshjet me shtetet tjera, si dhe instrumentet ndërkombëtare në sferën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Duke pasur parasysh faktin se shpesh herë veprat penale kryhen në disa vende e gjithashtu kemi situata kur autorë të veprave penale kryejnë vepra penale në vendin tonë apo shtetas të Kosovës kryejnë vepra penale në vendet e tjera, atëherë me qëllim të realizimit të zhvillimit me sukses të procedurës penale nevojitet ndihma juridike në çështje penale. Si bazë e realizimit të ndihmës juridike ndërkombëtare është legjislacioni vendor, përkatësisht Ligji nr. 04/L-213 – për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Gjithashtu me qëllim të realizimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar të rëndësishme janë edhe marrëveshjet e nënshkruara me shtete të veçanta me qëllim të realizimit efikas të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale. E rëndësishme është gjithashtu edhe përfitimi i njohurive përkitazi me legjislacionin relevant ndërkombëtar. Si çështje e rëndësishme në këtë temë dalin të jenë përcaktimi i kriterëve bazë të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, si dhe bazuar në marrëveshjet mes vendit tonë dhe vendeve tjera me qëllim të realizimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje penale. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën me theks të veçantë Serbia? Cilat janë instrumentet ndërkombëtare kryesore që Kosova i zbaton? Cilat janë mangësitë në legjislacionin vendos që e vështirëson? Cilat janë pengesat që hasën më së shpeshti në këtë fushë?

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth aspekteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në aspektin penal;
- ⇒ Avancimi i njohurive me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar në çështjet e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale;
- ⇒ Zbatimi në mënyrë të drejtë i dispozitave ligjore të legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar në sferën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Përmbajtja

- Diskutime lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar përkitazi me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar;
- Zbatimi i dispozitave relevante nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar;
- Ekstradimi;
- Kushtet e ekstradimit;
- Ndaletat në ekstradim, qëllimi i përfitimit apo shkaktimi i dëmit.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara duke filluar nga prezantimi nga ana e trajnuesit dhe gjithashtu do të përdoret metoda interaktive me qëllim të nxitjes së diskutimeve përmes rasteve praktike

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

23. Trafikimi me njerëz

Trafikimi me njerëz përbën një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe një sfidë serioze për sundimin e ligjit, sigurinë publike dhe shoqërinë në tërësi. Ai përfshinë shfrytëzimin e individëve – shpeshherë të pambrojtur dhe në kushte të cënueshme – përmes mashtrimit, forcës apo formave të tjera të kontrollit, për qëllime fitimprurëse, si puna e detyruar, shfrytëzimi seksual, trafikimi i organeve apo forma të tjera të shfrytëzimit. Trajnimi synon avancimin e njohurive për të identifikuar, trajtuar dhe ndjekur penalisht rastet e trafikimit me njerëz, në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare. Përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse trajnimi do të shqyrtojë kuadrin ligjor, mekanizmat e parandalimit, mbrojtjen e viktimave, si dhe bashkëpunimin institucional dhe ndërkombëtar në luftën kundër këtij fenomeni kompleks. Cilat janë shkaqet kryesore që e bëjnë një individ me të cënueshëm ndaj trafikimit? Çka e dallon trafikimin me njerëz nga kontrabanda me migrante? Cilat janë format me të përhapura të trafikimit? Cilat janë pasojat psikologjike shoqërore dhe ekonomike për viktimat? Çfarë mekanizmash ligjor ekzistojnë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për parandalimin e trafikimit?

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë drejtë infrastrukturën ligjore lidhur me Trafikimin me njerëz;
- ⇒ Identifikojnë elementet e veprës penale të Trafikimit me njerëz;
- ⇒ Bëjnë dallimin në mes të Trafikimit me njerëz dhe Kontrabandimit me migrantë;
- ⇒ Bëjnë dallimin ndërmjet trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit;
- ⇒ Zbatojnë procedurën për kompensimin e dëmit.

Përmbajtja

- Koncepti i trafikimit me qenie njerëzore;
- Elementet e veprës penale;
- Trafikimi i fëmijëve;
- Identifikimi i viktimave, hetimi dhe ndjekja penale;
- Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë;
- Kompensimi dhe mbështetja e viktimave

Metodologjia

Për realizimin e këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara, duke përfshi shpjegimin e shkurtër teorik, diskutimet interaktive, prezente në PowerPoint, diskutimin në grupe.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtor profesionalë, zyrtar policor, mbrojtësit e viktimave, hetuesit policor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për VNT për prokurorë 2026
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

24. Arsyetimi i vendimeve Gjyqësore, Mjetet Juridike dhe Parimi Reformatio in Peius

Një ndër detyrimet për një gjykim të drejtë është detyrimi i Gjykatës për arsyetimin e vendimeve Gjyqësore. Vendimmarrja në themel, në mungesë të cilësisë së arsyetimit të vendimeve gjyqësore përbën cenimin e Gjykimit të drejtë sipas Konventës për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut dhe sipas dispozitave Kushtetuese. Andaj, në kuadër të këtij trajnimi do të synohet që të sqarohen standardet që ka krijuar edhe GJEDNJ për nivelin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, çka duhet të përfshijë dhe si duhet ndërtuar një arsyetim i vendimit gjyqësorë që të jetë sa më bindës, qoftë ndaj palëve ashtu edhe për publikun e gjerë, duke marrë për bazë se transparenca e publikimit të vendimeve që është në sistemin gjyqësor i jep mundësi edhe publikut që të shikojë cilësinë e vendimeve gjyqësore. Nga ana tjetër, për të qenë një proces gjyqësor me efektivitet dhe zbatimin e drejtë të ligjit, duhet shqyrtuar nga të gjitha nivelet e gjykatave deri në përfundimin e tij ku shpeshherë rol të rëndësishëm i jepet edhe mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme, duke qenë se gjykata e nivelit të shkallës së dytë dhe Gjykata Supreme janë të kufizuar që të shqyrtojnë sipas detyrës zyrtare çështje që ka prekur zgjedhja e vendimit gjyqësor, andaj është e nevojshme që edhe mjetet juridike të trajtohen në kuadër të këtij trajnimi për standardet minimale që duhet paraqitur në mjetet juridike për të qenë efektive në zbatimin e drejtë të ligjit. Në praktikën gjyqësore ka pasur raste kur është shkelur edhe parimi reformatio in peius, varësisht kur çështja është kthyer në rigjykim ku Gjykata qoftë nga rrethanat e rigjykimit kanë bërë rikualifikime më të rënda apo edhe kur i kanë dhënë mundësinë prokurorit që të bëjnë rikualifikime për vepra më të rënda penale pasi që ankesa e mbrojtjes ka pasur sukses dhe vendimi i parë është anuluar. Andaj, në kuadër të këtij trajnimi do të trajtohen edhe këto probleme praktike për zbatimin efektiv dhe rigoroz të garancioneve në raport me të pandehurin që krijon ky parim dhe që janë të detyruara që ta zbatojnë si Gjykata ashtu edhe Prokuroria. Dilemat lidhur me nivelin e arsyetimit deri në çfarë pike ka detyrim gjykata që të arsyetoj vendimin për të përmbushur standardet ligjore dhe standardet ndërkombëtare për një gjykim të drejtë. Aspekte të praktikës gjyqësore dhe shmangia e të metave që si pasojë e arsyetimit të anulohen vendimet gjyqësore.

Gjatë trajnimit, do të trajtohet aspekti i standardeve të GJEDNJ-së, për arsyetimin e vendimeve, praktika e krijuar nga Gjykata Kushtetuese, praktika e vendimeve Gjyqësore.

Objektivat

- ⇒ Të arrijmë ngritjen e cilësisë dhe praktike unike për raste të ngjashme në arsyetimin e vendimeve;
- ⇒ Të njohim standardet e GJEDNJ-së për arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- ⇒ Të arrijmë ngritjen e cilësisë së mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme;
- ⇒ Të kuptojmë se kur duhet pasur kujdes në cenimin e parimit reformatio in peius.

Përmbajtja

- Pikat kyçe të arsyetimit të vendimeve gjyqësore;
- Niveli i arsyetimit në përputhje me standardet e GJEDNJ-së;
- Pikat kyçe dhe të forta për mjetet juridike efektive të rregullta dhe të jashtëzakonshme;
- Trajtimin e Parimit reformatio in peius me rastin e rikualifikimit apo ndryshimit të akuzës.

Metodologjia

Prezantim në PowerPoint, duke bërë diskutime dhe pyetje të drejtpërdrejta në raport me rastet që trajtohen në praktike si dhe kërkesat ligjore që janë për arsyetimin e vendimeve.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, Bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Strategjia për sundimin e ligjit
- Formulari për VNT 2025-pas trajnimit
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti i trajnuesve me rekomandime pas trajnimit
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

25. Hetimi dhe ndjekja penale e krimeve të luftës

Hetimi dhe ndjekja penale e krimeve të luftës në Kosovë paraqet një sfidë të re për sistemin e drejtësisë në vend. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës ka kaluar nëpër faza të vështira, dhe përpjekjet për të ndjekur penalisht dhe ndëshkuar kryesit e krimeve të luftës vazhdojnë ende. Duhet të kemi parasysh se krimet e luftës nuk janë vetëm çështje juridike; ato përfaqësojnë shkelje të rënda të moralit dhe të drejtave të njeriut, duke lënë pasojë të thella në shpirtin e viktimave dhe komunitetit që i përkasin dhe plagë që do të ndihen për shumë vite.

Gjatë këtyre 25 viteve, janë ndërmarrë përpjekje të mëdha për të sjellë përpara drejtësisë personat përgjegjës për krime gjatë luftës. Këto përpjekje kanë përfshirë krijimin e strukturave të drejta dhe të pavarura, mbështetjen për viktimat dhe sigurimin e një dokumentimi të saktë dhe të plotë të krimeve. Ndiurma ndërkombëtare dhe angazhimi i institucioneve vendore kanë qenë elemente kyçe në këtë proces, dhe ne mbetemi të përkushtuar që t'i mbështesim këto përpjekje me të gjitha resurset tona.

Në sistemin juridik të Kosovës, trajtimi i rasteve të krimeve të luftës bazohet në tri (3) korniza ligjore: (1) rregullat e së drejtës ndërkombëtare, (2) rregullat e së drejtës së ish-Jugosllavisë dhe (3) rregullat e së drejtës së Republikës së Kosovës.

Kosova, si vend që ka kaluar një luftë të armatosur të dokumentuar gjerësisht nga organizata ndërkombëtare dhe tribunale penale, përballlet me një realitet kompleks në trajtimin e dëshmive për krimet e luftës. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë proces janë:

- frika nga hakmarrja,
- presioni social dhe stigmatizimi,
- trauma e pazgjidhur,
- si dhe kalimi i kohës, që ndikon në besueshmërinë e kujtesës.

Në sistemet gjyqësore të pas-luftës, trajtimi i viktimave të krimeve të luftës nuk është vetëm një çështje procedurale, por edhe një akt drejtësie, respekti dhe humaniteti. Viktimat janë bartës të së drejtës për të kërkuar drejtësi, por edhe subjekte të cenueshme që kërkojnë mbrojtje të veçantë. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë një rol të pazëvendësueshëm në sigurimin e një trajtimi të ligjshëm dhe etik të viktimave gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Ky trajnim synon të rrisë kapacitetet profesionale të pjesëmarrësve përmes analizës së rasteve praktike vendore dhe ndërkombëtare të krimeve të luftës, mbi bazën e mangësive të identifikuar në praktikë, përfshirë edhe rastet që kanë marrë epilog gjyqësor.

Objektivat

- ⇒ Thellimi i njohurive mbi hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës;
- ⇒ Zgjerimi i njohurive mbi format e përgjegjësisë penale për krimet e luftës;
- ⇒ Trajtimi i përgjegjësisë komanduese si një formë specifike e përgjegjësisë penale;

- ⇒ Thellimi i njohurive mbi kornizën ligjore që rregullon hetimin dhe ndjekjen penale në mungesë për rastet e krimeve të luftës.
- ⇒ Thellimi i njohurive lidhur me rëndësinë e rolit të dëshmitarëve në rastet e krimeve të luftës;
- ⇒ Njohja e sfidave specifike që paraqiten gjatë marrjes së deklaratave;
- ⇒ Aplikimi i teknika të përshtatshme për marrjen e dëshmisë në përputhje me parimet e së drejtës penale dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare;
- ⇒ Të vlerësojnë rolin dhe të drejtat e viktimave gjatë procesit penal.
- ⇒ Të përdorin qasje të ndjeshme ndaj viktimave në rastet e ndjeshme, si dhuna seksuale gjatë luftës.
- ⇒ Të aplikojnë praktika konkrete për mbrojtjen e viktimave në proces, përfshirë masat e fshehtësisë, ndihmën psikologjike dhe përfaqësimin ligjor.

Përmbajtja

- Ndjekja penale e rasteve të krimeve të luftës në mungesë;
- Provat rrethore në vërtetimin e përgjegjësisë për rastet e krimeve të luftës;
- Korniza ligjore dhe praktike të procesit të marrjes së dëshmisë;
- Sfidat specifike të marrjes së deklaratës së një dëshmitari në rastet e krimeve të luftës;
- Rastet kur gjykata e ka vlerësuar një deklaratë të dëshmitarit;
- Korniza ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Roli i viktimës në procedurat penale në Kosovë;
- Reparacionet dhe kompensimi – kuadri ligjor dhe mundësitë praktike;
- Balancimi i të drejtave të të pandehurit me ato të viktimës;
- Praktika gjyqësore: Vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit të Kosovës;
- Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtarë për rastet e krimeve të luftës (Mekanizmave Rezidual për Tribunalet Ndërkombëtare me seli në Hagë).

Metodologjia

Trajnimi do të ekzekutohet përmes metodave të ligjërimit teorik, praktik dhe të kombinuar. Pjesëmarrësve do u jepen ushtrime praktike nga rastet e trajtuara në prokurori dhe do të kërkohet që të analizojnë dhe prezantojnë çështjet e evidentuara. Sesionet do të organizohen në punëtori individuale dhe grupore. Përmes kësaj metode synohet që pjesëmarrësi të përfshihet aktivisht në çdo çështje dhe në këtë mënyrë edhe do t'i forcojë njohuritë që posedon por edhe do të marr njohuri të reja në fusha të caktuara.

Përfituesit

Gjyqtarë, Prokurorë, Bashkëpunëtorë Profesional, Zyrtarë Ligjor, Hetuesit policor, Mbrojtësit e viktimave.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti nga takimi me gjyqtaret e fushës penale për të mitur
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

26. Veprat penale kundër integritetit seksual

Veprat penale kundër integritetit seksual, si temë kërkon një trajtim më të thelluar për të hequr dilemat të cilat shfaqen në praktik. Në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër integritetit seksual ndër të tjera parasheh një numër të konsiderueshëm të disa veprave penale që prekin dinjitetin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore nga ky kapitull shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët, duke përfshirë kujdesin gjatë marrjes së deklaratës së viktimës e posaçërisht në rastet kur viktimë është fëmija.

Cilat janë veprat penale kundër integritetit seksual? Cilat janë karakteristikat dalluese të këtyre veprave penale në mënyrë që të hiqen dilemat në rastin e kualifikimit të këtyre veprave penale? Cili është roli i prokurorit të shtetit në hetimin e këtyre veprave penale?

Gjatë trajnimit do të bëhen përpjekje maksimale që te këto vepra penale që kryhen ndaj fëmijëve të jepen sqarimet sa më përmbajtjesore në mënyrë që pjesëmarrësit të evitojnë dilemat dhe paqartësitë që shfaqen në praktik.

Objektivat

- ⇒ Zgjerimi i njohurive lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual;
- ⇒ Analizimi dhe format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave tjera lidhur me integritetin seksual;
- ⇒ Aplikimi i drejtë të dispozitave ligjore lidhur me këto vepra penale.
- ⇒ Zbatimi i kufizimit ligjor rreth marrjes së deklaratës së viktimës fëmijë dhe prezenca e përfaqësuesve të nevojshëm institucional;

Përmbajtja

- Dhunim, Sulmi seksual;
- Shërbime seksuale të viktimës së trafikimit;
- Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;
- Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.

Metodologjia

Interpretimi i dispozitave ligjore, diskutimi interaktiv i pjesëmarrësve në trajnim, trajtimi i praktikës dhe aplikimi i konventave ndërkombëtare, puna në grupe.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë, Mbrojtësit e viktimave, bashkëpunëtorë profesional, Zyrtarë Policor, Qendra për Punë Sociale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - OSBE

27. Luftimi i financimit të Terrorizmit

Si rezultat konkret i bashkëpunimit me Departamentin e Kërcënimeve Transnacionale / Njësinë e Veprimit Kundër Terrorizmit në Sekretariatit e OSBE-së në Vjenë, programi Trajnimi i Trajnerëve (ToT) mbi Luftimin e Financimit të Terrorizmit (CFT) filloi në Prishtinë më 13 Dhjetor 2022 dhe përfundoi në prill 2024. Projekti u financua nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe u zbatua nga OSBE-ja dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin "Programi Global kundër Pastrimit të Parave, të Ardhurave nga Krimi dhe Financimit të Terrorizmit (UNODC/GPML)". Programi u hartua për të rritur kapacitetin, për të parandaluar terroristët nga lëvizja, ruajtja, përdorimi dhe mbledhja e parave për qëllime terroriste, në përputhje me angazhimet dhe standardet ndërkombëtare. Në fund të këtij projekti, tetë (8) trajnerë vendas nga Kosova janë certifikuar si trajnerë mbi "Parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit". Të certifikuarit do të vazhdojnë të zhvillojnë trajnime për institucionet vendase brenda Akademisë së Drejtësisë dhe Akademisë për Siguri dhe Siguri Publike. Ata do të krijojnë platformën e tyre të trajnimit për Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Trajnimi mbi luftimin e financimit të terrorizmit (LFT) është një pjesë kyçe e përpjekjeve për të forcuar sistemin financiar dhe për të parandaluar përdorimin e tij nga individë apo grupe terroriste për qëllime të paligjshme. Lufta kundër financimit të terrorizmit është një pjesë thelbësore e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo përfshin një sërë masash ligjore, administrative dhe financiare që kanë për qëllim: parandalimin e mbledhjes së fondeve për qëllime terroriste; zbulimin dhe ndërprerjen e rrjedhës së parave që përdoren për të financuar veprime terroriste; dënimin e atyre që ndihmojnë, financojnë ose mbështesin organizatat terroriste.

Pikat kryesore të luftës kundër financimit të terrorizmit: Korniza Ligjore, Institucionet dhe mekanizmat monitorues, Roli i bankave dhe sektorit financiar, Masa ndërkombëtare, Pengesat dhe sfidat. Përdorimi i kriptomonedhave dhe sistemit informal të transferimit të parave (p.sh., Hawala); Organizatat bamirëse të infiltroar; mungesa e bashkëpunimit midis vendeve ose dobësitë në sistemet ligjore të disa shteteve.

Ky trajnim synon t'u ofrojë pjesëmarrësve njohuri, aftësi dhe praktika më të mira për të identifikuar, parandaluar dhe raportuar aktivitetet që lidhen me financimin e terrorizmit. Çfarë është financimi i terrorizmit? Cilat janë burimet më të zakonshme të financimit të terrorizmit? Cilat janë mekanizmat më të përdorur për të parandaluar financimin e terrorizmit? Cilat janë institucionet ndërkombëtare që e luftojnë këtë fenomen (si FATF, UN, EU, etj.)? Si përfshihen bankat dhe institucionet financiare në identifikimin e aktiviteteve të dyshimta?

A është më efektive parandalimi përmes mbikëqyrjes financiare apo ndëshkimi penal? A mund të cenohen të drejtat dhe privatësia e qytetarëve në emër të luftës kundër financimit të terrorizmit? A përdoret ndonjëherë kjo luftë si mjet politik ndaj grupeve opozitare apo minoriteteve? Si ndikon përdorimi i kriptomonedhave në kontrollin ndaj financimit të terrorizmit? A janë mjetet ekzistuese të mjaftueshme për të ndjekur transaksionet ndërkombëtare që financojnë terrorizmin?

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth konceptit të financimit të terrorizmit;
- ⇒ Zbatimi drejtë i kornizë ligjore dhe rregullator;
- ⇒ Identifikimi i rreziqeve dhe mënyrave të financimit;
- ⇒ Zbatimi i masave parandaluese;
- ⇒ Raportimi i transaksioneve të dyshimta;
- ⇒ Rastet studimore dhe praktikat më të mira;
- ⇒ Analiza e rasteve reale;
- ⇒ Diskutimi mbi dështimet apo sukseset e sistemeve të kontrollit.

Përmbajtja

- Hyrje në Luftën kundër Financimit të Terrorizmit;
- Korniza Ligjore dhe Rregullatore;
- Vlerësimi i Rrezikut dhe Zbulimi i Modeleve të Financimit të Terrorizmit;
- Masat Parandaluese dhe Kontrolli i Brendshëm;
- Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta (STR);
- Roli i Institucioneve Jo Financiare dhe OJQ-ve;
- Bashkëpunimi Ndërinstitucional dhe Ndërkombëtar;
- Raste Studimore dhe Ushtrime Praktike.

Metodologjia

Trajtimi i rasteve praktike dhe hipotetike, Prezantim me PowerPoint, diskutim në grupe pyetje dhe përgjigje.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, hetues nga Policia e Kosovës.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme

28. Trajtimi i Konfliktit të Interesit për Gjyqtarë dhe Prokurorë

Qëllimi i këtij trajnimi është të rrisë ndërgjegjësimin, njohuritë ligjore dhe aftësitë praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të identifikuar, deklaruar, parandaluar dhe menaxhuar rastet e konfliktit të interesit në përputhje me parimet kushtetuese, ligjore dhe etike. Përmes trajnimit, pjesëmarrësit do të thellojnë kuptimin e rrezikut që paraqet konflikti i interesit për pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e sistemit të drejtësisë. Konflikti i interesit nuk është vetëm çështje formale; ai është një test i besimit të publikut në drejtësi. Një gjyqtar apo prokuror, edhe nëse është i paanshëm në praktikë, duhet të shmang çdo konflikt qoftë ai edhe në dukje, pasi përceptimi publik është po aq i rëndësishëm sa realiteti. Trajnimi do të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë detyrimet ligjore, standardet ndërkombëtare (p.sh. Parimet e Bangalore-s, Opinionet e CCJE dhe CCPE, rekomandimet e GRECO-s), si dhe praktikatat më të mira në menaxhimin e situatave të konfliktit të interesit. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit do të angazhohen në diskutime dhe ushtrime rreth pyetjeve që lidhen direkt me punën e tyre, si: Si të identifikohet një konflikt interesi i mundshëm në një çështje gjyqësore apo hetimore? Çfarë duhet të bëjë gjyqtari/prokurori kur ka lidhje familjare, miqësore apo profesionale me një palë ose avokat? A konsiderohet konflikt interesi kur gjyqtari/prokurori ka marrëdhënie shoqërore me një palë, por jo përfitim financiar? Cilat janë pasojat ligjore dhe disiplinore në rast të mos deklarimit? Si ndikon një konflikt i përceptuar në imazhin e paanshmërisë së gjyqtarit/prokurorit? Si mund të balancohet ruajtja e jetës private me kërkesën për transparencë publike?

Objektivat

- ⇒ Shpjegojnë konceptin dhe llojet e konfliktit të interesit në gjyqësor dhe prokurori;
- ⇒ Avancojnë njohuritë rreth detyrimeve të tyre ligjore dhe etike për deklarimin e pasurisë, lidhjeve dhe interesave (bazuar në Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Kodin e Etikës për Gjyqtarë dhe Prokurorë);
- ⇒ Zhvillojnë aftësi për të identifikuar dhe raportuar situatat e mundshme të konfliktit;
- ⇒ Kuptojnë pasojat disiplinore dhe ligjore në rast të shkeljeve;
- ⇒ Promovojnë një kulturë integriteti dhe transparence, duke forcuar pavarësinë e sistemit gjyqësor.

Përmbajtja

- Hyrje në konceptin e konfliktit të interesit;
- Llojet e konfliktit të interesit;
- Korniza ligjore dhe nënligjore;
- Mekanizmat e deklarimit dhe menaxhimit;
- Pasojat ligjore dhe etike;
- Strategjitë e parandalimit.

Metodologjia

Diskutim interaktive, PowerPoint, të ndërlidhura me përvoja reale. Diskutime në grupe të vogla për situata të ndjeshme të konfliktit të interesit. Studime rastesh (case studies) nga praktika e gjyqësorit dhe prokurorisë. Role-playing dhe simulime: pjesëmarrësit vendosen në situata hipotetike për të marrë vendime etike.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- BE, Zyra në Prishtinë, projekti “Të Drejtat e Punës për të Gjithë” zbatuar nga ATRC

29. Hetimi dhe adresimi i rasteve të shkeljes së të drejtave të punës

Ky trajnim ka për fokus hetimin dhe adresimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të punës dhe synon ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe inspektorëve për të trajtuar në mënyrë efektive këto raste. Pjesëmarrësit do të trajtojnë legjislacionin vendor dhe acquis të BE-së mbi ndjekjen penale të shkeljeve të të drejtave të punës, duke u fokusuar në standardet evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Trajnimi përfshin studime rasti, ku pjesëmarrësit praktikojnë procedurat hetimore, mbledhjen e provave dhe përgatitjen e akuzave, duke pasur parasysh çasjet diskriminuese dhe mënyrat për eliminimin e tyre. Pjesëmarrësit gjithashtu do të punojnë mbi përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke garantuar koordinim efektiv ndërmjet prokurorëve, gjyqtarëve dhe inspektorëve të punës. Ky trajnim synon të rrisë aftësinë e prokurorëve si hetues dhe inspektorëve për zbatim më efektiv të ligjit, përmirësimin e çasjes në drejtësi për punëtorët dhe adresimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të punës në përputhje me standardet evropiane.

Objektivat

- ⇒ Zgjerimi i njohurive të prokurorëve dhe inspektorëve të punës për hetimin dhe trajtimin me efektivitet të rasteve të shkeljeve të të drejtave të punës.
- ⇒ Thellimi i kuptimit të praktikave të trajtimit të rasteve që përfundojnë me pasoja të rënda, përfshirë edhe ato me fatalitet.
- ⇒ Analizimi i kornizës ligjore dhe institucionale, me theks të veçantë tek afatet, procedurat penale dhe Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme.
- ⇒ Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse (Këshilli Prokurorial i Kosovës, Inspektorati i Punës, Gjykatat dhe organizatat e shoqërisë civile) për adresimin më efektiv të rasteve të shkeljeve.
- ⇒ Krahasimi me praktikatat më të mira ndërkombëtare, me qëllim nxjerrjen e mësimave dhe aplikimin e modeleve efektive për mbrojtjen e të drejtave të punës në Kosovë.

Përmbajtja

- Legjislacionin vendor mbi ndjekjen penale të shkeljeve të të drejtave të punës.
- Format e shkeljes së të drejtave të punës përfshirë: siguria dhe shëndeti në punë, rastet e lëndimeve dhe vdekjeve në vendin e punës.
- Procedurat penale dhe afatet për ndjekjen penale të shkeljeve të rregullave të punës.
- Raste studimi me shembuj të hetimeve të simuluar të shkeljeve të punës, duke përfshirë rastet me fatalitet.
- Mbledhja e provave, dokumentimi dhe përgatitja e aktakuzave.
- Realizimi i inspektimeve në vendin e punës në mënyrë efektive dhe të sigurt.
- Identifikimi i shkeljeve: kushte të pasigurta, shkelje të pagave, diskriminim, punë e fëmijëve.
- Bashkëpunimi ndër-institucional në hetimin e rasteve komplekse ose të atyre me pasoja fatale.

Metodologjia

Trajnimi do ti ofroj prokurorëve dhe inspektorëve të punës njohuri mbi praktikat e nevojshme për hetimin dhe trajtimin efektiv të shkeljeve të të drejtave të punës, përfshirë edhe rastet që përfundojnë me fatalitet. Metodologjia do të përfshijë: ligjerim interaktiv mbi legjislacionin kombëtar, analiza të rasteve studimore, të cilat u lejojnë pjesëmarrësve të eksplorojnë skenarë real dhe të kuptojnë procedurat hetimore dhe prokuroriale. Do të prezantohen simulime të rasteve ku inspektorët e punës praktikojnë inspektime në vendin e punës, identifikojnë shkeljet dhe dokumentojnë provat, ndërsa prokurorët fokusohen në rishikimin e provave, hartimin e aktakuzave dhe koordinimin e hetimeve. Trajnimi do të përkrahët nga projekti “Të Drejtat e Punës për të Gjithë” i cili mbështetet nga Zyrja e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe implementohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC).

Përfituesit

Prokurorë, bashkëpunëtorë profesionale dhe Inspektorati i Punës.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA CIVILE

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

1. Praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me rastin e vendosjes sipas mjeteve të goditjes së vendimeve

Tryeza ka për qëllim të adresojë të gjeturat nga Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas mjeteve të goditjes së vendimeve, e të cilat përfshijnë: çështjet e moszbatimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga gjykata më e lartë, gjykatave të instancave më të ulëta me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim; moszbatimi i Mendimeve Juridike, Udhëzuesve Juridik dhe Qëndrimeve Parimore të Gjykatës Supreme nga ana e gjykatave të instancave më të ulëta, e që kanë rezultuar me divergjencë të praktikës gjyqësore, me trajtim të pabarabartë të palëve në procedurë në çështje esencialisht të njëjta; si dhe situatat kur udhëzimet dhe rekomandimet e gjykatave më të larta me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim nuk janë të qarta, janë të përgjithësuara dhe konfuze për gjykatat e instancave më të ulëta dhe si të tilla paraqesin dilema se si të veprojnë gjykatat me rastin e shqyrtimit të rasteve në rigjykim. Një nga të gjeturat e identifikuar është se në disa raste gjykatat e instancave më të larta me rastin e shqyrtimit të rasteve sipas mjeteve të goditjes tejkalojnë kufijtë e ekzaminimit të këtyre mjeteve duke mos u kujdesur në respektimin e parimit “reformatio in pejus”. Çështjet për diskutim në këtë tryezë mund të jenë si në vijim: Kufijtë e ekzaminimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga ana e gjykatave të instancave më të larta. Të provuarit dhe mjetet provuese me rastin e kthimit të rasteve në rigjykim, Parimi “reformatio in pejus”, Zbatimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve nga gjykatat e instancave më të ulëta, Zbatimi i Mendimeve Juridike, Udhëzuesve dhe Qëndrimeve Parimore të Gjykatës Supreme.

Objektivat

- ⇒ Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- ⇒ Zbatimi unik i ligjeve procedurale dhe materiale;
- ⇒ Ngritja e efikasitetit dhe cilësisë në vendimmarrje.

Përmbajtja

- Procedura Kontestimore sipas mjeteve të goditjes;
- Të gjeturat e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me rastin e vendosjes sipas mjeteve të goditjes së vendimeve

Metodologjia

Metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

2. Praktikë gjyqësore në raste të shpronësimit dhe marrjes arbitrare të pronës

Instituti juridik i eksproprijimit, e që tani quhet shpronësim, deri në vitin 2009, ka qenë juridikisht i rregulluar me ligjin për eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 21/1978) me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tij, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë, Republika e Kosovës nxori Ligj tjetër me të cilin ka rregulluar juridikisht këtë institut juridik i cili quhet Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 52, datë 8 maj 2009 kur edhe ka hyrë në fuqi ky ligj. Tani ky ligj, përcakton autoritetet përgjegjëse dhe ndarjen e përgjegjësi në nivel qendror dhe komunal, përcakton kushtet dhe rregullat e procedurave për shpronësim, përcakton kushtet, rregullat dhe procedurat për kufizimin e shfrytëzimit të përkohshëm të pronës së paluajtshme, përcakton edhe kushtet, rregullat dhe kriteret e procedurave për caktimin e kompensimit. Si kundër Konventa Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe Liriët Themelore, ashtu edhe Neni 1 i Protokoli 1 i Konventës ka përcaktuar se ndërhyrja në të drejtat pronësore duhet të jetë i bazuar në ligj dhe se kjo duhet të jetë masë e fundit ndërhyrëse për arritjen e qëllimit të paraparë. Elemente të kërkuar sipas KEDNJ dhe Protokolit 1 të Konventës si dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për drejtat e njeriut janë: T’i shërbejë interesit të përgjithshëm, Ligji që cakton shpronësimin duhet të jetë i qasshëm dhe preciz, Shpërblimi –kompensimi duhet të jetë adekuat nga ana e shtetit ndaj personave, e drejta e pronësisë të cilëve është prekur. Në kuadër të kësaj do të përfshihet edhe çështja e kompensimit në rastet kur prona merret pa procedurë të shpronësimit (marrja arbitrare e pronës).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në kapitullin II të neni 46 paragrafi 3 lejon shpronësimin e pronës private, vetëm nëse është në interesin publik. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, shpronësimi mund të bëhet vetëm nëse është caktuar me ligj dhe nëse është i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat, prona e të cilave shpronësohet. Korniza ligjore e cila rregullon shpronësimin në Kosovë është Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e këtij Ligji). Para hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë, në Kosovë ka qenë e aplikueshme Ligji mbi eksproprijimin (Gazeta Zyrtare 21 /78 të Republikës së Kosovës). Me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme në mënyrë specifike parashikohen këto faza të cilat duhet të zbatojnë autoritet shtetërore: Caktimi i interesit të përgjithshëm, Punët përgatitore, Procedura e shpronësimit, Vendimi i kompensimit. Dilemat që janë shfaqur kanë të bëjnë me kompetencën kur atakohet vendimi preliminar, pastaj divergjenca me rastin e gjyqimit të diferencës së çmimit nga vlerësimi i organit shpronësues, kamata dhe llogaritja e saj si dhe humbja e vlerës dhe mënyra e të provuarit.

Objektivat

- ⇒ Analizojnë procedurat e shpronësimit;
- ⇒ Avancojnë njohuritë rreth procedurës së caktimit të kompensimit;
- ⇒ Të vlerësojnë se çka përfshinë kompensimi;
- ⇒ Të kuptojnë mënyrën e caktimit të kompensimit.

Përmbajtja

- Procedura e caktimit të lartësisë së kompensimit të shpronësimit;
- Kufizimet e të drejtës në pronë me KEDNJ dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Caktimi i kompensimit dhe pagesa e kompensimit;
- Kompensimi në rastet e marrjes arbitrare të pronës.

Metodologjia

Gjatë tryezës do të përdoren metodat interaktive të diskutimit dhe shtjellimit të rasteve, punë në grupe dhe do të zbërthehen raste praktike.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

3. Unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet pronësore

Tryeza për çështje pronësore ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale në fushën e të drejtës pronësore. Në tryezën për çështje pronësore do të trajtohen çështjet ma thelbësore në kuadër të së drejtës pronësore. Çështjet pronësore në vendin tonë tërheqin pas tyre një tërësi të gjerë problematikash duke filluar nga ato ligjore e deri tek praktika gjyqësore e zbatimit jo unik të ligjit material. Nisur nga rëndësia e marrëdhënieve pronësoro-juridike jo vetëm për qytetarët por edhe për vetë vendin, por edhe nga kompleksiteti dhe sfidat e kësaj fushe, kësaj tryeze duhet kushtuar rëndësia e duhur në programin e vazhdueshëm të arsimit ligjor. Ndryshimet ligjore që kanë ndodhur viteve të fundit lidhur me mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve pronësore, ndryshimi i sistemit shoqëror lidhur me konceptin e pronës dhe llojet e pronës, transaksionet joformale të transferimit të pronësisë, mos shqyrtimi i trashëgimisë, *etj.*, kanë ndikuar që numri i rasteve të jetë tejet i madh në gjykata tona. Praktika gjyqësore përballet me sfida të mëdha të cilat nuk kanë adresuar në mënyrë unike në sistemin gjyqësor, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejtë në sigurinë juridike. Gjykata Supreme e Kosovës në kuadër të jurisdiksionit të saj si gjykata e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimmarrjes në nivelet tjera gjyqësore, synon që përmes kësaj tryeze të organizuar nga Akademia e Drejtësisë të mbështes drejtpërdrejtë rritjen e performancës gjyqësore përmes rritjes së efikasitetit, cilësisë, zbatimit unik të dispozitave ligjore në mënyrë që puna e gjykatave të jetë objektive, ligjore dhe e besueshme. Temat e përfshira për këtë tryezë janë një përzgjedhje e kujdesshme e çështjeve më të rëndësishme dhe më aktuale, të cilat përmbledhen në: Fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, të drejtës së ndërtimit dhe trashëgimisë. Arsyeshmëria e fokusimit në këto baza është për shkak të nevojave imediate si rezultat i praktikave jo unike, duke synuar në unifikim të praktikave gjyqësore që do të siguronin parimin e sigurisë juridike.

Punimet tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve pronësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Punimet e tryezës duhet të mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve pronësore, për çka moderatorët duhet të jenë të përgatitur për të dhënë komentet e tyre të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe dispozitat ligjore për të gjitha çështjet e fushës që trajtohen. Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Panelistët duhet të jenë të përgatitur dhe të hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur me temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitik të çështjes përkatëse por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshme që dalin nga rasti që diskutohet. Adresimi i secilës çështje/temë të përmbledhur në këtë tryezë duhet të bëhet edhe përmes një prezantimi të fare të shkurtës (teorik) të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht duhet të pasohet me shembuj për secilën temë/çështje. Shembjet duhet të jenë të përzgjedhur me kujdes dhe duhet të kenë mbështetje në një praktikë gjyqësore të konsoliduar. Në fund të punimeve në tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultatet e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje

që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Tryeza synon eliminimin e divergjencave në vendimmarrje duke u bazuar në problemet e identifikuara.

Fitimi i Pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues, legjislacioni i aplikueshëm), ndërtimit (kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e të drejtës së ndërtimit sipas LMTHJP-së, ndërtimi përtej kufirit sipas LPTDS-së) dhe trashëgimisë (kushtet ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, rendet ligjore sipas LTK-së dhe anulimi i punëve juridike për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme).

Objektivat

- ⇒ Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- ⇒ Zbatimi unik i ligjeve;
- ⇒ Ngritja e cilësisë në vendimmarrje.

Përmbajtja

- E drejta në Pronës;
- Bazat e fitimit të së drejtës së pronësisë dhe
- Mbrojtja gjyqësore.

Metodologjia

Metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

4. Unifikimi i praktikës gjyqësore në kontestet për kompensimi e dëmit dhe parashkrimin

Numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, veçanërisht dëmit jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë indikator që tregojnë se kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet. Mbrojtja juridiko-civile e të mirave dhe ekzistimi i përgjegjësisë juridike civile (nëse dikush i cenon këto të mira) është segment i rëndësishëm në kuadër të sigurimit të një niveli më të lartë të mbrojtjes së të mirave njerëzore të mbrojtura juridikisht. Përcaktimi i saktë i përgjegjësisë së shkaktarit të dëmit dhe të realizimit të drejtës së palës së dëmtuar në shpërblimin e dëmit, në marrëdhënien juridike civile jo kontraktuale është një prej sfidave të gjyqtarëve të fushës civile.

Ndonëse praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë temë, mirëpo numri i madh i rasteve nëpër gjykatat e Kosovës, ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore sidomos sa i përket kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material, por edhe mënyra e vërtetimit të gjendjes faktike në këto raste shpesh ka të meta. Baza e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit material dhe jo material? Cilat janë kriteret për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material? Si provohet gjendja faktike në procedurën e shpërblimit të dëmit material dhe jo material? Si të bëhet zbatimi në praktikë i dispozitave materiale në rastet konkrete të kontestet për shpërblimin e dëmit material dhe jo material? Cila është praktika për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material? Tematika e trajnimit është strukturuar në mënyrën që t’iu përgjigjet pyetjeve dhe paqartësive të ngritura më lartë përmes analizës së të gjitha dispozitave materiale juridike që i referohen shpërblimit të dëmit material dhe jo material.

Në praktikën gjyqësore kemi dilema dhe vendimmarrje ndryshe sa i përket institutit të parashkimit në marrëdhëniet detyrimeve në veçanti në rastet e shpërblimit të dëmit, regresit si dhe shërbimeve komunale. Dilemat dhe vendimmarrja ndryshe kryesisht i referohet llogaritjes së parashkrimit (kur fillon afati i parashkrimit, kur ndërprehet apo ndalet?) Po ashtu në praktikën gjyqësore janë identifikuar dilema dhe vendimmarrje ndryshe në rastet e paraqitura që i referohen kërkesave për kompensimin e dëmit-gjegjësisht fitimit të humbur, të provuarit dhe mjetet provuese si dhe vlerësimi i kushteve me rastin e ndryshimit të vendimeve që i referohen kësaj kategorie të dëmit.

Tryeza synon eliminimin e divergjencave në vendimmarrje duke u bazuar në problemet e identifikuar. Çështjet për diskutim në këtë tryezë mund të jenë si në vijim: Dëmi Jo material, shpërblimi në të holla, specifikimi i kërkesave për kategoritë kompensuese sipas LMD-së, baza juridike, caktimi i lartësisë së kërkesëpadisë si dhe kriteret për caktimin e lartësisë për shpërblimin në të holla. Parashkrimi në marrëdhëniet e detyrimeve, llogaritja e afatit të përshkrimit, ndërprerja dhe ndalja e parashkrimit. Fitimi i humbur, renta e arritur dhe renta për të ardhmen, të provuarit dhe mjetet provuese dhe ndryshimi i vendimeve që i referohen fitimit të humbur.

Objektivat

- ⇒ Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- ⇒ Zbatimi unik i ligjeve;
- ⇒ Ngritja e cilësisë në vendimmarrje.

Përmbajtja

- Shpërblimi i dëmit jo material dhe praktika gjyqësore;
- Parashkrimi;
- Fitimi i Humbur.

Metodologjia

Në këtë tryezë do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, të përcjella me shembuj praktik dhe diskutime të përbashkëta, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimit.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

5. Unifikimi i Praktikës Gjyqësore në rastet nga procedura Përmbarimore

Gjykata Supreme me rastin e shqyrtimit të mjetit të jashtëzakonshëm, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ka identifikuar praktikë jounike në vendimmarrjen në rastet e procedurës përmbarimore. Si çështje të identifikuara janë: ekzaminimet nga ana e organit përmbarues me rastin e lejimit të propozimit për përmbarim, pastaj ekzaminimin nga ana e Gjykatës Themelore me rastin e shqyrtimit të prapësimit, si dhe ekzaminimi dhe kufijtë e ekzaminimit sipas ankesës nga ana e Gjykatës së Apelit.

Praktikat e ndryshme të vendimmarrjes nga ana e gjykatave themelore por edhe nga ana e Gjykatës së Apelit në rastet përmbarimore cenojnë sigurinë juridike kur merret për bazë fakti se krejt procedura mbështetet në Parimin e Rigorozitetit Formal Juridik si dhe parimin e mbrojtjes së dinjitetit të debitorit. Në praktikë ende ka dilema në raport me titujt përmbarimor, pastaj detyrimet e organit përmbarues në raport me vlerësimin dhe ekzaminimin e propozimit për përmbarim, përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor etj.

Tryeza përmes diskutimeve të rasteve praktike do të ofron pasqyrë të qartë përmes së cilës synohet arritja e harmonizimit të qëndrimeve të instancave më të ulta në mënyrë që të kemi unifikim të praktikës në rastet përmbarimore që përbën edhe garantim të sigurisë juridike.

Në tryezë do të trajtohen çështjet ma thelbësore të procedurës së përmbarimit si për raste kur procedura fillohet tek përmbaruesi privat, ashtu edhe për raste kur procedura fillohet tek gjykata, pa përjashtuar edhe çështjet që lidhen me zbatimin e përmbarimit si dhe procedurën sipas mjeteve të goditjes si dhe procedura në rastet e kundër përmbarimit. Nevoja për mbajtjen e një tryeze të tillë diktohet nga numri i madh i rasteve që kthen në rishqyrtim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës konetstimore dhe përmbarimore dhe nga nevoja e unifikimit të praktikës gjyqësore për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tryeza do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale. Punimet e tryezës do të zhvillohen sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së zbatimit të dispozitave të procedurës përmbarimore.

Tryeza është dizajnuar që të zhvillohet në një ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike. Prezantimi i temave do të bëhet përmes paraqitjes së një apo disa rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që duhet të trajtohet sipas agjendës. Për parashtrimin e rastit moderatori duhet të marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, të parashtrij disa pyetje/dilema mbi të cilat do të zhvillohet diskutimi dhe do të konsumohet tema. Moderatori duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastin/rastet e ndërlidhur me temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitik të çështjes përkatëse, por, duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshëm që dalin nga rastin që diskutohet. Në fund të punimeve në tryezë moderatorët duhet të hartojnë një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Raporti do të shërbej për të shpërndarë rezultate e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje që duhet të përfshihet në programet e akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objektivat

- ⇒ Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Procedurën Përmbartimore të Kosovës;
- ⇒ Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- ⇒ Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja

- Fillimi i procedurës së përmbartimit, kompetenca dhe vendimet e organit përmbartues;
- Titujt përmbartimor sipas dispozitave të LPP-së;
- Mjetet, objekti dhe zbatimi i përmbartimit;
- Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme në procedurën e përmbartimit.

Metodologjia

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë
- BE, Zyra në Prishtinë, projekti “Të Drejtat e Punës për të Gjithë” zbatuar nga ATRC

6. Mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës

Tryeza për mbrojtjen gjyqësore në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, sipas Ligjit të Punës, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës së punës. Në këtë tryezë ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth procedurës së filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t’i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në konteste të tilla, procedurën e gjykatës dhe llojet e vendimmarrjes së kësaj të fundit lidhur me këto konteste. Çështjet për diskutim mund të jenë si në vijim: Cilat janë llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës? Cilat janë shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës sipas Ligjit të Punës? Cila është procedura para ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit? Cilat janë mjetet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtje gjyqësore? Cilat janë afatet ligjore për sigurimin e mbrojtjes gjyqësore te kontestet e punës? Cilat janë vendimet gjyqësore të gjykatës në kontestet e punës? *etj.* Trajnimi do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore.

Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Rastet e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Objektivat

- ⇒ Zgjerojnë njohuritë lidhur me kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- ⇒ Identifikojnë legjislacionin e zbatueshëm vendor dhe ndërkombëtar në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- ⇒ Dallojnë kontestet për nëpunësit e shërbimit civil dhe kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- ⇒ Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Përmbajtja

- Kontratat e punës dhe llojet e tyre;
- Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës;
- Respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore;
- Zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive dhe Sektoriale.

Metodologjia

Gjatë tryezës do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, me fokus të prezantimit të çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi. Tryeza do të përkrahët nga projekti “Të Drejtat e Punës për të Gjithë” i cili mbështetet nga Zyrja e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe implementohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC).

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

7. Mbrojtja gjyqësore në rastet e shpifjes dhe fyerjes

Praktika gjyqësore në rastet e trajtimit të shpifjes dhe fyerjes ka identifikuar disa sfida që i referohen aspektit të të provuarit, cilësisë së vendimmarrjes dhe referimit në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Cilësia e vendimmarrjes në rastet e tilla nuk korrespondon me standardet e kërkuara ndërkombëtare e që kjo pastaj përbën trajtim jo të duhur të çështjes. Përmes këtij trajnimi që do të mbështetet në praktikën më të mira të GJEDNJ-së, synohet të arrihet në trajtimin konform standardeve, pastaj si fokus do ta ketë aspektin e të provuarit në rastet e shpifjes dhe fyerjes në kuptim të përcaktimit të lartësisë së kompensimit, përgjegjësisë dhe të provuarit e përgjegjësisë, ndarjen e përgjegjësisë si dhe masat mbrojtëse në raste të tilla.

Objektivat

- ⇒ Njohin konceptin e shpifjes dhe fyerjes;
- ⇒ Zbatojnë drejtë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;
- ⇒ Njohin përgjegjësit dhe sanksionet në gazetari, përmbajtja e modulit të trajnimit;
- ⇒ Koncepti për shpifjen;
- ⇒ Korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare;
- ⇒ Legjislacioni vendor lidhur me masat e përkohshme të sigurisë;
- ⇒ Shpifja dhe fyerja ndërlidhur me interesin publik;
- ⇒ Aplikimi i standardeve ligjore;
- ⇒ Përgjegjësitë dhe sanksionet në gazetari.

Përmbajtja

- Ushtrimi i padisë për shpifje dhe fyerje;
- E drejta për shpërblimin e dëmit jo material në rastin e shpifjes dhe fyerjes;
- Praktika Gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Metodologjia

Metoda specifike të trajnimeve për profesionistë ligjorë do të aplikohen për këtë trajnim, do të përdoren ushtrime në grup, prezantime në PP, raste studimore. Trajnimi do të bazohet në tërësi në manualin e trajnimit të zhvilluar nga projekti JUFREX.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Apelit dhe gjykatave themelore.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

8. Shqyrtimi paraprak i padisë

Shqyrtimi paraprak i padisë shënon fillimin e aktivitetit të gjykatës për përgatitjen e shqyrtimit kryesor. Shpesh ndodhë që në praktikën gjyqësore të mos i kushtohet rëndësi kësaj faze të procedurës përkatësisht të mos merren masat e duhura nga gjykata për të verifikuar se a janë plotësuar prezumimet procedurale për zhvillimin e procedurës kontestimore. Shqyrtimi paraprak i padisë është një filtër që i ndihmon gjykatës në eliminimin e të gjitha pengesave në mënyrë që të vazhdohet me faza të tjera të procedurës. Në këtë kuptim është me rëndësi që gjyqtarët e fushës civile të avancojnë njohurit e tyre lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë në mënyrë që të zbatojnë në mënyrë korrekte dispozita e Ligjit për Procedurën Kontestimore sa i përket verifikimit të plotësimit të prezumimeve procedurale dhe atë: Prezumimeve lidhur me gjykatën, palët dhe me objektin e kontestit si dhe prezumimet lidhur me rregullsinë e padisë. Pastaj veprimet procedural që detyrohen të ndërmarrin gjyqtarët deri në fazën e caktimit të seancës për shqyrtim kryesorë të çështjes.

Objektivat

- ⇒ Të zgjerojnë njohurit lidhur me padinë dhe përmbajtjen e saj;
- ⇒ Interpretojnë dhe zbatojnë drejtë dispozitat e LPK-së lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë;
- ⇒ Përcaktojnë veprimet për vendimet e gjykatës;
- ⇒ Njohin dhe dallojnë vendimet që merren në këtë fazë të procedurës.

Përmbajtja

- Prezumimet procedurale lidhur me palët;
- Prezumimet procedurale lidhur me kompetencën;
- Prezumimet procedurale lidhur me objektin;
- Bashkëndërgjyqësia dhe pjesëmarrja e personit të tretë.

Metodologjia

Gjatë kësaj tryeze do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Kohëzgjatja

Tryeza do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme
- Rekomandim nga KGJK-ë

9. Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm veçanërisht në raste familjare dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit - raste praktike

Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, zhvillimi i saj në ndërmjetësim të detyrueshëm dhe aprovimi ose anulimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit - raste praktike, ka për qëllim të ofrojë sqarime të detajuara për procedurën e ndërmjetësimit, duke filluar nga momenti i referimit të lëndës, sqarimin e zhvillimit të saj në ndërmjetësim të detyrueshëm, veçanërisht në rastet familjare, si dhe të përshkruajë procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe efektin e tyre në praktikë. Trajnimi synon që për temën e propozuar, të u sqaroj dhe të ju ndihmojë gjyqtarëve të kuptojnë apo interpretojnë drejtë dispozitat ligjore të cilat lënë hapësirë për dykuptimësi dhe të shtjelloj zbatimin e pa unifikuar këtyre dispozitave nga ana e gjyqtarëve që trajtojnë lëndët e tilla.

Nevoja për organizimin e një cikli të tillë të trajnimeve, me temën e propozuar, rrjedhë nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nga sfidat praktike të adresuara nga gjyqtarët. Trajnimi synon të arrijë ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve që kanë përfunduar trajnimin fillestar dhe atyre që nuk kanë marrë pjesë në ciklet e mëparshme të këtyre trajnimeve. Qëllimi është që ata të trajtojnë me efikasitet rastet civile dhe të ofrojnë zgjidhje për sfidat që hasen gjatë procedimit të rasteve në ndërmjetësim, si dhe në ushtrimin e kompetencës së tyre lidhur me vlefshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësimit. Kjo përfshinë harmonizimin e praktikave gjyqësore dhe zbatimin e qëndrueshëm të dispozitave ligjore.

Cilat janë sfidat më të mëdha për gjyqtarët gjatë referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, gjatë procedurës së aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit? Cilat janë sfidat e procedurës së referimit të lëndëve për të cilat parashihet Ndërmjetësimi i detyrueshëm? Cilat janë dilemat e gjyqtarëve në ushtrimin e kompetencës së tyre gjatë vlerësimit të vlefshmërisë së marrëveshjeve të ndërmjetësimit? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e përpilimit të marrëveshjeve nga ana e ndërmjetësuesve? Mënyra më efikase e kuptimit të koncepteve sipas këtij trajnimi, është biseda interaktive me gjyqtarët nëpërmjet shtrimit të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve ashtu që, mes shembujve praktik mund të zgjidhen dilemat që mund të dalin.

Objektivat

- ⇒ Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit;
- ⇒ Zbatojnë drejtë bazën ligjore të ndërmjetësimit;
- ⇒ Unifikojnë praktikën e referimit, aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të arritura përmes ndërmjetësimit;
- ⇒ Qartësojnë procedurën e referimit të rasteve familjare në procedurën e ndërmjetësimit;
- ⇒ Unifikojnë referimin e kontesteve për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm;
- ⇒ Unifikojnë zbatimin e Protokollit për Ndërmjetësim.

Përmbajtja

- Referimi i lëndëve të përshtatshme në procedurën e ndërmjetësimit-raste praktike;
- Procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit;
- Ndërmjetësimi i detyrueshëm, me fokus të veçantë tek rastet familjare;
- Sfidat në implementimin e Ligjit për Ndërmjetësim;
- Sfidat në implementimin e Protokollit për Ndërmjetësim.

Metodologjia

Trajnimi do zhvillohet përmes diskutimit interaktiv, aplikimit të shembujve më të mirë në praktik që japin sqarime adekuate të procesit të referimit, aprovimit ose refuzimit të marrëveshjeve të arritura në ndërmjetësim, ndërmjetësimin e detyrueshëm. Gjatë trajnimit do të paraqiten raste praktike në të cilët gjyqtarët duhen dhënë përgjigje apo opinione të tyre, ashtu që kuptimi i procedurës së ndërmjetësimit të jetë sa më lehtë i kapshëm.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore dhe degëve, si dhe ndërmjetësuesit e regjioneve të atyre gjykatave.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA E
DREJTËSISË PËR FËMIJË***

Aspekti Civil

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën gjyqësore të shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje

Trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurën gjyqësore të shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), si dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjithashtu do të diskutohet rreth besimit të fëmijës njërit prind, caktimit të lartësisë së alimentacionit, caktimit të kontakteve personale të fëmijës me njërin prind, mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në këto raste, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë parimet dhe procedura për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi, në rastet e besimit të fëmijës njërit prind, pagimin e alimentacionit dhe caktimin e kontakteve personale? Cili është legjislacioni ndërkombëtar i aplikueshëm në këto raste? Mbi çfarë kritere vendos gjykata në rastet e besimit të fëmijës, caktimit të lartësisë së alimentacionit, si dhe caktimit të kontakteve personale të fëmijës me njërin prind ? Cilat janë mënyra dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurën gjyqësore të shkurorëzimit? Si trajtohet dhe cila është pesha e mendimit të fëmijës në këtë procedurë? Cilat janë pasojat e fëmijëve si pasojë e dhunës në familje? Kush mund të kërkojë një urdhër mbrojtjeje? Çfarë informacioni duhet të përfshijë kërkesë-padia? Kush njoftohet për urdhrin e mbrojtjes? Trajnimi do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore.

Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve familjare, me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurë gjyqësore të shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë, por edhe raste nga praktika e GJEDNJ-së, e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit, besimit të fëmijës, alimentacionit dhe caktimit të kontakteve personale, si dhe në rastet e dhunës në familje etj. Lidhur me rastet e përzgjedhura, trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Objektivat

- ⇒ Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës, të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe dhunës në familje;
- ⇒ Unifikimi i praktikave në gjykatat e instancave më të ulëta;
- ⇒ Identifikimi dhe adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja

- Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar;
- Kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve dhe parimet për përcaktimin e alimentacionit;
- Caktimi i kontakteve personale, si dhe masat e përkohshme sipas LFK;
- Dhuna në familje, urdhri për mbrojtje dhe procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, në rastet kur pjesëmarrës janë fëmijët;
- Llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre,
- Ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje, në raport me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

2. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve në rastet e kundërshtimit apo vërtetimit të amësisë/atësisë

Trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e kundërshtimit apo vërtetimit të amësisë/atësisë, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjithashtu do të diskutohet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe rritet e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për tu njohur dhe vërtetuar e drejta e amësisë dhe atësisë? Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen dhe procedura gjyqësore që duhet të zhvillohet në rastet e kundërshtimit të atësisë apo amësisë? Cilat janë aktet vendore dhe ndërkombëtare që zbatohen në procedurën e vërtetimit/kundërshtimit të amësisë/atësisë? Cilat janë efektet e njohjes apo kundërshtimit të atësisë/amësisë në raport me fëmijën? *etj.*

Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore në procedurën për mbrojtjen e fëmijëve me rastin e ndryshimit të statusit të tyre. Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve familjare, me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me rastin e ndryshimit të statusit të tyre në procedurë gjyqësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Rastet e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara por, edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Objektivat

- ⇒ Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me rastin e ndryshimit të statusit të tyre;
- ⇒ Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- ⇒ Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja

- Amësia dhe atësia;
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës, statusi dhe pozita e tij juridike;
- Të drejtat trashëgimore të fëmijëve të cilëve iu ndryshohet statusi juridik;
- Zbatimi në praktikë i dispozitave të LFK dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

3. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në procedurë gjyqësore

Trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Gjithashtu do të diskutohet rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për tu lejuar adoptimi i fëmijës? Cila është procedura ligjore që duhet të ndiqet nga prindi adoptues për të adoptuar një fëmijë? A mund të adoptohen fëmijët shtetas të Kosovës nga shtetasit e huaj? Cilat janë aktet ndërkombëtare që zbatohen në procedurën e themelimit të adoptimit? Cilat janë format tjera të përkujdesjes prindërore të parapara me LFK? Si vlerësohet interesi më i lartë i fëmijës në këtë procedurë? Cilat janë metodat e komunikimit me fëmijët në procedurën e adoptimit? Rëndësia e dhënies së pëlqimit të prindit biologjik dhe fëmijës, si dhe zëvendësimi i pëlqimit kur plotësohen kushtet ligjore? Procedura gjyqësore dhe vendimmarrja tek rastet e adoptimit? Cili është roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Organit të Kujdestarisë tek adoptimi, përfshirë edhe atë me element ndërkombëtar?

Trajnimi do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore në procedurën e themelimit të adoptimit dhe jo vetëm. Trajnimi do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve familjare, me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në procedurë gjyqësore. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Objektivat

- ⇒ Identifikimi i sfidave për zbatimin e dispozitave të ligjit për Familjen i Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- ⇒ Identifikimi i praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta;
- ⇒ Adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore, si konkluzion.

Përmbajtja

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- Adoptimi, procedura në gjykatë dhe vendimmarrja;
- Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Organit të Kujdestarisë;
- Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore;
- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore, Organi i Kujdestarisë (QPS), Mbrojtësit e Viktimave, Zyrtarët për Ndihmë Juridike Falas.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Aspekti Penal

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Procedura penale ndaj madhoreve për veprat penale të kryera ndaj të miturve me fokus në mbrojtjen e viktimave të mitur dhe mbledhja e provave

Kodi i drejtësisë për të mitur (KDM) në Nenin 108 ka paraparë një numër të veprave penale për të cilat kompetente është gjykata themelore, Departamenti për të Mitur, të cilat vepra i gjykon gjyqtari për të mitur apo trupi gjykues për të mitur, në rastet kur procedura penale zhvillohet për personat madhor që kanë kryer njëren apo më shumë vepra penale të parashikuara me nenin 108 të Kodit të Drejtësisë për të mitur. Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore shpesh herë paraqitet si sfidë për gjyqtarët dhe prokurorët për të mitur duke përfshirë kujdesin gjatë marrjes së deklaratës së viktimës kur viktimë e njëres nga këto vepra penale është fëmija. Cilat janë veprat penale të parapara ne nenin 108 të Kodit të drejtësisë për të mitur? Si hetohen këto vepra penale? Cilat janë vështirësitë që ndikojnë ne gjykimit të këtyre rasteve? Ky program trajnimi, adreson pyetjet duke analizuar këto vepra penale si dhe procedurën penale që zhvillohet ndaj madhoreve që kanë kryer veprat penale ndaj fëmijëve.

Objektivat

- ⇒ Zgjerimi i njohurive lidhur me veprat penale të parapara ne nenin 108 të KDM;
- ⇒ Aplikimi i drejtë i dispozitave ligjore lidhur me këto vepra penale;
- ⇒ Zbatimi i kufizimit ligjor rreth marrjes së deklaratës së viktimës fëmijë dhe prezenca e përfaqësuesve të nevojshëm institucional.

Përmbajtja

- Veprat penale dhe hetimi i tyre (neni 108 të KDM);
- Gjykimi i këtyre veprave penale;
- Intervistimi i fëmijëve që janë viktimë të krimeve kundër integritetit seksual si dhe veprës penale trafikim me njerëz;
- Ekzaminimi mjeko-ligjor i viktimave fëmije.

Metodologjia

Interpretimi i dispozitave ligjore, diskutimi interaktiv i pjesëmarrësve në trajnim, trajtimi i praktikës dhe aplikimi i konventave ndërkombëtare, puna në grupe.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për të mitur, mbrojtësit e viktimave, bashkëpunëtor profesional, zyrtar policor, qendra për punë sociale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

2. Roli i prokurorit dhe gjyqtarit për të mitur në shqiptimin e sanksioneve penale

Sipas kodit të drejtësisë për të mitur-KDM, prokuror i shtetit për të mitur është ekspert në çështjet penale ku është i përfshirë i mituri, fëmiu dhe madhori i ri, ndjekjen e kryerësve madhorë për veprat e kryera ndaj të miturve. Andaj, roli i prokurorit është shumë i rëndësishëm në procedurën penale që zhvillon ky aktor për ndërmarrjen e veprimeve hetimore të qëndrojnë gjithmonë brenda caqeve ligjore të rëndësishme për zhvillimin e procedurës përgatitore. Po ashtu, rolin permanent që ka gjykata në mbrojtjen e të drejtave procedurale të të miturve dhe në gjykimin e rasteve kur ndaj të miturit zhvillohet procedura penale ndaj tyre.

Cili është roli i prokurorit të shtetit për të mitur? Cili është roli i gjykatës në garantimin e të drejtave procedurale të të miturit gjatë procedurës përgatitore? Cilat janë vështirësitë dhe dilemat që shfaqen në praktik të gjyimit të të miturve përshkak të karakteristikave dalluese që ka? Ky program trajnimi pra, adreson pyetjet duke analizuar çështjet problematike që shfaqen në praktik me qëllim të eliminimit dilemave rreth rolit të prokurorit për të mitur në procedurën penale që zhvillohet ndaj të miturit si dhe rolin e gjykatës në shqiptimin e masave edukative dhe dënimeve që shqiptohen ndaj të miturit.

Objektivat

- ⇒ Saktësojnë kompetencat e prokurorit të shtetit për të mitur në procedurën penale;
- ⇒ Zbatojnë drejt dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe akteve ndërkombëtare të cilat është i obliguar që të zbatoj;
- ⇒ Përcaktojnë se për cilat raste mund të shqiptohen masat apo dënimet ndaj një të miturit.

Përmbajtja

- Roli i prokurorit në procedurën penale që zhvillohet ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin;
- Roli i gjyqtarit për të mitur në procedurën penale dhe karakteristikat e gjyimit për të mitur;
- Masat e Diverzitetit;
- Masat edukative dhe dënimet që shqiptohen nga gjykata.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodologjia interaktive në formë të diskutimit e kombinuar me raste praktike.

Përfituesit

Gjyqtarë për të mitur, prokurorë për të mitur, zyrtarë nga Shërbimi Sprovues.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

3. Procedura për të mitur

Procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin duke përfshirë, karakteristikat e procedurës penale që kanë të bëjnë me të miturit shtron nevojën e trajtimit të ecurisë dhe karakteristikave dalluese që ka kjo procedurë në krahasim me procedurën penale që zhvillohet ndaj madhorëve (siç është konfidencialiteti, urgjenca, mbrojtja që duhet ti sigurohet të miturit gjatë gjithë procedurës etj). Po ashtu, rolin permanent që ka gjykata në mbrojtjen e të drejtave procedurale të të miturëve në gjykimin e rasteve kur ndaj të miturit zhvillohet procedura penale ndaj tyre është krucial gjë që shtron nevojën e trajtimit të thelluar të kësaj procedure që zhvillohet nga organet kompetente.

Cili është roli i prokurorit të shtetit për të mitur? Cili është roli i gjykatës në garantimin e të drejtave procedurale të të miturit gjatë procedurës përgatitore? Cilat janë vështësitë dhe dilemat që shfaqen në praktikë të gjykimin të të miturve për shkak të karakteristikave dalluese që ka? Ky program trajnimi pra, adreson pyetjet duke analizuar çështjet problematike që shfaqen në praktikë me qëllim të eliminimit të kolizionit të interpretimit të dispozitave ligjore dhe zbatimit unik të tyre.

Objektivat

- ⇒ Saktësojnë kompetencat e prokurorit të shtetit për të mitur në procedurën penale;
- ⇒ Zbatojnë drejt dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe akteve ndërkombëtare të cilat është i obliguar që të zbatoj;
- ⇒ Përcaktojnë se për cilat raste mund të shqiptohen masat apo dënimet ndaj një të miturit.

Përmbajtja

- Procedura përgatitore –paraburgimi i të miturit;
- Garantimi i të drejtave procedurale dhe shqyrtimi gjyqësor që zhvillohet ndaj të miturit nga gjykata;
- E drejta në ankesë.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodologjia interaktive në formë të diskutimit e kombinuar me raste praktike.

Përfituesit

Gjyqtarë për të mitur, prokurorë për të mitur, zyrtarë nga Shërbimi Sprovues.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA
KOMERCIALE***

Temë e identifikuar nga:

- Plan i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale, markat tregtare dhe patenta

E drejta e pronës intelektuale në përgjithësi dhe ajo e markave tregtare dhe patentave në veçanti (të gjitha së bashku referuar si pronësi intelektuale apo PI) është fushë e së drejtës relativisht e re në Kosovë. Institutet apo konceptet e kësaj lëmie me të cilat ballafaqohet sistemi gjyqësor janë shumë specifike dhe aspak të ngjashme me ato të cilat është ballafaquar sistemi gjyqësor tradicionalisht. Prandaj, vendimet gjyqësore mund të mos jenë të një niveli të duhur si për nga aspekti procedural ashtu edhe përmbajtësor gjë që zvogëlon besimin e komunitetit të biznesit tek gjyqësori. Trajnimi do të fokusohet edhe në sqarimet e hollësishme rreth teknologjisë dhe impakti i saj në sistemin e drejtësisë veçanërisht në fushën e të drejtës elektronike komerciale si përgjegjësia ligjore, ndërmjetësuesit e shërbimeve, kontratat dixhitale etj., dhe në këtë vështrim do të ofrohen praktikatat më të mira në zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Objektivat

- ⇒ Të njohin institutet kryesore të të drejtave të PI, markave tregtare e treguesve gjeografik, patentave e dizajneve industriale, si dhe të njohin dallimet midis këtyre instituteve;
- ⇒ Aplikojnë parimet e së drejtës së PI dhe praktikatat e mira në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;
- ⇒ Aplikojnë parimet e së drejtës së PI dhe praktikatat e mira në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për marka tregtare dhe treguesit gjeografik si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për patenta dhe dizajnit industrial;
- ⇒ Interpretojnë legjislacionet, politikatat dhe praktikatat e mira rajonale dhe globale nga shtete apo organizata të ndryshme dhe të mund t'i përdorin këto njohuri sa më mirë për të zgjidhur rastet në Kosovë.

Përmbajtja

- Të drejtat e PI - mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta;
- Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave nga markat tregtare dhe treguesit gjeografik;
- Mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave nga patentat dhe dizajni industrial;
- Mjetet juridike për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Të drejtat e autorit online, sfidat ligjore, rregullimi online, domenet dhe licencimi i pronësisë intelektuale.

Metodologjia

Metodologjia interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve, rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

2. Njohja dhe Përmbartimi i Vendimeve të Arbitrazhit Vendor dhe të Huaj

Trajnime me temën njohja dhe përmbartimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit vendor dhe të huaj ka për qëllim të sqaroj saktësisht rëndësinë dhe procedurën e njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit si ato vendore ashtu edhe të huaja duke ndihmuar gjyqtarët të unifikojnë praktikën e njohjes dhe përmbartimit të këtyre vendimeve. Trajnime synon të arrijë ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve në drejtim të interpretimit të drejtë dhe të saktë të dispozitave që mund të kenë dykuptimësi të njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit. Cilat janë sfidat që hasin gjyqtarët gjatë procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit vendor dhe të huaj? Cilat janë të metat eventuale që gjyqtarët shohin në aspektin e procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit? A ekziston ndonjë sfidë eventuale lidhur me implementimin apo përmbajtjen e Ligjit për Arbitrazhin? Mënyra më e mirë e kuptimit të të gjitha koncepteve dhe zgjidhjes së dilemave është biseda interaktive me gjyqtarët dhe shtrimi i pyetjeve dhe nxjerrja e konkluzioneve për çështjet e ngritura përmes shpalosjes së praktikave më të mira dhe qartësimit të problematikave mbi shembuj apo koncepte praktike.

Objektivat

- ⇒ Kuptojnë saktë rolin e gjyqtarëve në procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit;
- ⇒ Zbatojnë drejtë bazën ligjore të arbitrazhit;
- ⇒ Unifikojnë praktikën e njohjes dhe përmbartimit.

Përmbajtja

- Njohja dhe përmbartimi i vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës.

Metodologjia

Trajnime do të zhvillohet në mënyrë interaktive nga pjesëmarrësit dhe shtjellime të rasteve praktike.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës Komerciale dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnime do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

3. Praktika gjyqësore në kontestet që burojnë nga Ligji për Shoqëritë Tregtare

Trajnimi do të fokusohet në shpjegimin e të gjitha shoqërive tregtare që mund të themelohen në Kosovë në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, strukturat organizative dhe aktivitetet ekonomike që mund të ushtrojnë. Po ashtu në përgjegjësitë dhe kompetencat e ARBK-së në aspektet si: kapitali themeltar, aksionet preferenciale, aksionet e zakonshme, dokumentet e themelimit, ruajtja e tyre, shpërndarja e dividendes *etj.* si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që lindin nga Ligji për Shoqëritë Tregtare. Për më tepër, në këtë trajnim do të trajtohen edhe qeverisja korporative, strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve si dhe bashkimet, ndarjet, dhe qarkullimi i korporatës.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë rreth shoqërive të ndryshme tregtare;
- ⇒ Përshkruajnë formën e organizimit të shoqërive tregtare dhe strukturat e tyre pronësore;
- ⇒ Dallojnë të drejtat dhe detyrimet e aksionarëve, përfaqësuesve të autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në lidhje me shoqëritë tregtare;
- ⇒ Përshkruajnë dhe diskutojnë mosmarrëveshjet (problemet) që lindin deri tek rastet gjyqësore;
- ⇒ Të kenë njohuri mbi qeverisjen korporative, strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve;
- ⇒ Të kuptojnë në përgjithësi se si bëhet bashkimi, ndarja dhe qarkullimi i korporatës.

Përmbajtja

- Llojet e Shoqërive Tregtare - Funksionet dhe Kompetencat e ARBK-së;
- Natyra e Organizimit të Shoqërive Tregtare dhe Struktura Pronësore;
- Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë;
- Qeverisja korporative;
- Strukturat e kapitalit dhe të aksionarëve;
- Bashkimet, ndarjet, dhe qarkullimi i korporatës.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

4. Kontratat në Ekonomi

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizmin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët. Trajnimi do të shërbejë që të: rritet ekspertiza profesionale e gjyqtarëve në këtë fushë, të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon, avancimin e njohurive për aplikimin e instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë. Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve të pjesshme teorike, diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.

Objektivat

- ⇒ Njohin kontratën e franshizës, asignacionit, lizingut, know-how, licencën; kontratën publike dhe specifikat e tyre, kontratën për shitje ndërkombëtare të mallrave dhe specifikat e tyre;
- ⇒ Zbatojnë drejtë Konventën Ndërkombëtare për Shitjen e Mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në Kosovë.

Përmbajtja

- Kontrata franshizës, e asignacionit, lizingut dhe karakteristikat e saj;
- Kontrata për know-how dhe për licencën dhe karakteristikat e saj;
- Kontratat publike, llojet e tyre, specifikat dhe karakteristikat tjera;
- Konventa ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në raportet afariste me element të huaj;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

Metodologjia

Trajnimi është i dizajnuar në atë formë që përbëhet prej trajtimit teorik dhe prezantimit të rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore si dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

5. Procedura e Falimentimit

Ligji për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencen, i cili i pasqyron praktikën më të mira ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik. Prandaj, trajnimi ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve komercial në fushën specifike të falimentimit me qëllim të krijimit të një praktike gjyqësore të avancuar dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Për më tepër Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin e ri për Falimentimin (Ligji Nr. 08/L-256), i cili ka hyrë në Fuqi më 06.08.2024, dhe ky ligj përfshin risi në procedurën e Falimentimit, andaj gjyqtarët duhet të marrin njohuri të detajuara për institutet ligjore dhe ndryshimet në ligjin e ri.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë rreth instituteve kryesore të ligjit për Falimentimin;
- ⇒ Njohin pasojat e hapjes së rastit të falimentimit;
- ⇒ Zhvillojnë procedurën e falimentimit dhe të aplikojnë specifikat e saj;
- ⇒ Vlerësojnë kërkesat e kreditorëve, rregullsinë e paraqitjes, afatet dhe prioritetin e kërkesave;
- ⇒ Vlerësojnë kushtet ligjore dhe të mbikëqyrin procedurën e ri-organizimit apo likuidimit të shoqërive tregtare;
- ⇒ Të aplikojnë dispozitat ndërkufitare.

Përmbajtja

- Kuptimi i falimentimit, dispozitat e përgjithshme të Ligjit për falimentimin;
- Procedurat e përshpejtuara (NMV dhe para-pakot);
- Fillimi dhe hapja e rasteve, pasojat e hapjes së rasteve;
- Kërkesat e kreditorëve;
- Riorganizimi dhe Likuidimi;
- Lirimi individual dhe mbyllja e rastit;
- Dispozitat ndërkufitare.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive e të mësuarit përmes ligjëratave, ushtrimeve dhe diskutimeve si dhe përmes rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

6. Shkëputja e Kontratës dhe Efektet e Shkëputjes

Edhe pse palët i lidhin kontratat në bazë të vullnetit të tyre më qëllim të përmbushjes dhe realizimit të qëllimit për të cilin i lidhin, megjithatë në praktikë gjatë implementimit të kontratave paraqiten situata të ndryshme të cilat imponojnë shkëputjen e kontratave respektivisht pamundësojnë përmbushjen e tyre. Te disa kontrata na paraqiten edhe dispozita nule të cilat nuk krijojnë efekte juridike ndaj palëve kontraktuese. Mos përmbushja e kontratës, shkëputja e saj dhe nulimi i dispozitave kontraktuese, krijojnë pasoje juridike për palët kontraktuese të cilat shpesh bëhen objekt shqyrtimi në procedura gjyqësore. Këto pasoja janë të theksuara në sektorin ekonomik sepse kompanitë gjatë operimit të tyre për shkak të shkëputjes së kontratës mund të pësojnë dëme të natyrave specifike, si fitimi i humbur, dëmi ndaj palëve të treta, kompensimi i penaliteteve ndaj kontraktorëve tjerë, etj. Prandaj trajtimi i këtyre rasteve kërkon njohuri specifike, jo vetëm të ligjeve materiale por edhe të specifikave të operimit në fushën ekonomike. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve të kësaj natyre, sidomos në sferën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, është i konsiderueshëm me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë.

Objektivat

- ⇒ Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në sferën kontraktuale;
- ⇒ Pasojë juridike për palët kontraktuese në rastet e mos përmbushjes së kontratës, shkëputjes së kontratës dhe nulimit të dispozitave kontraktuese;
- ⇒ Specifikat e shkëputjes, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- ⇒ Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- ⇒ Aplikimi në praktikë i përvojave dhe praktikave me të mira të shteteve në rajon;
- ⇒ Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë.

Përmbajtja

- Karakteristikat e kontratave në ekonomi dhe detyrimet kontraktuese;
- Mos përmbushja e plotë dhe mos përmbushja e pjesshme e kontratës;
- Kushtet specifike të kontraktuara në rast të mos përmbushjes së kontratës;
- Të drejtat e palëve në rast të mos përmbushjes së kontratës;
- Pasojat juridike në rast të shkëputjes së kontratës;
- Pasojat juridike në rast të nulitetit të dispozitave kontraktuese;
- Llojet e kompensimit për shkak të mos përmbushjes së kontratave në ekonomi;
- Mënyra e llogaritjes së lartësisë së kompensimit;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

Metodologjia

Zbatimi i metodologjise interaktive, ushtrime dhe diskutime, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete, diskutim-bashkëbisedim, dhënie e ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe opinioneve.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

7. Kontrata e Sigurimit dhe Kompensimi i Dëmit

Për trajtimin e duhur të rasteve të sigurimit kërkohen njohuri të mjaftueshme jo vetëm në aspektin e trajtimit të dëmeve që lindin nga rastet e siguruar por edhe njohuri lidhur me natyrën e sigurimeve, specifikat e kontratave të sigurimit, mënyrën e lidhjes dhe interpretimit të tyre, procedurën e trajtimit të dëmit si dhe mënyrat e vlerësimit të dëmit në aspektin e përgjegjësisë dhe kompensimit adekuat. Meqenëse në praktikën gjyqësore numri më i madh i kontesteve paraqiten nga sfera e dëmeve të shkaktuara në komunikacion, fokusi i trajnimit do të jetë sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia duke përfshirë: mënyrat e trajtimit të dëmit, kompensimi i dëmit, bazat e përgjegjësisë dhe regresimi në rastet e sigurimeve “kasko”, llojet tjera të sigurimit vullnetar, si: sigurimi i pasurisë, sigurimi ekzekutimit të garancionit, sigurimi ekzekutimit të kontratës, etj.

Si të rritet ekspertiza profesionale në këtë fushë? Si të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane? Cilat janë përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon? Programi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve të pjesshme teorike, diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.

Objektivat

- ⇒ Njohin specifikat e kontratës së sigurimit – kushtet e përgjithshme dhe të veçanta;
- ⇒ Dallojnë procedurat për kompensimin e dëmit jashtë procedurës gjyqësore;
- ⇒ Zbatojnë drejtë procedurën gjyqësore për kompensimin e dëmit;
- ⇒ Njohin bazat e përgjegjësisë në rastet e shkaktimit të dëmit;
- ⇒ Identifikojnë llojet e kompensimit adekuat në rastet e dëmeve të paraqitura.

Përmbajtja

- Subjektet e të drejtës së sigurimeve; Sigurimi nga auto përgjegjësia; Polica e sigurimit TPL dhe kufijtë e mbulesës;
- Kërkesa për kompensim të dëmit, shpërblimi i dëmit material dhe jomaterial nga polica e sigurimit;
- E drejta në rentë dhe Regresimi i dëmit.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të aplikohet metodologji interaktive, diskutim, prezantim i rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

8. Marrëdhëniet Komerciale me Element të Huaj dhe Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar në Çështje Komerciale

Trajnimi ka për qëllim përditësimin e njohurive të gjyqtarëve të gjykatave përkatëse në pjesën e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare private dhe mbi risitë e ligjit në përgjithësi, institutet dhe shtyllat kryesore të së drejtës ndërkombëtare private dhe do të njoftohen mbi risitë kryesore në tri shtyllat kryesore të tij: në përcaktimin e së drejtës kompetente, në kompetencën e gjykatave dhe në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe me specifikat e marrëdhënieve komerciale/tregtare me element të huaj.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive të gjyqtarëve në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, me theks të veçantë në marrëdhëniet komerciale dhe tregtare;
- ⇒ Kuptimi i autonomisë së vullnetit: Trajnimi synon të ndihmojë gjyqtarët në kuptimin e autonomisë së vullnetit të palëve në përcaktimin e së drejtës kompetente në marrëdhëniet komerciale me element të huaj.
- ⇒ Praktikën ndërkombëtare: Trajnimi do të ofrojë shpjegime mbi praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të Unionit Evropian;
- ⇒ Rishikimi i vendimeve gjyqësore: Trajnimi synon të njohë gjyqtarët me procedurat dhe sfidat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe te punës;
- ⇒ Bashkëpunimi ndërkombëtar: Trajnimi synon të promovojë bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, duke ofruar shembuj praktikë të bashkëpunimit në fushën e ndërkombëtare private.

Përmbajtja

- Përcaktimi i të drejtës kompetente në marrëdhëniet tregtare me element të huaj, autonomia e vullnetit të palëve në këtë përcaktim;
- Jurisdiksioni i gjykatave të Kosovës në marrëdhëniet tregtare me element të huaj dhe në kontestet nga e drejta e punës;
- Jurisdiksioni i Gjykatës Komerciale në Kosovë në këto marrëdhënie;
- Autonomia e vullnetit të palëve në përcaktimin e gjykatës kompetente (të Kosovës apo të huaj);
- Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe e drejta e punës;
- Njohja e vendimeve gjyqësore të Kosovës në vendet tjera;
- Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në këtë fushë: shpjegime praktike mbi bashkëpunimin e gjykatave në marrjen e provave dhe shërbimin e dokumenteve.

Metodologjia

Aplikimi i metodologjisë së kombinuar mes shpjegimeve teorike të ndryshimeve që sjellë ligji dhe pjesës praktike të përbërë nga ushtrimet. Shpjegimet mbi risitë e ligjit dhe institutet e kësaj fushe të së drejtës bëhen duke elaboruar rastet kryesore në praktikë të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë e Unionit Evropian. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate, përveç që është shumë e pasur, është tejet udhëzuese për gjyqtarët kosovarë meqë interpreton dispozitat e njëjta të cilat janë transpozuar në LDNP në Kosovë.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

9. Kontrata e Ndërtimit

Kontrata mbi ndërtimin dhe kontrata e inxhinjeringut aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit. Po ashtu kontratat publike kanë një përdorim të gjerë në sferën publike. Ndërsa shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për Shitje Ndërkombëtare të Mallrave. Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave. Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Si të rritet ekspertiza profesionale e gjyqtarëve në këtë fushë? Si të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane? Cilat janë përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon? Si të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë?

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohurit për specifikat e kontratës së ndërtimit, inxhinjeringut dhe kontratave publike;
- ⇒ Zbatojnë drejtë Konventën Ndërkombëtare për Shitjen e Mallrave, në raportet afariste me element të huaj;
- ⇒ Zbatojnë drejtë procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- ⇒ Njohin mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

Përmbajtja

- Karakteristikat e kontratës publike të ndërtimit dhe specifikat e tyre;
- Kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës;
- Klauzola “çelësi në dorë”;
- Ndryshimet e çmimeve për shkak të ndryshimeve në treg;
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

Metodologjia

Trajnimi do të aplikojë një metodologji interaktive të të mësuarit e cila përbëhet nga prezantimi i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore si dhe diskutimeve për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete dhe ofrimin e zgjidhjeve dhe opinioneve.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerçiale.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plan i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026
- Rekomandim nga gjyqtarët e Gjykatës Komerciale
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

10. Kontrata e Kredisë

Kontratat e kredisë kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçanta gjatë zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkojnë njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata. Për më tepër tregu financiar në Republikën e Kosovës në vazhdimësi ka pësuar ndryshime thelbësore çka ka pasuar edhe me ndryshim legjislativ në këtë fushë. Për të mundësuar përditësimin e njohurive të gjyqtarëve me ndryshimet legjislative dhe aplikimin e tyre në kontestet që paraqiten në gjykata, është i nevojshëm trajnimi i vazhdueshëm në këtë fushë.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive për ta trajtuar Kontratën e kredisë;
- ⇒ Krijimi i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane;
- ⇒ Njohuri lidhur me përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon;
- ⇒ Aplikimi i instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë.

Përmbajtja

- Kuptimi i kontratës së kredisë, elementet dhe specifikat e saj;
- Klauzolat e posaçme lidhur me kamatat dhe llogaritjen e tyre;
- Klauzolat e veçanta për kamatëvonesën dhe penalitetet;
- Kthimi i parakohshëm i kredisë dhe pasojat juridike;
- Mjetet e sigurimit të përmbushjes së kredisë (Pengu dhe Hipoteka);
- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së dispozitave të veçanta kontraktuese.

Metodologjia

Aplikimi i metodologjisë interaktive, trajtimin teorik të kontratave specifike, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore, të gjitha këto që të jepen përgjigje dilemave dhe paqartësive të cilat lindin në praktikën gjyqësore.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional të Gjykatës Komerciale.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA
ADMINISTRATIVE***

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Llojet e padive sipas Ligjit të ri për konfliktet administrative

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e dispozitave të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative që ka filluar të zbatohet nga janari 2025. Gjithanshëm do të trajtohen dispozitat lidhur me llojet e padive. Me Ligjin e ri për Konfliktet Administrative është përcaktuar një numër i caktuar i llojeve të padive të cilat mund të paraqiten në procedurën e konfliktit administrativ. Në këtë trajnim do të shqyrtohen gjithanshëm dispozitat e ligjit të ri për konfliktet administrative lidhur me paditë dhe llojet e tyre dhe synimet kryesore të këtij ligji lidhur me paditë, ndërsa çështje që do të shtrohen dhe që kërkojnë përgjigje janë si në vijim: Përcaktimi i llojit të padisë? Procedura e cila duhet të ndiqet? dhe Vendimi për padinë e caktuar.

Në këtë trajnim trajnuesit përmes shpjegimeve do të interpretojnë dispozitat e Ligjit të ri për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimeve të trajnuesve përmes zgjidhjeve të reja ligjore si dhe duke elaboruar shembuj praktik hipotetik mbi llojet e padive.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth llojeve të padive dhe veçorive të tyre sipas ligjit të ri;
- ⇒ Të thellojnë njohuritë për paditë dhe kushtet procedurale për ngritjen e tyre;
- ⇒ Të avancojnë njohuritë lidhur me vlerësimin e llojeve të padive;
- ⇒ Të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore në fuqi lidhur me paditë.

Përmbajtja

- Paditë dhe veçoritë e tyre sipas ligjit të ri;
- Paditë dhe kushtet procedurale për ngritjen e tyre;
- Vlerësimi i llojeve të padive;
- Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në fuqi lidhur me paditë.

Metodologjia

Pas fillimit të zbatimit të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve, duke trajtuar zgjidhjet ligjore përmes shpjegimeve teorike dhe shembuj praktik dhe shembujve praktik hipotetik.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, bashkëpunëtorë profesional.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

2. Llojet dhe ekzekutimi i vendimeve sipas Ligjit për konfliktet administrative

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e rolit dhe rëndësisë së zbatimit të drejtë të dispozitave të Ligjit të ri për Konfliktet Administrative që ka filluar të zbatohet nga janari i vitit 2025 lidhur me Vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre. Gjithashtu do të trajtohet gjithanshëm mënyra e vendosjes së Gjykatës dhe llojet e vendimmarrjes së saj. Në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje si: Cilat janë synimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me Vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre; Kur Gjykata vendos me aktgjykim e kur me aktvendim dhe a ka përjashtim nga rregulli i përmendur? Ku qëndron rëndësia e vendimeve në procedurën e konfliktit administrativ? Cili është roli i vendimeve dhe cilat janë veçoritë e procedurës së nxjerrjes së tyre? 3. Kur gjykata, me aktgjykim, do të aprovojë padinë e kur do ta hedhë atë? Në këtë trajnim trajnuesit përmes shpjegimeve do të shpjegojnë dhe interpretojnë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (në fuqi prej janarit 2025) lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimeve të trajnuesve duke shpjeguar zgjidhjet ligjore dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre.

Objektivat

- ⇒ Të njihen me qëllimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me Vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre;
- ⇒ Të dallojnë situatat kur Gjykata vendos me aktgjykim e kur me aktvendim dhe përjashtimet nga rregulli i përmendur;
- ⇒ Të njohin rolin dhe rëndësinë e vendimeve në procedurën e konfliktit administrativ dhe cilat janë veçoritë e procedurës së nxjerrjes së tyre;
- ⇒ Të avancojnë njohuritë për ekzekutimin e vendimeve në procedurën e konfliktit administrativ;
- ⇒ Të njihen me vendimet, procedurën e nxjerrjes dhe shpalljen e tyre.

Përmbajtja

- Qëllimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me Vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre;
- Situatat kur Gjykata vendos me aktgjykim e kur me aktvendim dhe përjashtimet nga rregulli i përmendur;
- Roli dhe rëndësia e vendimeve në procedurën e konfliktit administrativ dhe veçoritë e procedurës së nxjerrjes së tyre;
- Ekzekutimi i vendimeve në procedurën e konfliktit administrativ;
- Dispozitat ligjore për Vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre.

Metodologjia

Dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve, duke shpjeguar zgjidhjet ligjore duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu tematika e përmendur do të trajtohet përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat e Ligjit për konfliktet administrative dhe punës në grupe me pjesëmarrës.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional në këto gjykata.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

3. Kontrolli gjyqësor i diskrecionit administrativ

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e rolit dhe rëndësisë së Kontrollit gjyqësor të diskrecionit administrativ. Një synim tjetër është zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrativ që ka filluar të zbatohet nga janari i vitit 2025 lidhur me kontrollin gjyqësor të diskrecionit administrativ. Gjithashtu do të trajtohen gjithanshëm mënyrat dhe vlerësimi i ligjshmërisë së aktit apo veprimit tjetër administrativ nga ana e gjykatave. Në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje si: Cilat janë synimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me Kontrollin gjyqësor të diskrecionit administrativ? Kur gjykata shqyrton vetëm ushtrimin e ligjshëm të diskrecionit në pajtim me ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative dhe nuk shtrin shqyrtimin e saj mbi përshtatshmërinë e zgjedhjes të bërë nga administrata? Kur Gjykata nuk do të aprovojë një padi, vetëm për shkak të shkeljeve të konstatuara të rregullave të procedurës administrative? Ku qëndron roli dhe rëndësia e Kontrollit gjyqësor të diskrecionit administrativ? Në këtë trajnim trajnuesit përmes shpjegimeve do të shpjegojnë dhe interpretojnë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (në fuqi prej janarit 2025) lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimeve të trajnuesve duke shpjeguar zgjidhjet e reja ligjore dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi vendimet, marrjen dhe shpalljen e tyre.

Objektivat

- ⇒ Të njihen me qëllimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me Kontrollin gjyqësor të diskrecionit administrativ;
- ⇒ Të njohin rolin dhe rëndësinë e Kontrollit gjyqësor të diskrecionit administrativ;
- ⇒ Të avancojnë njohuritë për mënyrat dhe vlerësimin e ligjshmërisë së aktit apo veprimit tjetër administrativ nga ana e gjykatave;
- ⇒ Të zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrativ lidhur me kontrollin gjyqësor të diskrecionit administrativ.

Përmbajtja

- Roli dhe rëndësia e Kontrollit gjyqësor të diskrecionit administrativ;
- Mënyrat dhe vlerësimi i ligjshmërisë së aktit apo veprimit tjetër administrativ nga ana e gjykatave;
- Kur Gjykata nuk do të aprovojë një padi, vetëm për shkak të shkeljeve të konstatuara të rregullave të procedurës administrative;
- Zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrativ lidhur me kontrollin gjyqësor të diskrecionit administrativ.

Metodologjia

Dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve, duke shpjeguar zgjidhjet ligjore duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu tematika e përmendur do të trajtohet përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat e Ligjit për konfliktet administrative dhe punës në grupe me pjesëmarrës.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

4. Masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e rolit dhe rëndësisë së Masave të sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ. Një synim tjetër është zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative që ka filluar të zbatohet nga janari i vitit 2025 lidhur me Masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ. Gjithashtu do të trajtohen gjithanshëm situatat kur Gjykata, me kërkesë, mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme dhe proporcionale, të përcaktuar me legjislacionin përkatës për procedurën gjyqësore civile në fuqi. Në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje si: Cilat janë synimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me Masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ? Për sigurimin e padisë në rastin e padive për anulimin e një akti administrativ, Gjykata, me kërkesë, a mund të vendosë pezullimin e zbatimit të aktit apo përkatësisht ndalimin e menjëhershëm të veprimit tjetër administrativ? Për sigurimin e padisë në rastin e padive për nxjerrjen e një akti administrativ, Gjykata me kërkesë, a mund të nxjerr një masë të përkohshme që konsiston në rregullimin e përkohshëm të marrëdhënies juridike në konflikt? dhe, Gjykata, me kërkesë, a mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme dhe proporcionale, të përcaktuar me legjislacionin përkatës për procedurën gjyqësore civile në fuqi, në rastet kur masat e përcaktuara në nenin konkret nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për propozuesin e sigurimit.

Në këtë trajnim trajnuesit përmes shpjegimeve do të shpjegojnë dhe interpretojnë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (në fuqi prej janarit 2025) lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimeve të trajnuesve duke shpjeguar zgjidhjet ligjore dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi Masave të sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ.

Objektivat

- ⇒ Të njihen me qëllimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ;
- ⇒ Të njohin rolin dhe rëndësinë e Masave të sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ;
- ⇒ Të avancojnë njohuritë për situatat kur Gjykata, me kërkesë, mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme dhe proporcionale, të përcaktuar me legjislacionin përkatës për procedurën gjyqësore civile në fuqi;
- ⇒ Të zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me Masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ.

Përmbajtja

- Dispozitat ligjore të LKA-së lidhur me Masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ;
- Roli dhe rëndësia e Masave të sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ;
- Situatat kur Gjykata, me kërkesë, mund të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme dhe proporcionale, të përcaktuar me legjislacionin përkatës për procedurën gjyqësore civile në fuqi;
- Zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me Masat e sigurisë në procedurën e konfliktit administrativ.

Metodologjia

Dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve, duke shpjeguar zgjidhjet ligjore bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu tematika e përmendur do të trajtohet përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat e Ligjit për konfliktet administrative dhe punës në grupe me pjesëmarrës.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional në këto gjykata.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

5. Vlerësimi i akteve nënligjore normative dhe shqyrtimi incidental i ligjshmërisë së një akti nënligjor normativ

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e vlerësimit të akteve nënligjore normative dhe dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e këtyre akteve. Një synim tjetër është zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative që ka filluar të zbatohet nga janari i vitit 2025 lidhur me vlerësimin e akteve nënligjore normative dhe dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e këtyre akteve. Gjithashtu do të trajtohen gjithanshëm rastet kur akti nënligjor sipas vlerësimit të gjykatës a duhet të anulohet në tërësi apo vetëm dispozitat kontestuese sipas padisë. Po ashtu objekt trajtimi do të jetë edhe shqyrtimi incidental i ligjshmërisë së një akti nënligjor normativ. Fokusi do të jetë në situatat kur Gjykatat referojnë në Gjykatë Supreme çështje përkitazi me përputhshmërinë e një akti nënligjor normativ me ligjin, nëse ajo përputhshmëri është ngritur sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese krijon bindjen për mospërputhshmërinë e aktit nënligjor normativ të kontestuar me ligjin.

Në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje si: Cilat janë synimet e dispozitave ligjore të LKA-së lidhur me vlerësimin e akteve nënligjore normative si dhe shqyrtimin incidental të ligjshmërisë së një akti nënligjor normativ? Kur kolegji shqyrtues, në seancë të trupit gjykues, mund të shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë? Çfarë vepron kolegji shqyrtues kur nuk vjen unanimisht në përfundim se padia nuk është e lejueshme? Çka vlerëson Gjykata çka vlerëson gjatë shqyrtimit të themelësisë së padisë? Në këtë trajnim trajnuesit përmes shpjegimeve do të shpjegojnë dhe interpretojnë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (në fuqi prej janarit 2025) lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimeve të trajnuesve duke interpretuar zgjidhjet ligjore dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi vlerësimin e akteve nënligjore normative si dhe shqyrtimin incidental të ligjshmërisë së një akti nënligjor normativ.

Objektivat

- ⇒ Të kuptojnë rëndësinë e vlerësimit të akteve nënligjore normative dhe dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e këtyre akteve;
- ⇒ Të zbërthejnë rastet kur akti nënligjor sipas vlerësimit të gjykatës a duhet të anulohet në tërësi apo vetëm dispozitat kontestuese sipas padisë;
- ⇒ Të njihen me rolin dhe peshën e shqyrtimit incidental të ligjshmërisë së një akti nënligjor normativ;
- ⇒ Të njihen me situatat kur gjykatat referojnë në Gjykatën Supreme çështje përkitazi me përputhshmërinë e një akti nënligjor normativ me ligjin, nëse ajo përputhshmëri është ngritur sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese krijon bindjen për mospërputhshmërinë e aktit nënligjor normativ të kontestuar me ligjin;
- ⇒ Të zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrativ lidhur me vlerësimin e akteve nënligjore normative dhe dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e këtyre akteve.

Përmbajtja

- Vlerësimi i akteve nënligjore normative dhe dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e këtyre akteve;
- Trajtimi i rasteve kur akti nënligjor sipas vlerësimit të gjykatës a duhet të anulohet në tërësi apo vetëm dispozitat kontestuese sipas padisë;
- Roli dhe pesha e shqyrtimit incidental të ligjshmërisë së një akti nënligjor normativ;
- Trajtimi i situatave kur gjykatat referojnë në Gjykatën Supreme çështje përkitazi me përputhshmërinë e një akti nënligjor normativ me ligjin, nëse ajo përputhshmëri është ngritur sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, gjatë procedurës gjyqësore;
- Zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me vlerësimin e akteve nënligjore normative dhe dispozitave të posaçme për procedurën e gjykimit të padive për shfuqizimin e këtyre akteve.

Metodologjia

Dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve, duke shpjeguar zgjidhjet ligjore dhe duke u bazuar në raste dhe shembuj konkret. Gjithashtu tematika e përmendur do të trajtohet përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat e Ligjit për konfliktet administrative dhe punës në grupe me pjesëmarrës.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

6. Procedura administrative dhe dallimi në mes të procedurave tjera me fokus të procedurës kundërvajtëse si dhe procedurave gjyqësore

Ky trajnim ka për qëllim trajtimin e procedurës administrative dhe dallimin në mes të procedurave tjera me fokus të veçantë procedurën kundërvajtëse dhe procedurave gjyqësore (lidhur me çështjet në kompetencë të Inspektorateve të Republikës së Kosovës). Gjithashtu do të trajtohet edhe procedura administrative lidhur me çështjet e inspektoratëve si dhe procedurat gjyqësore të cilat i kanë në kompetencë këto çështje. Një synim tjetër është zbatimi i drejtë i dispozitave të ligjeve materiale të materieve specifike dhe Ligjit për Konfliktet Administrativ që ka filluar të zbatohet nga janari i vitit 2025. Në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje si: Cilat janë synimet e dispozitave ligjore të ligjeve materiale të materieve specifike dhe Ligjit për Konfliktet Administrative? Cilat janë dilemat rreth zbatimit të ligjeve materiale në raport me zhvillimin e procedurave administrative si dhe identifikimi i procedurave gjyqësore?

Në këtë trajnim trajnuesit përmes shpjegimeve do të shpjegojnë dhe interpretojnë dispozitat e ligjeve materiale të materieve specifike dhe Ligjit për Konfliktet Administrativ, lidhur me tematikën e lartpërmendur dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimeve të trajnuesve duke shpjeguar zgjidhjet ligjore dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi procedurën administrative dhe dallimin në mes të procedurave tjera me fokus të veçantë procedurën kundërvajtëse dhe procedurave gjyqësore (lidhur me çështjet në kompetencë të Inspektorateve të Republikës së Kosovës).

Objektivat

- ⇒ Të avancojnë njohuritë për procedurën administrative si dhe dallimin në mes të procedurave tjera me fokus të veçantë procedurën kundërvajtëse dhe procedurave gjyqësore (lidhur me çështjet në kompetencë të Inspektorateve të Republikës së Kosovës);
- ⇒ Të elaborojnë procedurën administrative lidhur me çështjet e inspektoratëve si dhe procedurat gjyqësore të cilat i kanë në kompetencë këto çështje;
- ⇒ Të identifikojnë sfidat që hasin gjyqtarët dhe inspektorët në praktik gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;
- ⇒ Zbatimi i drejtë i dispozitave të ligjeve materiale të materieve specifike dhe Ligjit për Konfliktet Administrativ dhe përballja e suksesshme me sfidat që po hasen në praktikë.

Përmbajtja

- Trajtimin e procedurës administrative dhe dallimin në mes të procedurave tjera me fokus të veçantë procedurën kundërvajtëse dhe procedurave gjyqësore (lidhur me çështjet në kompetencë të Inspektorateve të Republikës së Kosovës);
- Trajtimi i procedurës administrative lidhur me çështjet e inspektorateve si dhe procedurat gjyqësore të cilat i kanë në kompetencë këto çështje;
- Sfidat që hasin gjyqtarët dhe inspektorët në praktik gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;
- Zbatimi i drejtë i dispozitave të ligjeve materiale të materieve specifike dhe Ligjit për Konfliktet Administrativ.

Metodologjia

Lidhur me tematikën e përmendur dhe çështjet e ngritura dhe sfidat do të adresohen përmes shpjegimit të trajnuesve dhe kontributeve (sfida vete paraqitura) të pjesëmarrësve në trajnim duke ofruar zgjidhje konform legjislacionet në fuqi. Gjithashtu tematika e përmendur do të trajtohet përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik konform rregullave të legjislacionit në fuqi si dhe punës në grupe me pjesëmarrës. Me fokus të trajtimit të procedurës administrative lidhur me çështjet e inspektorateve si dhe procedurat gjyqësore të cilat i kanë në kompetencë këto çështje.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, bashkëpunëtorë profesional, gjyqtarët e divizioneve për kundërvajtje dhe inspektorët prej të gjitha inspektorateve të Republikës së Kosovës) me GIZ-in.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

7. Tryezë diskutimi lidhur me çështjet e mungesës së mekanizmave për zbatimin e dispozitave ligjore për konfiskimin në raport me ligjet për inspektoratet e Republikës së Kosovës

Kjo tryezë ka për qëllim diskutimin lidhur me çështjet e mungesës së mekanizmave për zbatimin e dispozitave ligjore për konfiskimin në raport me ligjet për inspektoratet e Republikës së Kosovës. Gjithashtu do të diskutohet për gjetjen e zgjidhjeve për krijimin e këtyre mekanizmave në ligjet materiale tek të cilat mungojnë ose kanë qenë të pamundura të zbatohen. Në këtë tryezë do të shtrohen çështje dhe pyetje si: Cilat janë mekanizmat për zbatimin e dispozitave ligjore për konfiskimin në raport me ligjet për inspektoratet e Republikës së Kosovës. Cilat janë sfidat për zbatimin e këtyre mekanizmave? Cilat janë dilemat për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me konfiskimin. Në këtë tryezë pjesëmarrësit përmes kontributeve dhe diskutimeve interaktive do të trajtohen dispozitat e ligjeve materiale të materieve në raport me sfidat për zbatimin e dispozitave për konfiskimin.

Objektivat

- ⇒ Të avancojnë njohuritë për çështjet e mungesës së mekanizmave për zbatimin e dispozitave ligjore për konfiskimin në raport me ligjet për inspektoratet e Republikës së Kosovës;
- ⇒ Të gjejnë zgjidhje për krijimin e mekanizmave për konfiskimin;
- ⇒ Të identifikojnë sfidat për zbatimin e këtyre mekanizmave;
- ⇒ Të evitohen dilemat për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me konfiskimin.

Përmbajtja

- Diskutimi lidhur me çështjet e mungesës së mekanizmave për zbatimin e dispozitave ligjore për konfiskimin në raport me ligjet për inspektoratet e Republikës së Kosovës;
- Diskutimi për gjetjen e zgjidhjeve për krijimin e këtyre mekanizmave në ligjet materiale tek të cilat mungojnë ose kanë qenë të pamundura të zbatohen;
- Mekanizmat për zbatimin e dispozitave ligjore për konfiskimin në raport me ligjet për inspektoratet e Republikës së Kosovës;
- Sfidat për zbatimin e këtyre mekanizmave? Cilat janë dilemat për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me konfiskimin.

Metodologjia

Në tematikën e përmendur - çështjet e ngritura dhe sfidat do të adresohen përmes kontributeve (sfidave të paraqitura) të pjesëmarrësve në tryezë duke ofruar zgjidhje konform legjislacionet në fuqi, diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik konform rregullave të legjislacionit në fuqi.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, bashkëpunëtorë profesional, dhe inspektorët prej të gjitha inspektorateve të Republikës së Kosovës) me GIZ-in.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

8. Kontestet e punës sipas Ligjit për Zyrtarët Publik

Në këtë trajnim qëllimi kryesor është avancimi i njohurive të gjyqtarëve për procedurën që zhvillohet dhe mbrojtjen gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës me përqendrim tek nëpunësit-shërbyesit civil të Republikës së Kosovës. Vështirësitë janë të theksuara në zbatimin e vendimeve të Këshillit, përmbardimin e vendimeve nga gjykatat, zbatimin e standardeve kushtetuese për të drejtën në punë dhe zbatimin e garancioneve të KEDNJ-së. Gjithashtu do të trajtohen çështjet që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët publik në organet administrative të përfshira në mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës si dhe procedurën dhe afatet e ankimit administrativ dhe gjyqësor. Do të trajtohet edhe iniciimi i konfliktit administrativ ndaj vendimit të KPMK-së, mbrojtja gjyqësore e të drejtave të punës për zyrtarët publik, kompetenca, afatet dhe mjetet juridike etj. Po ashtu intencë është edhe zbatimi i parimit të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme në këto raste. Sfiduese në zgjidhjen e disa prej këtyre rasteve është edhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin ajo ka ndaluar për një afat të caktuar aplikimin e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, andaj ka nevojë për një trajtim të gjithanshëm.

Në këtë trajnim do të shqyrtohen gjithanshëm dispozitat e ligjit për zyrtarët publik për zbatimin e drejtë të tyre për zyrtarët publik. Pastaj do të trajtohet procedura ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij dhe përmbardimi i vendimeve të tij. Gjithashtu në këtë trajnim do të shtrohen çështje dhe pyetje që kërkojnë përgjigje si: Cilat janë të drejtat e zyrtarëve publik? Cila është rëndësia e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik për procedurën e gjykimit lidhur me këto kategori dhe cila është pesha e vendimeve dhe procedura e nxjerrjes së tyre? Në këtë trajnim, trajnuesit përmes shpjegimeve do të interpretojnë dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik lidhur me temat e lartpërmendura. Çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përveç shpjegimeve edhe duke interpretuar zgjidhjet ligjore si dhe duke elaboruar shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit të përmendur dhe legjislacionit tjetër në fuqi, dhe diskutimeve interaktive me pjesëmarrës.

Objektivat

- ⇒ Të njihen me të drejtat e nëpunësve sipas Ligjit për Zyrtarët Publik;
- ⇒ Të dallojnë kategoritë e nëpunësve që gjykohen në procedurën e konfliktit administrativ dhe ato kategori që gjykohen në procedurën kontestimore;
- ⇒ Të zbërthejnë procedurën ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij;
- ⇒ Të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore për nëpunësit-shërbyesit civil.

Përmbajtja

- Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore për zyrtarët publik;
- Procedura ligjore në KPMK dhe mjetet kundër vendimeve të tij;
- Raste nga praktika gjyqësore lidhur me procedurën në çështjet që lidhen me zyrtarët publik.

Metodologjia

Metodat që do të përdoren gjatë këtij trajnimi janë: ligjërime të përgjithshme, diskutime interaktive dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Trajnimi do të jetë i strukturuar në mënyrë që koha më e madhe t'iu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit. Në trajnim do të elaborohen parimet dhe rregullat kryesore të së drejtës-së marrëdhënies së punës për zyrtarët publik sipas Ligjit dhe mënyrat e vendimmarrjes.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët e KPMK-së, përfaqësues të organeve publike.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

9. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjet e konfliktit administrativ - Mënyra e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ në gjykatat nacionale

Synim kryesor i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut GJEDNJ në Strasburg në çështjet e konfliktit administrativ dhe mënyra e zbatimit të këtyre vendimeve në gjykatat nacionale (vendore). Qëllim tjetër është trajtimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rastet kryesore të GJEDNJ, më konkretisht, është ofrimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese. Do të analizohet sfera e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në krahasimin e kësaj mbrojtjeje me standardet e interpretimit të të GJEDNJ, si dhe do të trajtohen marrëdhëniet midis GJEDNJ dhe gjykatave nacionale.

Objektivat

- Të njihen me çështjet juridike të ngritura në konfliktet administrative para GJEDNJ;
- Të dallojnë mënyrat e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ në gjykatat nacionale (vendore) në lëmin administrative;
- Të kuptojnë qasjet dhe qëndrimet e GJEDNJ në konfliktet administrative përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtësore të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ;
- Të zbatojnë efektisht detyrimin kushtetues specifik nga nenit 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës - “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore... (duhet të) interpretohen në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”; dhe të njihen me arsyet se pse gjykatat e Kosovës, në praktikën e tyre duhet të mbështeten në jurisprudencën e GJEDNJ.

Përmbajtja

- Çështjet juridike të ngritura në konfliktet administrativ para GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin administrative.
- Mënyrat e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ në gjykatat nacionale (vendore) në lëmin administrative.
- Qëndrimet e GJEDNJ në konfliktet administrative përkitazi me aspektet kryesore procedurale dhe përmbajtësore të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ;
- Detyrimin kushtetues specifik nga nenit 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe arsyet se, pse gjykatat e Kosovës, në praktikën e tyre duhet të mbështeten në jurisprudencën e GJEDNJ.

Metodologjia

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të kenë mundësin që përmes bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri të reja mbi vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas ankesave në lëmin administrative – konflikteve administrative. Fokusi do të jetë edhe në ofrimin e

udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GJEDNJ.

Përfituesit

Gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

10. Zbatimi i Ligjit për Azilin dhe Ligjit për Shtetësinë dhe pa shtetësinë - dilemat në praktikën administrative dhe gjyqësore

Me këtë trajnim synohet thellimi i njohurive të gjyqtarëve kosovar për garancionet ndërkombëtare në tematikën e azilit dhe veçmas me dispozitat e Ligjit për Azilin i Kosovës, raportin e këtij ligji me Konventën ndërkombëtare për azilin dhe zbatimin e drejt të dispozitave të tij me rastin e vendosjes në këto lëndë. Po ashtu do të trajtohen çështjet që ndërlidhen me statusin dhe qëndrimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të dispozitave të Ligjit për azilin si dhe zbatimin e tyre nga organet kompetente të Republikës së Kosovës.

Synimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve mbi çështjet aktuale të pa shtetësisë në vend dhe zhvillimet aktuale në doktrinën ligjore ndërkombëtare si dhe shembuj të praktikave të mira dhe zgjidhjet e mundshme. Në këtë trajnim, përveç krahasimit të praktikave të vendit, me ato në rajon dhe Evropë do të shqyrtohen edhe sfidat objektive dhe subjektive në shqyrtimin e padive në procedurën e konfliktit administrativ, roli i punës cilësore të organeve administrative në dy instanca si dhe organeve gjyqësore në parandalimin e pa-shtetësisë. Pa shtetësia mund të ndodhë si rezultat i diskriminimit dhe privimit arbitrar të shtetësisë, situatat e ecurisë anormale të shtetit, praktikat e papërshtatshme të regjistrimit civil, probleme në marrjen e dokumenteve që vërtetojnë shtetësinë dhe mangësi të tjera në ligjet e shtetësisë.

Njohuritë që do të marrin pjesëmarrësit, do të ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e kërkesave të azilkërkuessve si në procedurën administrative ashtu edhe në procedurën gjyqësore, dhe do të mundësojnë gjykimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme lidhur me këto raste. Gjithashtu pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri efektive lidhur me mbledhjen e informacioneve nga raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendi i origjinës gjatë procedimit të rasteve. Ky trajnim do të ofroj përgjigje lidhur me dispozitat e Ligjit për Azilin i Kosovës duke u fokusuar në çështjet dhe dilemat që ndërlidhen me statusin dhe qëndrimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në procedurën ligjore të mbajtjes dhe dëbimit të tyre nga Republika e Kosovës në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit nacional si dhe zbatimin e drejt të tyre nga organet kompetente të Republikës së Kosovës. Po ashtu do të bëhet edhe shqyrtimi i praktikës gjyqësore të deritanishme lidhur me vendimet gjyqësore mbi paditë për njohjen e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare si dhe krahasimi me rastet e Gjykatës së Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Disa prej çështjeve që do të shtrohen e që kërkojnë përgjigje në këtë trajnim janë edhe: Dilemat kryesore që po shfaqen lidhur me shtetësinë dhe mënyrat e fitimit dhe humbjes së saj në Kosovë? Cilat janë problemet kryesore në zbatimin e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës? Po ashtu në praktikë në Republikën e Kosovës ka probleme dhe paqartësi ligjore dhe çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e që kanë nevojë dhe do të trajtohen në detale. Për këto probleme dhe procedura ka nevojë që të trajtohen në mënyrë të gjithanshme përmes shpjegimit të dispozitave ligjore, mënyrave të fitimit të shtetësisë, zbatimit të drejtë të procedurave për humbjen e shtetësisë dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave.

Në këtë trajnim dilemat dhe pyetjet do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, pastaj trajtimit të rasteve dhe shembujve konkret. Do të përdoren edhe diskutime dhe shembuj praktik të bazuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtarë nga fusha e Azilit/Mbrojtjes Ndërkombëtare. Në këtë trajnim të gjitha dilemat dhe çështjet tematike do të shpjegohen edhe përmes shembujve nga praktika administrative dhe gjyqësore vendore, e rajonit dhe ajo e

ndërkombëtare. Gjithashtu krahas angazhimit të pjesëmarrësve do të trajtohen edhe rastet praktike që janë vendosur në gjykatë. Po ashtu përmes bashkëbisedimit pjesëmarrësit do të këmbëjnë përvoja në mes vete lidhur me çështjet e ndryshme aktuale nga praktika gjyqësore e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe departamentit administrativ të Gjykatës së Apelit. Po ashtu do të trajtohen edhe raste nga procedurat administrative dhe procedurat gjyqësore të aplikueshme në vendet e rajonit dhe ato evropiane e që do të u ndihmojnë gjyqtarëve në shqyrtimin efikas dhe praktik të kërkesave që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekt me të drejtat e shtetësisë.

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë drejt dispozitat e Ligjit për Azilin i Kosovës dhe legjislacionit sekondar me rastin e vendosjes në çështjet për azilin;
- ⇒ Avancojnë njohuritë dhe zbatojnë drejt dispozitat ligjore në fuqi për shtetësinë në Republikën e Kosovës;
- ⇒ Njohin mënyrat e fitimit dhe të humbje së shtetësisë;
- ⇒ Avancojnë njohuritë e tyre në zbatimin parimeve të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve gjegjësisht me parimet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollit të Saj të vitit 1967.

Përmbajtja

- Roli dhe zbatimi i dispozitave të Ligjit për Azilin i Kosovës dhe raporti i tij me Konventën ndërkombëtare për azilin.
- Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi për shtetësinë në Republikën e Kosovës.
- Mënyrat e fitimit dhe të humbje së shtetësisë.
- Zbatimi i parimeve të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve gjegjësisht me parimet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Refugjatëve e vitit 1951 dhe Protokollit të Saj të vitit 1967.

Metodologjia

Metodologjia do të përfshijë shpjegime të pjesshme teorike dhe diskutime të hapura ashtu që konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra do të ndahen me të gjithë pjesëmarrësit për dhe në dobi të punës së tyre praktike. Dilemat dhe çështjet e ngritura do të adresohen edhe përmes diskutimeve dhe shembujve praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtarë nga fusha e mbrojtjes ndërkombëtare për refugjatë, puna në grupe dhe diskutimi i tyre me pjesëmarrës, si dhe do ketë diskutime për praktikë efektive që sjellin vendime të bazuara në merita për çështjet aktuale dhe vendimet për ankesa në shkallë të ndryshme.

Përfituesit

Gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore dhe zyrtarë të Komisionit Kombëtar për Refugjatë dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim - MPB dhe institucioneve tjera (me UNHCR).

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA
KUSHTETUESE***

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese në lidhshmëri me praktikën e GJEDNJ sipas kërkesave në lëmin civile dhe administrative

Synim kryesor i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me njohuritë e reja dhe vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave në lëmin civile dhe administrative. Qëllim tjetër është trajtimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë rastet kryesore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe ato të GJEDNJ, dhe ofrimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe atë të GJEDNJ. Pastaj mbrojtja gjyqësore e të drejtave kushtetuese në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në krahasimin e kësaj mbrojtjeje me standardet e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe GJEDNJ, si dhe trajtimi i marrëdhënies midis gjykatës kushtetuese dhe atyre të rregullt. Fokusi do të jetë edhe në kontrollin incidental të kushtetutshmërisë në kontekst të zhvillimeve të praktikës aktuale gjyqësore.

Objektivat

- ⇒ Të njihen me çështjet kryesore juridike të ngritur në rastet sipas kërkesave në lëmin civile dhe administrative para Gjykatës Kushtetuese;
- ⇒ Të kuptojnë qasjet dhe qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përkitazi me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtjesore të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ);
- ⇒ Të zbatojnë efektivisht dispozitat e nenit 53 dhe 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe që gjyqtarë të nxjerrin vendimet në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ⇒ Arsyetojnë drejtë vendimet e tyre në praktikën duke u mbështet në jurisprudencën e GJEDNJ dhe si t'i qasen kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

Përmbajtja

- Çështjet aktuale dhe veçoritë e praktikës së Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmine civile dhe administrative;
- Qasjet dhe qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës lidhur me aspekte kryesore procedurale dhe përmbajtjesore të të drejtave dhe lirive individuale, në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ);
- Zbatimi i dispozitave të nenit 53 dhe 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nxjerrja e vendimeve në harmoni me vendimet e GJEDNJ;
- Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në praktikë duke u mbështet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Roli i kontrollit incidental të kushtetutshmërisë në praktikën aktuale në Republikën e Kosovës.

Metodologjia

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të kenë mundësin që përmes bashkëbisedimit interaktiv dhe shpjegimeve të trajnuesve pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri të reja mbi vendimet kryesore në praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lidhshmëri me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sipas kërkesave-ankesave në lëmin civile dhe administrative si dhe mbi rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë. Fokusi do të jetë edhe në ofrimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve për të drejtat individuale të njeriut që mbrohen me Kushtetutën e Kosovës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfituesit

Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë

AKTIVITETET TRAJNUESE NGA KEDNJ

Temë e identifikuar nga:

- Plani kombëtar për të drejtat e njeriut
- Raporti i IKD-së dhe OJQ-ve tjera për të drejtat e njeriut
- Raporti i Avokatit të Popullit
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut - Raste me ekspertiza të Gjykatës së Strasburgut

Kosova edhe pse akoma nuk është ende anëtare e Këshillit të Evropës dhe nuk është palë nënshkruese e KEDNJ-së, ajo është drejtpërdrejt e ndikuar nga jurisprudenca e GjEDNJ ky detyrim lind nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Fillimisht, Nenin 22 i Kushtetutës së Kosovës garanton zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të "Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj", prandaj KEDNJ dhe Protokollet kanë efekt ligjor të drejtpërdrejtë në Kosovë, me prioritet mbi ligjet e tjera. Për më tepër, në nenin 53 të Kushtetutës përcaktohet qartë se "të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Aplikimi i Jurisprudencës së GjEDNJ me rastin e shkrimit të vendimeve gjyqësore është shumë i rëndësishëm edhe për nga efekti i zbatimit të të drejtave të njeriut të garantuara me KEDNJ por edhe për unifikimin e praktikave vendimmarrjes në Gjykata të gjitha niveleve. Në praktikë edhe pse mund të konsiderohet problematike mirëpo tani gjyqtarët mund të kanë qasje në jurisprudencën e GjEDNJ-së duke ju falënderuar përdorimit të internetit. Duke qenë se interpretimi i të drejtave dhe lirive themelore bëhet në përputhje me jurisprudencën e GjEDNJ-së, është e nevojshme që profesionistët ligjorë të gjykatave dhe prokurorive të kenë njohuri për data bazat e GjEDNJ-së, platformat e Këshillit të Evropës, si dhe resurseve të tjera, siç janë udhëzuesit e GjEDNJ për Nenet përkatëse të KEDNJ. Njohuritë e fituara në këtë trajnim do të mundësojnë zhvillimin e shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke siguruar që shkrimi dhe arsyetimi ligjor të zhvillohet duke iu referuar Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgu-GjEDNJt.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i shkathtësive praktike në aplikimin e Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut;
- ⇒ Avancimi i njohurive rreth hulumtimit dhe identifikimit të rasteve konkrete apo dokumenteve në platformat e KE dhe GjEDNJ;
- ⇒ Përdorimi i platformave sipas nevojave dhe mënyrave të ndryshme për identifikimin e çështjeve, neneve përkatëse apo rasteve;
- ⇒ Aftësimi praktik i përdorimit të jurisprudencës së GjEDNJ me rastin e shkrimit ligjor, përfshirë citimin e rasteve adekuate, mënyrës së referimit në rastet e GjEDNJ-së, përdorimin e rasteve të GjEDNJ-së në situatat konkrete praktike;
- ⇒ Zhvillimi i shkathtësive të profesionistëve ligjor në shkrimin ligjor në përputhje me standardet e GjEDNJ-së me rastin e zbatimit të jurisprudencës së GjEDNJ.

Përmbajtja

- Aplikimin e Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, përfshirë shkathtësitë në gjetjen dhe hulumtimin e rasteve dhe dokumenteve në HUDOC dhe përdorimi i udhëzuesve të GJEDNJ;
- Shkrimi ligjor duke përfshirë citimin e rasteve nga Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, mënyrës së referimit në rastet e GJEDNJ-së, dhe zbatimimi më i mirë i tyre në praktikën gjyqësore në Kosovë në çështjet civile dhe penale.
- Shkrimi ligjor dhe rritja e kapaciteteve me rastin e arsyetimit të vendimeve në harmoni me jurisprudencën e GJEDNJ.

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet duke hulumtuar Jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut duke përfshirë prezantime dhe diskutime me raste konkrete nga GJEDNJ me përfshirjen edhe të pjesëmarrësve, me qasje në mjetet e kërkimit (search engines) të platformave si HUDOC dhe përdorimi praktik i Udhëzuesve të GJEDNJ. Ushtrime praktike të gjetjes, referimit dhe citimit të rasteve të GJEDNJ në harmoni me standardet e shkrimit ligjor.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026
- Raporti i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut
- Raporti i Avokatit të Popullit
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026

2. Zhvillimi i procedurës gjyqësore dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm

Procesi i rregullt ligjor është garanci me rëndësi jetike në çdo shoqëri demokratike, kështu që Parimet, procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm parimet si Transparenca dhe publiciteti i gjykimeve janë më të rëndësishme dhe më të atakuar të Konventës. Për procesin e rregullt ligjor ka më shumë çështje në gjykatë se për çdo lloj të drejte tjetër të parashikuar në Konventë. Përgjegjësia për sigurimin e procesit të rregullt ligjor bie shumë më tepër mbi gjyqtarët, prokurorët publikë. Të gjithë gjyqtarët të cilët drejtojnë një seancë gjyqësore që të sigurojnë që të respektohen të gjitha garancitë që përmban Neni 6 duke garantuar dhe respektuar procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm duke përfshirë transparenca dhe publicitetin e gjykimeve, pra që nga në fillimi i një seance duhet të kenë parasysh përgjegjësinë për të siguruar që këto garanci të respektohen si në çështjet penale ashtu edhe në ato civile. Çështja e tej zgjatjes së procedurave gjyqësore dhe shpeshherë anulimi i paarsyeshëm i seancave gjyqësore në praktikën tonë gjyqësore është mjaftë problematike prandaj gjyqtarët janë të obliguar që të sigurojnë që të respektohet parimi i përfundimit të çështjeve gjyqësore brenda afatit të arsyeshëm në mënyrë që të garantohet standardet e nenit 6 të KEDNJ përkatësisht procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm. Faktorët që institucionet e Konventës kanë krijuar për vlerësimin e faktit nëse procedura të caktuara kanë përmbushur standardin e afatit të arsyeshëm janë kompleksiteti i një çështjeje të dhënë, qëndrimi i autoriteteve, qëndrimi i kërkuesit dhe çfarë kërkohet prej kërkuesit. Gjykata vlerëson kompleksitetin e një çështjeje në dritën e faktorëve të tillë si natyra e fakteve apo pyetjet ligjore mbi çështjen në fjalë, numri i aktorëve të përfshirë si të paditur, palët apo dëshmitarët, kryerja e procedurave të ngjashme apo të lidhura me to dhe çfarë do lloj elementi ndërkombëtarë, duke u kujdesur që proceset të jenë të hapura dhe transparente, pasi që një procedurë që është e hapur vetëm për palët dhe përfaqësuesit e tyre nuk përmbush kërkesat e kësaj dispozite të Konventës. Gjithsesi, shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga seanca disiplinore që mbahen brenda burgjeve dhe kërkesa e procesit të hapur zbatohet në cilën do fazë të një procedure që ndikon vendimin mbi çështjen në fjalë.

Objektivat

- ⇒ Zhvillimi i shkathtësive praktike në aplikimin e Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut lidhur me procesin e rregullt dhe brenda një afati të arsyeshëm;
- ⇒ Përkufizojnë procesin e rregullt dhe brenda një afati të arsyeshëm të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ⇒ Kuptojnë në cilën fazë të procesit gjyqësor zbatohet këto parime;
- ⇒ Kuptojnë çfarë përfshinë e drejta për një seancë të hapur;
- ⇒ Mësojnë çfarë përfshinë nocioni i “procesit të drejtë”;
- ⇒ Analizojnë rastet e Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg lidhur me nenin 6.1 të Konventës Evropiane.

Përmbajtja

- Zbatimi i Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut lidhur me procesin e rregullt dhe brenda një afati të arsyeshëm.
- Aplikimi i kriterëve të GJEDNJ-së lidhur me procesin e rregullt dhe afatit të arsyeshëm sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Zbatimi i Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut lidhur me transparencën, të drejtën për një seancë të hapur dhe aksesit në gjykatë.
- Kompleksiteti çështjeve, tejzgjatja e proceseve gjyqësore, dhe praktika e GJEDNJ lidhur me këto çështje

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet duke hulumtuar Jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut duke përfshirë prezantime dhe diskutime me raste konkrete nga GJEDNJ procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm me theks te veçante në procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm, duke përdorur një metode interaktive me pjesëmarrësit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026
- Pyetësi për VNT për prokuror 2026
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Plani Kombëtar për të Drejtat e Njeriut
- KE-Projekti PROFREX

3. Liria e Shprehjes - Shpifja dhe Mbrojtja e Reputacionit

Shpifja dhe mbrojtja e reputacionit përbëjnë një nga fushat më të ndjeshme të balancimit ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtës për nder e reputacion. Gjyqtarët dhe prokurorët shpesh përballen me raste ku duhet të vendosin kufirin midis kritikës së ligjshme, edhe kur ajo është e ashpër, dhe shkeljes së të drejtave individuale. Ky trajnim do të fokusohet në mënyrë të veçantë në kuptimin e standardeve evropiane dhe vendore lidhur me shpifjen, duke përfshirë trajtimin e figurave publike, përgjegjësitë dhe sanksionet ndaj mediave, si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Ai synon të fuqizojë rolin e gjyqësorit në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe në të njëjtën kohë në respektimin e të drejtës për reputacion, në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e Këshillit të Evropës.

Objektivat

- ⇒ Kuptojnë standardet ligjore dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi shpifjen dhe mbrojtjen e reputacionit;
- ⇒ Diferencojnë ndërmjet kritikës së ligjshme (edhe të ashpër) dhe shpifjes së ndaluar;
- ⇒ Aplikojnë parimet mbi statusin e figurave publike dhe kufijtë e kritikës ndaj tyre;
- ⇒ Vlerësojnë përgjegjësitë dhe sanksionet në gazetari, duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit;
- ⇒ Zbatojnë standardet e Këshillit të Evropës në vendimmarrjen gjyqësore.

Përmbajtja

- Kuadri ligjor vendor dhe ndërkombëtar mbi shpifjen dhe mbrojtjen e reputacionit;
- Kritika e ashpër: kufijtë e saj dhe dallimi mes opinionit, fakteve dhe akuzave shpifëse;
- Figurat publike: standarde të veçanta për vlerësimin e kritikës ndaj tyre;
- Përgjegjësitë dhe sanksionet në gazetari: roli i mediave, editorëve dhe proporcionaliteti i masave civile/penale;
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së: rastet kyçe për shpifjen dhe reputacionin;
- Standardet e Këshillit të Evropës: rekomandimet për dekriminalizimin e shpifjes dhe sigurimin e një bilanci të drejtë midis lirive dhe të drejtave themelore.

Metodologjia

Aktiviteti trajnues do të mbështetet nga ekspertë ndërkombëtarë të cilët do të përqendrohen në standardet ndërkombëtare që lidhen me lirinë e shprehjes dhe metodologjinë e të mësuarit të të rriturve. Trajnimi do të jetë në përputhje me modelin ndërkombëtar të doracakut të trajnimit për lirinë e shprehjes dhe mediave i draftuar nga projekti i Këshillit të Evropës. Ky doracak trajnimi do të përdoret edhe për trajnime të tjera në fushën e lirisë së shprehjes të cilat do të zhvillohen në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Akademinë e Drejtësisë. Gjatë

trajnit do të sigurohen materiale dhe ushtrime për pjesëmarrësit. Trajnerët do të ofrojnë mundësi për diskutime të hapura mbi çështje të ndryshme të lidhura me temën e trajnimit dhe do t'ju mundësohet pjesëmarrësve një bazë solide për të zhvilluar aftësitë e tyre si trajnerë në fushën e lirisë së shprehjes.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një ditë (1).

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026
- Pyetësori për VNT për prokuror 2026
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Raporti i IAP
- Plani Kombëtar për të Drejtat e Njeriut

4. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja efektive në procedurat penale

Zbatimi i standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkatësisht KEDNJ-së, lind si detyrim nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Fillimisht, Nenin 22 i Kushtetutës së Kosovës garanton zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të "Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj", prandaj KEDNJ dhe Protokollet kanë efekt ligjor të drejtpërdrejtë në Kosovë, me prioritet mbi ligjet e tjera. Për më tepër, në nenin 53 të Kushtetutës përcaktohet qartë se "të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përdorimi i praktikës së GJEDNJ me rastin e shkrimit dhe argumentimit të vendimeve gjyqësore është shumë i rëndësishëm edhe për nga efekti i zbatimit të të drejtave të njeriut të garantuara me KEDNJ por edhe për unifikimin e praktikave vendimë marrjes në Gjykata të gjitha niveleve sidomos në Gjykatën e Apelit duke qenë se Gjykata e Apelit në sistemin gjyqësor të Kosovës konsiderohet si unifikues i praktikës gjyqësore. Përdorimi i zgjeruar paraburgimit shpesh është një simptomë e mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale, që mund të rezultojë në mungesë të mbrojtjes së të drejtave të të paraburgosurve. Kjo mund të sjellë trajtimin e tyre çnjerëzor dhe degradues, Paraburgimi, kur nuk respektohen standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni ynë i brendshëm rezulton me shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, prandaj Prokurorët janë të obliguar që të kujdesen me rastin e paraqitjes së kërkesave për paraburgim.

Objektivat

- ⇒ Zhvillimi i shkathtësive praktike në zbatimin e standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkatësisht KEDNJ-së;
- ⇒ Zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të "Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj", prandaj KEDNJ dhe Protokollet e saja në Kosovë;
- ⇒ Përdorimi i praktikës së GJEDNJ me rastin e shkrimit dhe argumentimit të vendimeve gjyqësore për nga efekti i zbatimit të të drejtave të njeriut të garantuara me KEDNJ dhe unifikimi i praktikave vendimë marrjes në Gjykata të gjitha niveleve sidomos në Gjykatën e Apelit;
- ⇒ Respektimi i standardet ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm në frymën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me rastin e aplikimit të masës së paraburgimit përkatësisht paraqitjes së kërkesave për paraburgim nga ana e Prokurorëve.

Përmbajtja

- Zbatimi i standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkatësisht KEDNJ-së;
- Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e KEDNJ dhe Protokollet e saj, me rastin e shkrimit dhe argumentimit të vendimeve gjyqësore për nga efekti i zbatimit të të drejtave të njeriut të garantuara me KEDNJ
- Unifikimi i praktikave vendimmarrjes në Gjykata të gjitha niveleve sidomos në Gjykatën e Apelit; Respektimi i standardet ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm në frymën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me rastin e aplikimit të masës së paraburgimit përkatësisht paraqitjes së kërkesave për paraburgim nga ana e Prokurorëve.

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet duke analizuar praktikën tonë në raport me Jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut duke përfshirë prezantime dhe diskutime me raste konkrete nga GJEDNJ procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm me theks te veçante në procesi i drejtë, i paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm, duke përdorur një metode interaktiv me pjesëmarrësit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- KE-Projekti PROFREX

5. Konferenca mbi temën për lirinë e shprehjes dhe mediave

Liria e shprehjes është një nga të drejtat themelore të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe një shtyllë kyçe e shoqërisë demokratike. Ajo mundëson shkëmbimin e lirë të ideve, transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike. Megjithatë, kjo e drejtë shpesh përballët me sfida në praktikë: kufizime të paarsyeshme, balancimin me të drejta të tjera themelore, ndikimet e teknologjive të reja, si dhe presionet mbi gazetarët dhe mediat. Roli i gjyqësorit në këtë drejtim është thelbësor për të siguruar një ekuilibër të drejtë ndërmjet të drejtave dhe lirive themelore dhe për të mbrojtur diskursin publik demokratik. Në këtë kontekst, do të organizohet një konferencë kushtuar çështjeve të lidhura me lirinë e shprehjes. Tema e saktë e konferencës do të përcaktohet në koordinim me partnerët institucionalë, duke reflektuar nevojat dhe zhvillimet më aktuale në fushë.

Objektivat

- ⇒ Diskutojë çështje kyçe të lidhura me lirinë e shprehjes në kontekstin vendor dhe evropian;
- ⇒ Theksojë rolin e gjyqësorit në mbrojtjen dhe zhvillimin e standardeve të lirisë së shprehjes;
- ⇒ Krijojë një platformë ndërvepruese për shkëmbimin e ideve dhe përvojave ndërmjet profesionistëve ligjorë, gazetarëve dhe shoqërisë civile;
- ⇒ Nxisë reflektimin mbi zhvillimet e reja ligjore dhe praktikat gjyqësore në këtë fushë.

Përmbajtja (përzgjedhur në varësi të temës)

- Standardet ndërkombëtare dhe evropiane mbi lirinë e shprehjes;
- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Balancimi i lirisë së shprehjes me të drejtat e tjera (privatësia, reputacioni, siguria publike);
- Tendencat e reja në nivel të BE-së dhe Këshillit të Evropës;
- Roli i institucioneve vendore në zbatimin e standardeve evropiane;
- Përvoja dhe perspektiva të gazetarëve, avokatëve dhe shoqërisë civile.

Metodologjia

Konferencë njëditore me fjalime hyrëse dhe prezantime të ekspertëve, panele diskutimi me gjyqtarë, prokurorë, avokatë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, sesione ndërvepruese dhe diskutime të hapura me pjesëmarrësit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, avokatë, gazetarë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe Akademisë (të përzgjedhur, jo me aplikim)

Kohëzgjatja

Konferenca do zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA E DREJTA
EVROPIANE***

Temë e identifikuar nga:

- Qendra Evropiane për Gjyqtarë dhe Avokatë (Qendra e Luksemburgut të Institutit Evropian për Administratë Publike/EIPA)

1. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe komerciale

Gjatë 15 viteve të fundit, një zhvillim i rëndësishëm ka ndodhur në fushën e së drejtës evropiane, i cili, megjithatë, mbetet kryesisht i pavërejtur nga praktikuesit ligjorë (gjyqtarët kombëtarë, avokatët, etj.). E drejta ndërkombëtare private ose - siç quhet në Traktat - 'bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile' është zhvilluar në një fushë të pavarur dhe të veçantë të së drejtës evropiane. Meqenëse Traktati i Amsterdimit i dha kompetencën Bashkimit Evropian për të nxjerrë ligje në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, një numër i rëndësishëm aktesh legjislative evropiane në këtë fushë janë miratuar. Ashtu si me fushat e tjera të së drejtës së Bashkimit Evropian, instrumentet e miratuara në këtë fushë kanë përparësi ndaj ligjeve të brendshme të Shteteve Anëtare dhe ndërlidhen me ligjin kombëtar kur bëhet fjalë për vendosjen në nivel të Bashkimit të standardeve minimale procedurale të përbashkëta në fusha të veçanta ligjore. Si rezultat, gjyqtarët kombëtarë e gjejnë veten gjithnjë e më shumë të përballur me situata që kanë implikime ndërkufitare dhe me probleme dhe çështje ligjore të rregulluara nga ligjet e BE-së. Situata të tilla mund të përfshijnë, për shembull, përmbushjen e kontratave që përfshijnë dërgimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve përtej kufijve, çështjet ligjore në lidhje me lëvizjen e turistëve dhe aksidentet e trafikut jashtë vendit, çështjet në lidhje me blerjen dhe asgjësimin e pronës, të luajtshme dhe të paluajtshme, nga individë dhe biznese në një ose më shumë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian, të ndryshëm nga ai në të cilin ata janë të vendosur, dhe trashëgim të pronave të individëve që kanë pronë dhe lidhje me disa Shtete Anëtare. Në fushën e së drejtës familjare gjithashtu, marrëdhëniet personale shumëkombëshe janë gjithnjë e më të shpeshta dhe pyetjet ligjore lindin rregullisht në rastet e marrëdhënieve ndërkufitare të familjes dhe përgjegjësisë prindërore. Njëlloj, në ditët e sotme, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të cilat janë një komponentë e madhe e tregut të brendshëm evropian po kryejnë transaksione përtej kufijve pothuajse në baza ditore dhe shpesh online.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth evolucionit të kornizës institucionale dhe vendimmarrëse të sektorit të drejtësisë civile në BE;
- ⇒ të kuptojnë instrumentet ligjore aktualisht në fuqi dhe të fitojnë një pasqyrë në përafrimin dhe harmonizimin e ligjeve civile të BE-së.

Përmbajtja

- Qarkullimi i lirë i vendimeve në çështje Civile dhe Komerciale;
- E drejta e zbatueshme në çështje Civile dhe Tregtare;
- Qarkullimi i lirë i gjykimit në çështje Familjare;
- Aspektet procedurale të bashkëpunimit gjyqësor në çështje Civile;
- Rregullimi jashtë Gjykatës, metodat alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Civile dhe Tregtare në Bashkim Evropian.

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive dhe analizë të rasteve gjyqësore.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtarët gjykatave themelore, dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Qendra Evropiane për Gjyqtarë dhe Avokatë (Qendra e Luksemburgut të Institutit Evropian për Administratë Publike/EIPA)

2. Bashkëpunimi gjyqësor dhe i zbatuesve të ligjit në çështje penale

Trajnimi prezanton konceptet bazë, objektivat dhe format e bashkëpunimit dhe institucionet e së drejtës penale të BE-së. Ai gjithashtu përshkruan se si kuadri institucional dhe vendimmarrës për bashkëpunimin në çështjet penale ka evoluar brenda BE dhe fokusohet në procedurën legislative dhe instrumentet ligjore në fuqi aktualisht në këtë kuadër. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shpjegimit të ndryshimit midis ndihmës së ndërsjellë juridike dhe njohjes reciproke. Instrumentet kryesore, të tilla si Urdhër Arrestimi Evropian, do të analizohen në detaje. Për më tepër, arrijtjet kryesore të së drejtës penale materiale dhe procedurale do të shpjegohen së bashku me drejtimet në të cilat duket se evoluon zhvillimet juridike në këtë fushë. Më tej, moduli do të fokusohet në rolin e gjyqtarëve dhe prokurorëve kombëtarë në zbatimin e ligjit penal të BE-së dhe ndikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së BE-së në interpretimin dhe formësimin e kësaj fushe ligjore.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth përdorimit në mënyrë efektive parimet ligjore, instrumentet e ndryshme ligjore dhe procedurat e zbatimit të së drejtës penale të BE-së;
- ⇒ Aftësia për të trajtuar vendimet e rolit të Gjykatës së Drejtësisë së BE, në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e së drejtës penale të BE-së dhe aftësinë për të punuar me të me anë të procedurës së vendimit preliminar;
- ⇒ Kuptimi i ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet sistemeve kombëtare të drejtësisë penale të Shteteve Anëtare dhe shpërndarjes së kompetencave ndërmjet funksioneve të hetimit dhe ndjekjes penale;
- ⇒ Avancimi i njohurive për të përdorur në praktikë asistencën e ndërsjellë juridike dhe instrumentet e njohjes reciproke në fushën e së drejtës penale të BE-së.

Përmbajtja

- Drejtësia Penale dhe Legjislacioni i BE-së;
- Ndihma juridike dhe njohja reciproke;
- Mbrojtja e të drejtave themelore, të drejtave procedurale dhe mbrojtje në procedurën penale;
- Fushat specifike të Krimit, e drejta Penale materiale.

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive dhe analizë të rasteve gjyqësore.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtarët gjykatave themelore, dhe bashkëpunëtorët profesional.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA LËMIA E
KUNDËRVAJTJES***

Temë e identifikuar nga:

- Pyetësi për vlerësim të nevojave për trajnime të vazhdueshme (gjyqtarë/prokurorë)
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Kundërvajtja, kompetenca dhe përgjegjësitë sipas dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje

Duke marrë për bazë ndryshimet ligjore si dhe mosharmonizimin e duhur në praktikë nevojitet unifikim sidomos në raport me ndërlidhjen e procedurës kundërvajtëse me atë penale, zbatimin e ligjit të favorshëm, kompetencës dhe përgjegjësisë. Lëmia e kundërvajtjes është lëmi specifike pasi veprat kundërvajtëse mund të përcaktohen edhe me dispozita të veçanta, mënyra e kryerjes dhe vendi i kryerjes e përcakton edhe kompetencën.

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë drejtë procedurën e kundërvajtjes;
- ⇒ Të vlerësojnë drejtë kompetencën;
- ⇒ Të zbatojnë drejtë dispozitat që e përcaktojnë përgjegjësinë
- ⇒ Përshkrimin faktik të veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes;
- ⇒ Cilësimi juridik i kundërvajtjes;
- ⇒ Vendimi për fillim të procedurës-kushtet.

Përmbajtja

- Kompetenca sipas ligjit të ri;
- Përgjegjësitë e akterve të ndryshëm në procedurën kundërvajtëse;
- Zhvillimi i procedurës dhe mjetet e goditje.

Metodologjia

Për realizimin e këtij trajnimit do të përdorën metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, prezantime në PowerPoint, pyetje e përgjigje, të përcjellore me shembuj praktik, dhe analizimi i përbashkët i problemeve rreth aplikimit të këtyre dispozitave në praktikë, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfituesit

Gjyqtarët e gjykatave themelore, Divizioni i kundërvajtjes.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë 1 (një) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE NGA KOMPETENCA
INTERDISCIPLINARE***

Temë e identifikuar nga:

- Propozimi për trajnime nga KGJK
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Etika dhe sjellja profesionale për gjyqtarë

Praktikat etike të gjyqtarit janë ndër hapat e parë të mëdhenj drejtë krijimit të një mjedisi institucional i cili do të përmirësojë besueshmërinë e qytetarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës. Qasja etike do të shërbejë si gur themel për vetëbesimin e gjyqtarëve apo prokuroreve kur ofrojnë shërbimet e tyre që kanë të bëjnë me drejtësinë. Megjithatë, kodet e etikës dhe të sjelljes janë pjesë e një kuadri më të gjerë. Kodet profesionale nuk duhet, dhe nuk mund të qëndrojnë në vetvete (të pavarura). Kodet profesionale duhet të merren parasysh bashkë me përkrahjet e punës, me betimin për ndershmëri, me vlerësimet e performancës dhe me format e tjera të mbikëqyrjes dhe udhëheqjes. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth zbatimit të parimeve kryesore të etikës, të cilat janë të përcaktuara me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtarë dhe jo vetëm, siç janë pavarësia, paanësia, integriteti, konflikti i interesit, barazia, përdorimi i mediave sociale, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë, konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat etj. Përveç kësaj do të trajtohet edhe praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJEDNJ-së, e cila ndërlidhet me çështjet dhe parimet kryesore etike, siç janë pavarësia dhe paanësia e gjyqtarit etj, e që vlerësohet se do të jetë një ndihmesë e madhe për gjyqtarët në kuptimin dhe zbatimin e parimeve kryesore të etikës.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Si zbatohet në praktikë parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore nga gjyqtarët? Si zbatohet në praktikë parimi i integritetit të gjyqtarit, si dhe cilat janë pasojat nëse nuk respektohet një parim i tillë? Çka nënkupton komunikimi ex parte dhe si duhet të shmangët gjyqtari një komunikimi të tillë? Cilat janë detyrimet etike të gjyqtarit në zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të palëve në procedura gjyqësore? Çka nënkupton konflikti i interesit, si dhe si duhet të shmangët nga gjyqtari? Çka përfshin ruajtja e konfidencialitetit të procedurës gjyqësore nga gjyqtari, si dhe si duhet të sillet i njëjti në raport me mediat dhe publikun? A lejohet përdorimi i rrjeteve sociale nga ana e gjyqtarëve, nëse po në çfarë kushte? A lejohet pranimiti i dhuratave nga ana e gjyqtarit? Cili është roli i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore dhe në cilat raste gjyqtarët mund të drejtohen të njëjtit për sqarimin e dilemave rreth zbatimit të parimeve kryesore të etikës.

Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës përmes trajtimit të çështjeve dhe parimeve kryesore të etikës profesionale të cekura më lartë, zbatimi me korrektësi i të cilave nga gjyqtarët do të forcojë besimin e publikut në gjyqtarin në veçanti dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi, si dhe do të ketë ndikim pozitiv tek gjyqtarët që gjatë punës së tyre dhe jo vetëm, të jenë të pavarur, të paanshëm, me integritet, duke i trajtuar të gjitha palët në mënyrë të barabartë. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën gjyqësore vendore dhe të GJEDNJ-së, e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me zbatimin e parimeve të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe jo vetëm dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë për rregullat bazë të etikës gjyqësore sipas Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar;
- ⇒ Zbërthejnë parimet dhe rregullat e Kodit në situata të ndryshme të jetës reale;
- ⇒ Identifikojnë dhe zgjidhin problemet etike;
- ⇒ Zhvillojnë mendimin kritik në lidhje me etikën;
- ⇒ Zbatojnë drejtë rregullat etike dhe Kodin e Etikës Profesionale.

Përmbajtja

- Etika profesionale dhe Kodi i Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Pavarësia dhe paanësia;
- Integriteti dhe konflikti i interesit;
- Barazia, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë;
- Komunikimi ex parte;
- Dhuratat;
- Përdorimi i mediave sociale;
- Konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat.
- Praktika gjyqësore vendore dhe e GJEDNJ-së për shkelje të etikës.
- Roli i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Gjyqtarët e të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026
- Propozimi për trajnime nga KPK
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën

2. Etika dhe sjellja profesionale për prokurorë

Praktikat etike të prokurorit janë ndër hapat e parë të mëdhenj drejtë krijimit të një mjedisi institucional i cili do të përmirësojë besueshmërinë e qytetarëve në sistemin prokurorial të Kosovës. Qasja etike do të shërbejë si gur themel për vetëbesimin e prokuroreve kur ofrojnë shërbimet e tyre që kanë të bëjnë me drejtësinë. Megjithatë, kodet e etikës dhe të sjelljes janë pjesë e një kuadri më të gjerë. Kodet profesionale nuk duhet, dhe nuk mund të qëndrojnë në vetvete (të pavarura). Kodet profesionale duhet të merren parasysh bashkë me përkrahjet e punës, me betimin për ndershmëri, me vlerësimet e performancës dhe me format e tjera të mbikëqyrjes dhe udhëheqjes. Në këtë trajnim ndër të tjera do të trajtohen çështjet rreth zbatimit të parimeve kryesore të etikës, të cilat janë të përcaktuara me Kodin e Etikës Profesionale për prokurorë dhe jo vetëm, siç janë pavarësia, paanësia, integriteti, konflikti i interesit, barazia, përdorimi i mediave sociale, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë, konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat etj.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Si zbatohet në praktikë parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore nga prokurorët? Si zbatohet në praktikë parimi i integritetit të prokurorit, si dhe cilat janë pasojat nëse nuk respektohet një parim i tillë? Çka nënkupton komunikimi ex parte dhe si duhet të shmanget prokurori një komunikimi të tillë? Çka nënkupton konflikti i interesit, si dhe si duhet të shmanget nga prokurori? A lejohet përdorimi i rrjeteve sociale nga ana e prokuroreve, nëse po në çfarë kushte? A lejohet pranimi i dhuratave nga ana e prokurorit?

Trajnimi do të shërbejë si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për prokurorët pjesëmarrës përmes trajtimit të çështjeve dhe parimeve kryesore të etikës profesionale të cekura më lartë, zbatimi me korrektësi i të cilave nga prokurorët do të forcojë besimin e publikut në he prokurorin në veçanti dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi, si dhe do të ketë ndikim pozitiv tek e prokurorët që gjatë punës së tyre dhe jo vetëm, të jenë të pavarur, të paanshëm, me integritet, duke i trajtuar të gjitha palët në mënyrë të barabartë.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë për rregullat bazë të etikës sipas Kodit të Etikës Profesionale për prokurorë;
- ⇒ Zbërthejnë parimet dhe rregullat e Kodit në situata të ndryshme të jetës reale;
- ⇒ Identifikojnë dhe zgjidhin problemet etike;
- ⇒ Zhvillojnë mendimin kritik në lidhje me etikën;
- ⇒ Zbatojnë drejtë rregullat etike dhe Kodin e Etikës Profesionale.

Përmbajtja

- Etika profesionale dhe Kodi i Etikës për prokurorë;
- Pavarësia dhe paanësia;
- Integriteti dhe konflikti i interesit;
- Barazia, profesionalizimi dhe përgjegjësia në punë;
- Komunikimi ex parte;
- Dhuratat;
- Përdorimi i mediave sociale;
- Konfidencialiteti dhe raportet me publikun dhe mediat.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Prokurorët e të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjat një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Raporti nga takimi me gjyqtarët e fushës penale
- Raportet e Organizatave që monitorojnë sistemin e drejtësisë
- Pyetësi për VNT për gjyqtarë 2026
- Pyetësi për VNT për prokurorë 2026

3. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është njëri ndër kompetentët kryesor përmes së cilës pasqyrohet vendimmarrja e drejtë e gjykatave dhe pasqyron profesionalizmin dhe njohuritë konkrete të gjyqtarit në raport me lëndën dhe standardet ndërkombëtare. Ky Trajnim synon që të përmirësoj nivelin e shkrimit dhe arsyetimin dhe paraqitet si ndihmës për gjyqtarët, prokuroret, bashkëpunëtorët dhe zyrtarët ligjor në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale lidhur me hulumtimin ligjor, shqyrtimin gjyqësor dhe hartimin e vendimeve gjyqësore.

Trajnimi si i tillë për shkak të tematikës do të jetë një reflektim i të gjeturave praktike ku përmes këtyre të gjeturave do të përfitojnë të trajnuarit në aspektet e shkrimit dhe arsyetimit me fokus në zhvillimin e aftësive analitike tek pjesëmarrësit duke trajtuar mënyrën së si duhet t'i qasemi një çështjeje juridike, si duhet të realizohet hulumtimi i resurseve për çështjen objekt shqyrtimi, si duhet të realizohet analiza ligjore dhe sipas cilave standarde duhet të bëhet shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Përveç udhëzimeve teorike lidhur me parimet dhe metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, pjesë e këtij trajnimi do të jenë edhe rastet dhe udhëzimet praktike në mënyrë që pjesëmarrësit njohurit e fituara të mund t'i aplikojnë në praktikë.

Përmes udhëzimeve dhe rasteve konkrete nga fusha civile dhe penale pjesëmarrësit do të kenë mundësi që duke zbatuar kërkesat e ligjeve nga procedura penale dhe civile të japin konkluzionet e tyre për vendosjen e çështjeve që trajtojnë. Shkrimi dhe arsyetimi ligjor paraqet standard vlerësimi të punës së gjykatave. Në këtë kuptim shkrimi dhe arsyetimi ligjori në punë e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe zyrtarëve e përfaqëson një objektiv jo lehet të arritshëm, prandaj përmes këtij trajnimi synohet që përmirësohet cilësia e shkrimit dhe arsyetimit ligjor në punën e tyre.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Praktika aktuale, problemet e identifikuar praktike, cilësia e shkrimit dhe e arsyetimit, niveli i zhvillimit të shkathtësive analitike dhe aplikimi i standardeve ndërkombëtare të shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë cilësinë rreth arsyetimit ligjor;
- ⇒ Avancimi i shkathtësive analitike me rastin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore;
- ⇒ Modelet e të shkruarit dhe arsyetimit ligjor;
- ⇒ Ngrisin aftësitë rreth interpretimi;
- ⇒ Avancojnë njohuritë për kualifikimin e duhur të veprës në aktakuzë dhe akte tjera prokuroriale.

Përmbajtja

- Llojet e arsyetimit ligjor;
- Parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- Kërkesat ligjore për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore;
- Zbatimi i metodës IRAC të vendimet penale;
- Kualifikimi i duhur i veprës në aktakuzë dhe akte tjera prokuroriale;
- Shkrimi pa gabime;
- Numri akteve të kthyer për plotësim nga gjykata.

Metodologjia

Trajtimi teorik i elementeve të shkrimit, mënyrës së formularit të akteve ligjore, interpretimit të akteve, analizës së fakteve, i hartimit të akteve kryesore procedurale. Diskutim teorik lidhur me dispozitat ligjore procedurale që i referohen kërkesave ligjore për shkrimin e akteve ligjor. Demonstrim praktik i mënyrës së arsyetimit dhe shkrimit ligjor. Diskutim teorik dhe praktik për metodat e analizës ligjore në rastet konkrete. Prezantim i rasteve civile dhe penale dhe diskutime për mënyrën e vendosjes së supozuar meritore për rastet konkrete. Pjesëmarrësit përveç kontributit të tyre në diskutime sfidojnë edhe idetë e trajnuesit lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve alternative apo edhe problematike.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional.

Kohëzgjatja

Trajnim do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026
- Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale

4. Empatia ndaj viktimave, Udhëzimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale

Ballafaqimi me të kaluarën/Drejtësia Tranzicionale është një proces afatgjatë që synon krijimin e një kulture llogaridhënieje dhe sundimi të ligjit. Drejtësia tranzicionale ("DT") bazohet në respektimin e të drejtave individuale dhe kolektive për të vërtetën, qasjen në drejtësi dhe adresimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut. Masat e DT-së duhet të jenë në përputhje me standardet dhe parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Strategjia për Drejtësi Tranzicionale është hartuar duke u bazuar në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimet e drejtësisë tranzicionale. Proces i hartimit të strategjisë, ka zgjatur nga korriku 2021 deri në qershor 2024 kur është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia është hartuar përmes konsultimeve publike me grupet e viktimave, institucionet relevante, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe palët tjera të interesit. Janë organizuar gjithsej 30 takime me viktimat dhe përfaqësuesit e tyre nga të gjitha komunitetet, gratë, të rinjtë dhe studentët, punëtorët në sektorin publik, aktivistët e të drejtave të njeriut, punonjësit e arsimit, intelektualët, gazetarët, bashkësitë fetare në Kosovë, profesionistët juridikë, të sektorit të sigurisë dhe punëtorët socialë. Strategjia për Drejtësi Tranzicionale ofron një qasje dhe përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj trashëgimisë së shkeljeve të të drejtave të njeriut përmes angazhimit në transformime politike, ligjore, socio-kulturore dhe ekonomike për ta konsoliduar paqen dhe për ta ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse. Lloji i qasjes së drejtësisë tranzicionale do të varet nga konteksti, historia, kultura dhe prioritetet vendore të Kosovës, në veçanti nga pritjet e viktimave. Përmes aktiviteteve të parapara, Strategjia për Drejtësi Tranzicionale do ta përforcojë zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës në respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, ligjet nacionale dhe konventat ndërkombëtare. Qëllimet e Strategjisë janë: adresimi i krimeve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe krimeve tjera që janë e shkelje e së drejtës ndërkombëtare, për periudhën kohore 1989 – 2000.

Përmes parimeve dhe vlerave që përfaqëson Drejtësia Tranzicionale, institucionet e drejtësisë jo vetëm që duhet t'i sjellin para drejtësisë përgjegjësit për krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, por edhe duhet të fokusohen në arritjen e drejtësisë për kategoritë e viktimave. Institucionet e drejtësisë të Republikës së Kosovës janë përgjegjëse për të siguruar që Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale të zbatohet me sukses duke i ndjekur parimet e së vërtetës, drejtësisë, riparimit dhe garancisë së mos përsëritjes. Ato duhet t'i ndjekin penalisht përgjegjësit për krimet e luftës, t'i mbështesin proceset për zbardhjen e së vërtetës dhe të sigurojnë që viktimat ta marrin drejtësinë dhe kompensimin e duhur, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të qëndrueshme. Trajnimi synon të ofroj informata dhe udhëzime të veçanta, për zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale, duke përfshirë hapa të rëndësishëm, përgjegjësi dhe mekanizma specifik për të siguruar një zbatim efektiv dhe të qëndrueshëm. Ky trajnim synon të rrisë kapacitetet e prokurorëve dhe gjykatësve në kuptimin dhe zbatimin e parimeve të drejtësisë tranzicionale, me fokus të veçantë në empatinë ndaj viktimave. Përmes njohjes së udhëzimeve dhe përgjegjësiave ligjore dhe morale, me profesionistët e drejtësisë do të analizohen qasjet specifike humane dhe të drejta në trajtimin e rasteve që përfshijnë viktimat e krimeve të luftës, dhunës së organizuar dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Cilat janë përgjegjësitë specifike që rrjedhin nga Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale në trajtimin e viktimave? Si mund të balancohet roli profesional i prokurorit dhe gjykatësit me nevojën për empati ndaj viktimave? Si të identifikohen dhe adresohen nevojat psikologjike dhe sociale të viktimave gjatë procesit gjyqësor? Çfarë sfidash paraqet zbatimi praktik i udhëzimeve në situata të ndryshme të rasteve? Trajnimi do të përdorë shembuj konkretë, raste studimore, role-play dhe diskutime të hapura për të nxjerrë në pah dilemat praktike dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Ekspertë të fushës së drejtësisë tranzicionale dhe psikologjisë do të ofrojnë inpute multidisiplinore për të ndihmuar pjesëmarrësit të zhvillojnë një qasje të mirë balancuar dhe të qëndrueshme.

Objektivat

- ⇒ Të njohin parimet bazë të drejtësisë tranzicionale dhe rolin e empatisë ndaj viktimave;
- ⇒ Të identifikojnë udhëzimet dhe përgjegjësitë ligjore në zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale;
- ⇒ Të zhvillojnë aftësi praktike për komunikim empatik dhe trajtim të respektueshëm të viktimave gjatë procesit gjyqësor;
- ⇒ Analizojnë raste të ndryshme për të kuptuar sfidat dhe për të gjetur zgjidhje praktike;
- ⇒ Të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe aktorëve tjerë për mbrojtjen e viktimave.

Përmbajtja

- Hyrje në drejtësinë tranzicionale, kuptimi dhe rëndësia;
- Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale: objektivat, prioritetet dhe rolet e prokurorëve dhe gjykatësve;
- Empatia ndaj viktimave: koncepti, rëndësia dhe ndikimi në procesin gjyqësor;
- Udhëzimet ligjore dhe praktike për trajtimin e viktimave gjatë hetimeve dhe seancave gjyqësore;
- Psikologjia e viktimave dhe nevojat e tyre gjatë procesit të drejtësisë;
- Sfida dhe dilema etike në praktikën e prokurorisë dhe gjyqësisë;
- Shembuj praktikë dhe raste studimore nga konteksti vendor dhe ndërkombëtar;
- Metodat për ndihmën psikologjike dhe mbështetjen sociale për viktimat gjatë procedurave gjyqësore.

Metodologjia

Trajnimi do të realizohet përmes prezantimit interaktive, diskutimeve punës në grupe dhe rastet studimore, Role-play, video dhe materiale multimediale për ilustrimin e koncepteve, pyetje dhe përgjigje për sqarimin e çështjeve të ndryshme.

Përfituesit

Gjyqtarë dhe prokurorë që trajtojnë raste të proceseve drejtësisë tranzicionale dhe shkelje të të drejtave të njeriut të gjitha niveleve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR DHUNËN NDAJ
GRAVE, DHUNËN NË FAMILJE DHE DHUNËN
NË BAZË GJINORE***

Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave

1. Dhuna ndaj Grave, Dhuna në Familje dhe Dhuna në Bazë Gjinore

Me përfshirjen e Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (më tutje Konventa e Stambollit) në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në vitin 2020 dhe CEDAW në 2008, të gjithë zyrtarët e drejtësisë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të kenë njohuri për standardet ndërkombëtare dhe mënyrën se si t'i zbatojnë ato në mënyrë efektive në punën e tyre, andaj ky trajnim synon ta arrij edhe këtë objektivë. Qëllimi i trajnimit është ngritja e kapaciteteve të kuadrit ligjor mbi konceptet kryesore, kornizat normative vendore dhe ligjet që lidhen me Dhunën ndaj Grave (DhNG), Dhunën në Familje (DhF) dhe Dhunën me Bazë Gjinore (DhBGJ).

Objektivat

- ⇒ Ngritja e kapacitetet dhe njohurive të zyrtarëve ligjor mbi konceptet bazë të Dhunës ndaj Grave (DhNG), Dhunën në Familje (DhF) dhe Dhunën me Bazë Gjinore (DhBGJ);
- ⇒ Kuptimi i koncepteve kyçe që kanë të bëjnë me DHNG-në, DHF-në dhe DHBGJ-në dhe njohja e barrierave të përbashkëta për qasje në drejtësi për viktimat në Kosovë;
- ⇒ Referimi në instrumentet kyçe ligjore ndërkombëtare dhe evropiane, veçanërisht Konventën e Stambollit në punën e tyre të përditshme, si e zbatueshme drejtpërdrejt në legjislacionin e Kosovës;
- ⇒ Identifikimi dhe artikulimi i ligjeve vendore të zbatueshme në mënyrë që t'i përgjigjen në mënyrë efektive DHNG-së, DHF-së dhe DHBGJ-së;
- ⇒ Zbatimi i një qasje të përqendruar te viktimat, e përgjegjshme ndaj gjinisë dhe e informuar për traumën, duke siguruar përgjegjshmërinë e kryerësit të dhunës në rastet e DHNG-së, DHF-së dhe DHBGJ-së;
- ⇒ Kuptimi i rolit të rëndësishëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë, si nga këndvështrimi i së drejtës civile ashtu edhe ai penal, në mbrojtjen e viktimave të DHNG-së, DHF-së dhe DHBGJ-së dhe sigurimin e qasjes së tyre në drejtësi;
- ⇒ Kuptimi i rëndësisë e bashkëpunimit dhe koordinimit për të siguruar standarde më të larta dhe efikasitet më të madh në sistemin gjyqësor dhe masa më të mira që synojnë kryesit e dhunës.

Përmbajtja

- DHNG-në, DHF-në dhe DHBGJ-në – përkufizimet, konceptet kryesore, shkaqet dhe pasojat rrënjësore;
- Format dhe taktikat e DHNG-së, DHF-së dhe DHBGJ-së;
- Legjislacioni vendor parësor dhe dytësor lidhur me DHNG-në;
- Programet për trajtimin e kryesve të dhunës dhe përfshirjen e tyre si pjesë të dënimit;

- Parimet dhe konceptet thelbësore (vlerësimi i natyrës gjinore të dhunës; qasja e përqendruar te viktimat, përgjegjësia e kryerësit të dhunës, si dhe informuar për traumat dhe të qenit i lirë nga çdo stereotip gjinor);
- Rishikimi i përgjigjeve kyçe të drejtësisë penale ndaj DHNG-së, DHF-së dhe DHBGJ-së - zhvillimi i praktikave specifike të udhëhequra nga parimet thelbësore;
- Rishikimi i përgjigjeve kyçe të drejtësisë civile ndaj DHNG-së, DHF-së dhe DHBGJ-së - zhvillimi i praktikave specifike të udhëhequra nga parimet thelbësore.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit është e përzier, rekomandohet që të kombinohet ndjekja e kursit online në platformën kryesore të Këshillit të Evropës për Profesionistët ligjor “HELP”, kursi “Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, i cili mbulon Konventën e Stambollit dhe ligjet dhe politikat përkatëse vendore për DhNG, DhF dhe DhBGJ. Gjithashtu, propozohet që pjesa tjetër e trajnimit të jetë me prezencë fizike për të ofruar tek pjesëmarrësit mundësi për të reflektuar se si t'i zbatojnë këto parime në praktikë në punën e tyre.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistëve të tjerë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë 1 (një) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave

2. Veprat e dhunës në familje: Përgjigja efektive e drejtësisë penale

Qëllimi i Programit të Trajnimit është të përgatisë gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistë të tjerë për të trajtuar në mënyrë efektive rastet që përfshijnë DhNG, DhF dhe DhBGj në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare, me fokus në sigurimin e një qasjeje të përqendruar tek viktimat, të mirë-informuar mbi traumën, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe qasje ku kryerësi i dhunës mbahet përgjegjës, ashtu që të kontribuohet në ndalimin e ciklit të mosndëshkueshmërisë, sipas kërkesave të Konventës së Stambollit.

Objektivat

- ⇒ Ngritjen e kapaciteteve për t'i dhënë një përgjigje efektive rasteve të dhunës në familje;
- ⇒ Artikulojnë dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Udhëzimeve dhe Politikave përkatëse të Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë, si dhe përkufizimet e reja në Ligjin për DHNG, DHF dhe DHBGJ.
- ⇒ Kuptojnë dinamikën e kontrollit dhe detyrimit dhe shkencën e traumës dhe efektet e traumës në të menduarit dhe sjelljen e viktimave;
- ⇒ Përdorin teknika për të siguruar qasjen e përqendruar te viktimat, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe llogaridhënies së kryesit të dhunës në ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të DHF-së, duke përfshirë balancimin e të drejtave të viktimës dhe të akuzuarit dhe në menaxhimin e viktimave ngurruese të DHF-së;
- ⇒ Vlerësojnë rrezikun dhe mënyrën se si t'i përdorni ato në seancat e lirimit para gjykimit ose të marrin vendime për lirimin me kusht duke marrë parasysh sigurinë e viktimës.
- ⇒ Sigurojnë hetim gjithëpërfshirës dhe mbledhje të të gjitha provave përkatëse;
- ⇒ Zhvillojnë aftësitë për vlerësimin e saktë të provave (për prokurorët në ushtrimin e gjykimin prokurorial dhe përzgjedhjen e akuzave; për gjyqtarët, të inkorporojnë një perspektivë gjinore në fakt përcaktimin dhe zbatimin e ligjit vendor) duke u udhëhequr nga praktikat më të mira.
- ⇒ Demonstrojnë kompetenca për zbatimin me ndjeshmëri gjinore të rregullave të provave në rastet e DHF-së.
- ⇒ Kuptojnë nevojën për të siguruar dënime proporcionale dhe bindëse në rastet që përfshijnë DHF-në, përshtatshmërinë e aplikimit të rrethanat lehtësuese dhe rënduese, përdorimin e duhur të ndërhyrjes së kryesit të dhunës dhe/ose programeve të trajtimit si pjesë e dënimit, si dhe adresimin e çështjes së kompensimit për viktimën.
- ⇒ Artikulojnë mënyra efektive për të reduktuar viktimizimin dytësor të viktimave të DHF-së.
- ⇒ Demonstrojnë njohuri dhe aftësi në trajtimin e rasteve sfiduese të DHF-së.

Përmbajtja

- Përmbledhje të dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe Udhëzimeve dhe Politikave përkatëse të Gjykatës Supreme dhe Prokurorisë, si dhe përkufizimet e reja në Ligjin për DhF, DhNG dhe DhBGJ.
- Dinamikën e dhunës në familje, kontrolli shtrëngues, cikli i fuqisë dhe kontrollit si dhe cikli i dhunës, stereotipet për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje;
- Trauma, dhuna në familje dhe faktorët e rrezikut, duke përfshirë dhunën pas ndarjes;
- Identifikimi i veprave penale të dhunës në familje, teknikave të intervistimit- çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet bërë, mbledhja dhe vlerësimi i provave, ushtrimi i gjykimit të prokurorisë dhe përzgjedhja e akuzave,
- Luftimi i përdorimit diskriminues të rregullave të provave, sigurimi i marrjes së vendimit të duhur për dënimin e kryerësve të dhunës,
- Përfshirja e programeve të trajtimit të kryerësit të dhunës si pjesë e dënimit, dhe trajtimin e shkeljeve të urdhrit të mbrojtjes.

Metodologjia

Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

Përfituesit

Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorët profesional, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë relevantë të cilët vijnë në kontakt të rregullt me rastet e dhunës në familje në sistemin e drejtësisë penale.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave

3. Kuptimi i Dhunës në Familje në të Drejtën Civile: Urdhrat Mbrojtës dhe Konsiderimet e të drejtës familjare

Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është ngritja e njohurive të kuadrit ligjor mbi kuptimin e dhunës në familje në të Drejtën Civile, me fokus në urdhrat mbrojtës dhe konsiderimet e të drejtës familjare. Trajnimi fokusohet në çështjet kritike të mbrojtjes, si dhe në çështjet e së drejtës familjare që ka një lidhje të afërt dhe të dukshme me DHNG-në. Ai do të shqyrtojë dispozitat përkatëse në Ligjin për DHF, DHNG dhe DHBGJ-në lidhur me procedurën gjyqësore për vendosjen lidhur me kërkesat për urdhër mbrojtje.

Objektivat

- ⇒ Ngritjen e kapaciteteve të kuadrit ligjor në kuptimin e drejtë të dhunës në familje në të drejtën civile;
- ⇒ Ngritja e njohurive në zbatimin efektiv të urdhrave mbrojtës;
- ⇒ Kuptojnë shkencën e traumës dhe efektet e traumës në të menduarit dhe sjelljen e viktimave dhe aftësinë e saj për të ndërvepruar me sistemet ligjore;
- ⇒ Identifikojnë mitet e zakonshme për viktimën dhe dhunuesin dhe vlerësojnë se si kjo ka ndikim në vendimmarrje nga gjyqtarët e gjykatave civile që merren me urdhrat e mbrojtjes dhe çështjet e së drejtës familjare;
- ⇒ Demonstrojnë njohuri për faktorët e rrezikut dhe aftësi për të ndërmarrë vlerësime të kërcënimeve dhe analiza të rrezikut në rastet e duhura;
- ⇒ Zbatojnë regjimin e mbrojtjes së ligjit civil në mënyrë të përshtatshme për të rritur sigurinë e viktimës;
- ⇒ Demonstrojnë njohuri dhe aftësi për integrimin e duhur të çështjeve dhe perspektivave të DHF-së në proceset gjyqësore familjare, si p.sh. përcaktimi i kujdestarisë dhe qasja e fëmijës dhe vlerësimi i interesit më të mirë të fëmijës;
- ⇒ Përdorin një qasje të informuar mbi gjininë dhe traumën në rastet e së drejtës familjare në lidhje me shqyrtimin, referimin dhe vlerësimin për DHNG dhe DHF;
- ⇒ Krijojnë mjedise të sigurta për viktimat në gjykatat civile.

Përmbajtja

- Dispozitat përkatëse në Ligjin Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (miratuar 2023) lidhur me rastet e DHF, DHNG dhe DHBGJ dhe procedurën gjyqësore për vendosjen e kërkesave për urdhër mbrojtje;
- Dispozitat përkatëse në Ligjin për Familjen Nr. 2004/32 (miratuar 2004) si dhe Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare (miratuar 2024) lidhur me kujdestarinë dhe

qasjen, mbrojtjen e fëmijëve, mbështetjen e fëmijëve dhe bashkëshortëve dhe ndarjen e pasurisë;

- Dinamika dhe llojet e dhunës në familje;
- Trauma.

Metodologjia

Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parimet dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

Përfituesit

Gjyqtarë të gjykatave civile.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- KE-Zyra në Prishtinë, projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit
- Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave
- Programi kombëtarë për të drejtat e njeriut 2021-2025

4. Veprat penale që përfshijnë Dhunën ndaj Grave: Ndjekja penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën

Qëllimi i përgjithshëm i këtij trajnimi është ngritja e kapaciteteve të kuadrit ligjor mbi ndjekjen penale efektive dhe nxjerrjen e vendimeve të informuara mbi traumën e viktimës, në përputhje me ligjet vendore, standardet ndërkombëtare dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026. Pjesëmarrësit do të angazhohen në praktikimin e teknikave për marrjen në pyetje të duhur të dëshmitarëve dhe viktimave të traumatizuara dhe pjesëmarrësit do të kenë mundësinë t'i praktikojnë ato nëpërmjet ushtrimeve të simuluar në një mjedis të kontrolluar.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive të faktorëve të rëndësishëm që luajnë rol në ndjekjen penale dhe gjykimet e informuara mbi traumën;
- ⇒ Njohin traumën dhe efektet e saj tek viktimat dhe dëshmitarët dhe kenë një kuptim të qartë se si dhuna dhe abuzimi mund të formësojnë reagimet e viktimave;
- ⇒ Përfshijnë mësimet e informuara për traumat për të reduktuar ritraumatizimin e mundshëm të përjetuar nga viktimat dhe dëshmitarët që marrin pjesë në sistemin e drejtësisë penale;
- ⇒ Artikulojnë dispozitat përkatëse të Kodit Penal që mbulojnë dhunën seksuale (përdhunimin dhe sulmin seksual), martesën e detyruar, ndjekjen dhe ngacmimin seksual;
- ⇒ Përdorin teknika për të siguruar qasjen e përqendruar të viktimave, të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe llogaridhënies së kryesit të dhunës në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të DHNG-së.
- ⇒ Zhvillojnë aftësitë për të vlerësuar saktë provat;
- ⇒ Artikulojnë mënyra efektive për të reduktuar viktimizimin dytësor të viktimave të DHNG-së.
- ⇒ Demonstrojnë njohuri dhe aftësi në trajtimin e rasteve sfiduese të DHNG-së.

Përmbajtja

- Mitet e zakonshme të dhunimit rreth çështjeve të besueshmërisë dhe pëlqimit;
- Neurobiologjia e traumës dhe se si trauma ndikon në sjelljen dhe kujtesën e viktimës, dhe implikimet për hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet;
- Qasjet e përgjithshme të intervistimit;
- Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave;
- Teknikat e ekzaminimit (të drejtpërdrejta, të kryqëzuara, të ridrejtuara);
- Strategjitë e pyetjeve për dëshmitarë të ndryshëm, trajtimin e dëshmitarëve të traumatizuar, qasjen e mbështetjes së dëshmitarëve dhe trajtimin e traumatizimit dytësor.

Metodologjia

Metodologjia e propozuar për këtë trajnim përfshinë shqyrtimin e dispozitave përkatëse ligjore dhe politike, parime dhe koncepte ndërkombëtare që lidhen me temën, rishikimi i hulumtimeve më të fundit mbi DhF, DhNG dhe DhBGJ, dhe punë zhvillimin e aftësive praktike përmes shembujve dhe rasteve të studimit.

Përfituesit

Prokurorë, Gjyqtarët, mbrojtësit e viktimave dhe profesionistë të tjerë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë dy (2) ditë.

AKTIVITETET TRAJNUESE KUNDËR DISKRIMINIMIT

Temë e identifikuar nga:

- Raporti i IKD-së dhe OJQ-ve tjera për të drejtat e njeriut
- Planë kombëtar për të drejtat e njeriut
- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën
- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026

1. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave në çështjet që rrjedhin nga diskriminimi

Trajnime për mbrojtjen gjyqësore të drejtave në çështjet që rrjedhin nga diskriminimi, ka për fokus trajtimin dhe adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e legjislacionit në fuqi kundër diskriminimit. Në aspektin procedural Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMnD), shprehë qëllimin e qartë të ligjvënësit për të siguruar mjete juridike efektive për çështjet e diskriminimit përmes të gjitha rrugëve të mundshme ligjore, përfshirë organet administrative, gjykatat, hetimet penale, prokuroritë, si dhe mekanizmat e ndërmjetësimit. Pretendimin e bazuar në bazat e diskriminimit të parapara me LMnD-në dhe sipas legjislacionit në fuqi, mund të paraqesë çdo person ose grup personash (kushtëzuar) të cilët pretendojnë se janë diskriminuar. LMnD shpreh qartazi tiparet e veçanta procedurale në rastet që trajtojnë diskriminimin si: afatin për paraqitjen e kërkesës nga pala që pretendon se është diskriminuar, urgjenca në trajtim të rasteve të diskriminimit, llogaridhënia, provat dhe metodat e ligjshme (përfshirë, por pa u kufizuar në të dhëna statistikore) që mund të dëshmojnë sjellje diskriminuese, barrën e provës e cila bie mbi të paditurin, llojet e masave, sanksioneve, dhe dëmshpërblimit, kjo edhe kur LMnD zbatohet në ndërthurje me ligjet përkatëse procedurale.

Çështjet për diskutim në këtë trajnim mund të jenë si në vijim: Çfarë nënkuptojmë me diskriminim? Cilat janë llojet dhe format e diskriminimit dhe si shprehen më së shpeshti në praktikë? Cili është fushëveprimi i dispozitave të Ligjit kundër Diskriminimit, përkatësisht në cilat raste dhe rrethana zbatohen të njëjtat? Cili është roli dhe përgjegjësia e Avokatit të Popullit sipas LMnD?, Kush mund të parashtrij padi në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet për diskriminim? Cili është afati ligjor për parashtrimin e padisë kundër diskriminimit në gjykatën kompetente? Kush e mban barrën e provës në kontestet kundër diskriminimit? Cilat janë llojet e vendimeve gjyqësore të cilat i merr gjykata kompetente sipas LMnD? Cilat janë mjetet juridike që mund të paraqiten në këto konteste? Cilat janë rastet e diskriminimit të cilat përbëjnë vepër penale? Si trajtohet çështja e diskriminimit nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-ës, etj.

Trajnime do të shërbej si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret pjesëmarrës lidhur me praktikën aktuale gjyqësore vendore dhe të GJEDNJ-ës. Trajnime do të zhvillohet sipas një agjende kornizë (të paracaktuar) për çështjet që përfshihen në kuadër të fushës kundër diskriminimit, me theks të veçantë për mbrojtjen gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit. Trajtimi i çështjeve do të bëhet duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë, por edhe ato nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-ës, e të cilat do të prezantohen përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuar duhet të përzgjidhen me kujdes në mënyrë që të konsumohen të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me fushën përkatëse, në këtë rast me fushën e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen gjyqësore në çështjet që rrjedhin nga Ligji kundër Diskriminimit. Lidhur me rastet e përzgjedhura trajnuesit duhet të bëjnë hulumtimet e duhura nga praktika gjyqësore në gjykatat ku punojnë dhe duhet të sigurohen se ato raste paraqesin në mënyrë objektive problematikën e çështjeve të trajtuara, por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen.

Objektivat

- ⇒ Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin;
- ⇒ Njohin kompleksitetet praktike në situatat ku ndër veprojnë ligjet në rastet e diskriminimit;
- ⇒ Analizojnë trajtimin e rasteve të diskriminimit në procedurën kontestimore, përfshirë këtu në trajtimin e kontesteve të punës me elemente diskriminimi;
- ⇒ Të përafrojnë qëndrimet në zbatimin unik të dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Përmbajtja

- Bazat dhe format e manifestimit të diskriminimit sipas LMnD;
- Mënyrat e zbatimit të aspekteve procedurale të LMnD, në ndërthurje me ligjet përkatëse procedurale;
- Llojet e masave, dëmshpërblimi dhe sanksionet që mund të shqiptohen ndaj atyre që diskriminojnë;
- Zbatimi i LMnD në ndërthurje me ligjet tjera;
- Praktika e GJEDNJ-së lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, do të zhvillohet diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Përfituesit

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatave Themelore si dhe prokurorë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR MENAXHMENTIN E
GJYKATAVE DHE PROKURORIVE***

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026

1. Menaxhimi i Gjykatës

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e gjykatave, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financave, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.

Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e gjykatave përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të gjykatave. Gjatë tërë procesit do të behet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë parimet standarde të menaxhimit të mirë;
- ⇒ Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
- ⇒ Zbatojnë parimet dhe metodologjinë e planifikimit.

Përmbajtja

- Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës;
- Përgjegjësitë menaxheriale;
- Burimet njerëzore dhe financat.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, gjithashtu duke shfrytëzuar edhe PowerPoint prezantime.

Përfituesit

Kryetarët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Plani i veprimit i strategjisë për sundimin e ligjit 2025-2026

2. Menaxhimi i Prokurorisë

Menaxhimi nënkupton organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim. Prandaj, njohuritë e përgjithshme mbi menaxhimin e prokurorisë, duke filluar nga menaxhmenti, udhëheqësit tjerë që merren me menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare, zyrës qendrore të menaxhimit të lëndëve, zyrës për mbështetje juridike, zyrës për logjistike dhe zyrën për informim, duhet të zhvillohen edhe më tutje nëpërmjet trajnimeve praktike.

Si menaxhohet suksesshëm një prokurori? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të prokurorisë?

Ky trajnim është hartuar për të ju përgjigjur pyetjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e prokurorisë përmes kombinimit të prezantimeve ku do të trajtohen strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të prokurorisë. Gjatë tërë procesit do të bëhet një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.

Objektivat

- ⇒ Zbatojnë parimet standarde të menaxhimit të mirë;
- ⇒ Identifikojnë kriteret për planifikimin e suksesshëm;
- ⇒ Zbatojnë parimet dhe metodologjinë e planifikimit.

Përmbajtja

- Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i prokurorisë;
- Përgjegjësitë menaxheriale;
- Burimet njerëzore dhe financat.

Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, punë në grupe, të përcjella me shembuj praktik, gjithashtu duke shfrytëzuar edhe prezantimin në PowerPoint.

Përfituesit

Kryeprokurorët, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve, Udhëheqësit rajonal të zyrës për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR BASHKËPUNËTOR
PROFESIONAL DHE ZYRTAR LIGJOR***

Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional

Penale Materiale

1. Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përjashtimit të Kundërligjshmërisë, pjesa e Posaqme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual
2. Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit, Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli: XXVI, XXIII, XXIX dhe XXX të KPK-së.

Penale Proceduarale

3. Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi
4. Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta

Drejtësi për fëmijë

5. Parimet e procedurës ndaj të miturve dhe Masat dhe dënimet ndaj të miturve

Civile Materiale

1. E drejta e trashëgimisë dhe e Drejta pronësore
2. E drejta e punës dhe E drejta e detyrimeve

Civile Proceduarale

3. Proceduara kontestimore
4. Proceduar përmbarimore dhe Ndërmjetësimi
5. E Drejta Familjare dhe Dhuna në familje

Temë e identifikuar nga:

- Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2026
- Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale

1. Viktimat në qendër-Udhëzimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale

Drejtësia Tranzicionale (DT) është një proces i domosdoshëm për ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe përballjen me trashëgiminë e shkeljeve të së kaluarës. Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale e Kosovës përfshin masa të përgjegjësisë ligjore, të drejtën për të vërtetën, të drejtën për riparim dhe garanci për mos-përsëritje, si pjesë e një procesi të gjerë transformues për të ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse.

Përmes aktiviteteve të parapara, Strategjia për Drejtësi Tranzicionale do ta përforcojë zotimin e institucioneve të Republikës së Kosovës në respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, ligjet nacionale dhe konventat ndërkombëtare. Qëllimet e Strategjisë janë: adresimi i krimeve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe krimeve tjera që janë e shkelje e së drejtës ndërkombëtare, për periudhën kohore 1989 – 2000.

Ky trajnim është i orientuar posaçërisht për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjorë, duke synuar t'i pajisë ata me njohuri dhe udhëzime praktike mbi zbatimin e Strategjisë, me theks të veçantë te qasja e ndjeshme ndaj viktimave.

Institucionet e drejtësisë, përfshirë rolin ndihmës të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjorë, janë kyçe në garantimin e trajtimit të drejtë dhe dinjitoz të viktimave. Ky trajnim ndihmon në:

- Kuptimin e përgjegjësisë që rrjedhin nga Strategjia.
- Zhvillimin e aftësive për trajtim empatik dhe ligjërësht të saktë të viktimave.
- Përmirësimin e praktikave për dokumentimin dhe ndjekjen penale të krimeve të së kaluarës.
- Cili është roli i bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjorë në zbatimin e Strategjisë për DT?
- Si mund të integrohet empatia dhe ndjeshmëria në mbështetje të viktimave pa cenuar objektivitetin profesional?
- Çfarë protokollesh dhe udhëzimesh ekzistojnë për t'i mbështetur viktimat gjatë procesit hetimor e gjyqësor?
- Si të dokumentohen krimet dhe deklaratat e viktimave në përputhje me parimet e DT-së?
- Cilat janë sfidat më të shpeshta në zbatim dhe si t'i adresojmë?
- Prezantime të shkurtra të drejtësisë tranzicionale dhe mbrojtjes së viktimave.
- Diskutime interaktive dhe punë në grupe për analiza rastesh konkrete.
- Role-play për ndërtimin e aftësive të komunikimit të ndjeshëm ndaj viktimave.
- Ushtrime praktike për zbatimin e udhëzimeve ligjore dhe etike.
- Reflektim mbi rastet nga praktika vendore dhe ndërkombëtare.

Objektivat

- ⇒ Njohin parimet bazë të drejtësisë tranzicionale dhe rëndësinë e vendosjes së viktimave në qendër;
- ⇒ Kuptojnë përmbajtjen e Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale dhe rolin e tyre në zbatim;
- ⇒ Identifikojnë praktika të mira në trajtimin ligjor dhe etik të viktimave;
- ⇒ Aplikojnë udhëzimet për dokumentimin, komunikimin dhe përkrahjen e viktimave në procese ligjore;
- ⇒ Reflektojnë mbi dilemat profesionale dhe etike dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete në kontekstin kosovar.

Përmbajtja

- Parimet themelore dhe qëllimi i Strategjisë;
- Nevojat e viktimave dhe ndikimi i përvojës së tyre në sistemin e drejtësisë;
- Udhëzime, përgjegjësi dhe praktika për përfshirjen aktive në zbatim;
- Komunikimi i ndjeshëm, dilemat etike dhe përkrahja psikologjike;
- Analizë rastesh, role-play dhe zbatim i njohurive në kontekst praktik.

Metodologjia

Trajnimi do të realizohet përmes prezantimeve interaktive, punës në grupe dhe diskutime, role-play dhe simulime të situatave reale, analizë rastesh dhe reflektime personale/profesionale materiale praktike dhe fletë-udhëzime për pjesëmarrësit.

Përfituesit

Bashkëpunëtorë profesional që mbështesin prokurorët/gjykatësit në hetim dhe përgatitje të rasteve. Zyrtar ligjor që punojnë në gjykata, prokurori, ose institucione të tjera të drejtësisë.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjasë një (1) ditë.

***AKTIVITETET TRAJNUESE PËR STAFIN
ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL***

Aktivitetet trajnuese për stafin administrativ gjyqësor

Temë e identifikuar nga:

- Komisioni për Trajnime në KGJK-ë

1. Trajnimet fillestare obligative

Secili i punësuar në administratën e sistemit gjyqësor duhet të përfundojë trajnimet fillestare të detyrueshme me qëllim të formimit, zhvillimit dhe avancimit profesional, siç parashihet me Ligjin nr. 08/l-197 për zyrtarët publik, si dhe me Rregulloren e Këshillit nr. 17/2023 për trajnimin e të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor. Në përputhje të plotë me legjislacionin primar dhe sekondar në këtë fushë, si dhe me vendimin e KGJK-së nr. 324/2024 ku janë miratuar modulet trajnuese fillestare për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor, ky grup i të punësuarve do të trajnohet në fushat relevante të përcaktuara me modulet trajnuese fillestare të detyrueshme. Trajnimet fillestare të detyrueshme planifikohen të mbahen si trajnime të brendshme, përkatësisht të zhvillohen nga trajnues të cilat mund të zhvillojnë trajnime përkatëse. Lidhur me grupin e synuar për të mbajtur trajnimin fillestar përveç të punësuarve të rinj të vitit 2025, do të përfshihen edhe të punësuarit të rekrutuar gjatë vitit 2024 dhe të cilët nuk kanë marr trajnim fillestar për pozitën e tyre të punës. Në përputhje me modulet trajnuese të miratuara nga KGJK, trajnimet fillestare përbëhen nga modulet trajnuese të përgjithshme, ku mund të trajnohen të gjithë të punësuarit pa dallim dhe modulet trajnuese specifike apo të veçanta, ku mund të trajnohen të punësuarit, varësisht nga pozita e punës ku janë të punësuar.

Trajnimi fillestar në pjesën e përgjithshme të moduleve

Modulet trajnuese fillestare të përgjithshme organizohen për të gjitha pozitën dhe kategoritë e të punësuarve që për herë të parë fillojnë punën në sistemin gjyqësor. Përmes modulit duhet që i punësuarit të pasurohet me njohuritë bazike mbi sistemin gjyqësor, njohuritë për vendin e punës, të drejtat, detyrimet, kodin e mirësjelljes së administratës gjyqësore dhe njohuritë me sistemet elektronike/platformat që përdorë sistemi gjyqësor.

Përmbajtja

- Moduli i Trajnimit Fillestar 1 (Kodi: MTF01) - Hyrje në sistemin gjyqësor; integriteti dhe sjelljet etike e të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor; të drejtat dhe detyrimet e të punësuarit;
- Moduli i Trajnimit Fillestar 2 (Kodi: MTF02) - Administrimi i punëve në zyrë; Njohuri për detyrat specifike të punës; Njohuri të përgjithshme në SMIL, në SQEP, në sistemet audio-video në gjykata; në sistemin E-pasuria dhe sisteme/platforma tjera që administrohen nga gjyqësori;
- Moduli i Trajnimit Fillestar 3 (Kodi: MTF03) - Siguria kibernetike; Komunikimi zyrtar elektronik dhe Cilësia e të dhënave.

Trajnimi fillestar në modulet trajnuese fillestare specifike

Moduli trajnues specifik organizohet për grup pozitash të cilat për nga natyra e punës dhe aktivitetet ditore në punë janë të ngjashme. Përmes modulit duhet që i punësuarit që përveç njohurive të trajnimit fillestar të përgjithshëm në kuadër të trajnimit fillestar të i ofrohet edhe

trajnim specifik në fushën e punës që do të punoj, përkatësisht ofrimi i trajnimit sipas përshkrimit të vendit të punës. Në trajnimin fillestar specifik të punësuarit duhet t'i ofrohet trajnim edhe mbi platformat elektronike përkatësisht sistemet elektronike të cilat përdoren nga departamenti apo njësia përkatëse në të cilën zyrtari përkatës është i punësuar.

Përmbajtja

- Moduli i Trajnimit Fillestar 4 (Kodi: MTF04)
 - Moduli i Trajnimit Fillestar 5 (Kodi: MTF05)
- Modulet specifike sipas përmbajtjes së modulit 4 dhe 5:
- Trajnim për zhvillimin e burimeve njerëzore;
 - Trajnim për komunikim me media dhe publikun;
 - Trajnim për çështjet ligjore;
 - Trajnim për fushën e financave;
 - Trajnim për fushën e evidencës penale;
 - Trajnim në fushën e prokurimit publik;
 - Trajnim në fushën e integriteteve evropiane;
 - Trajnim në fushën e teknologjisë informative;
 - Trajnim në fushën e përkthimeve;
 - Trajnim në fushën e logjistikës dhe infrastrukturës;
 - Trajnim në fushën e arkivës;
 - Trajnim në fushën e auditimit;
 - Trajnim në fushën e inspektimit gjyqësor.

Metodologjia

Trajnimet do të realizohen përmes shpjegimit teorik, diskutimeve interaktive duke u bazuar në shembuj konkret dhe shembuj praktik hipotetik si dhe punë në grupe me pjesëmarrësit.

Përfituesit

Ndarja e grupeve të pozitive është bërë në varësi të pozitive të cilat planifikohet të zhvillohen trajnimet përkatëse, të cilat përfshijnë të punësuarit e rinj në sistem dhe nuk kanë ndjekur trajnimin fillestar.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë 5 ditë për një grup (secili modul nga një ditë).

Temë e identifikuar nga:

- Komisioni për Trajnime në KGJK-ë

2. Trajnim për ekzekutime

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka miratuar planin e veprimit lidhur me ekzekutimin e lëndëve në gjykata, synim i këtij plani të veprimit është zhvillimi i një qasje praktike, me qëllim të adresimit të çështjes së zgjidhjes së lëndëve të ekzekutimit në një afat sa më të arsyeshëm kohor, ashtu siç përcaktohet me ligjin e zbatueshëm, si dhe evitimin e çfarëdo pengese procedurale që mund të paraqitet gjatë procedurës së ekzekutimit. Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit do të arrijnë të zgjerojnë njohuritë mbi trajtimin e lëndëve në fazën e ekzekutimeve, përfshirë afatet dhe gjithë procedurën.

Objektivat

- Avancimi i njohurive rreth administrimit të dosjes në procedurën e ekzekutimit, të lëndëve në lëmine civile/përmbare, komerciale, administrative, kundërvajtje si dhe procedimi i tyre përmes SMIL-it.

Përmbajtja

- Administrimi i dosjes në procedurën e ekzekutimit, procedura e ekzekutimit të lëndëve civile/përmbare, komerciale, administrative, kundërvajtje dhe procedimi i tyre përmes SMIL-it.

Metodologjia

Trajnimet do të realizohen përmes shpjegimit teorik, diskutimeve interaktive duke u bazuar në shembuj konkret dhe shembuj praktik hipotetik si dhe punë në grupe me pjesëmarrësit.

Përfitues

Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve/Gjykatë, Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika/Gjykata Themelore dhe Referentët.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë për një grup.

Temë e identifikuar nga:

- Komisioni për Trajnime në KGJK-ë

3. Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor

Sistemi gjyqësor përbënë njërën nga shtyllat kryesore të pushtetit shtetëror. Korniza ligjore aktuale përkitazi me gjyqësorin është e veçantë dhe ka themeluar trupa administruese, kjo kornizë ligjore po ashtu ka rregulluar edhe strukturën e gjykatave. Në kuadër të trupave të gjykatave funksionon administrata e cila ka status, strukturë organizative dhe kompetenca specifike. Kjo administratë përfshinë kategori dhe profile të ndryshme të stafit, në varësi të strukturës organizative dhe detyrave të punës.

Ky trajnim do të trajtojë aspekte të menaxhimit dhe udhëheqjes, planifikimit, vendimmarrjes dhe punës së përditshme, përfshirë por pa u kufizuar në efikasitetin dhe llogaridhënien e stafit administrativ.

Objektivat

- ⇒ Aplikojnë standardet adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- ⇒ Hartojnë plane për një punë të suksesshme dhe marrin vendime të arsyeshme;
- ⇒ Krijojnë ambient për një punë kreative, efikase dhe efektive;
- ⇒ Menaxhojnë situatat stresuese dhe punës me presion.

Përmbajtja

- Menaxhimi dhe udhëheqja;
- Planifikimi dhe vendimmarrja;
- Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës;
- Efikasiteti dhe llogaridhënia e stafit administrativ gjyqësor.

Metodologjia

Trajnimi do të realizohet duke përdorë metodologji të ndryshme përfshirë diskutime interaktive, punë në grupe dhe trajtimi i rasteve nga praktika.

Përfituesit

Administratorët dhe ndihmës administratorët e gjykatave.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Komisioni për Trajnime në KGJK-ë

4. Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore

Trajnimi është i fokusuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale për të dhënë vlerësimet e duhura më rastin e pranimit të kërkesave për fillimin e procedurave të ndryshëm ligjore, për të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale lidhur me përgatitjen e fazave pasuese të procedurës dhe për të hartuara aktet/vendimet e ndryshme varësisht nga përfundimi që është arritur si rezultat procedurës përkatëse. Në fokus të këtij trajnimi do të shtjellohen teknikat e hulumtimit ligjor, shkrim dhe arsyetimi ligjor si parakushte për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në zbatimin e kompetencave gjyqësore për trajtuar me kohë dhe në mënyrë profesionale çështjet e ngritura. Ky trajnim është hartuar për të dhënë udhëzimet teorike dhe praktike lidhur me shkathtësitë e hulumtimit ligjor, shkathtësitë e trajtimit të rasteve dhe shkathtësitë për shkrimin dhe arsyetimin ligjor, sipas metodave dhe standardeve që garantojnë objektivitet, siguri, cilësi dhe efikasitet.

Objektivat

- ⇒ Njohin parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- ⇒ Njohin metodat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor;
- ⇒ Hartojnë vendimet sipas metodës IRAC;
- ⇒ Njohin teknikat dhe burimet e hulumtimit ligjor.

Përmbajtja

- Teknikat e hulumtimit ligjor;
- Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë;
- Procesi dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor;
- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC;
- Struktura dhe përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit.

Përfituesit

Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore në SKGJK, të punësuarit në Departamentin Ligjor të PZAP-së, Zyrtarët Ligjor në Departamentin për Çështje Ligjore në SKGJK, Koordinatorin i Panelit për Lirim me Kusht në DÇL, Bashkëpunëtori Profesional, Zyrtari ligjor/Sekretari Juridik, Inspektorët Gjyqësor, Zyrtari Ekzekutiv në PZAP.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë për një grup.

Aktivitetet trajnuese për stafin administrativ prokurorial

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

1. Trajnimi hyrës për stafin e sapo emëruar administrativ prokurorial

Trajnimet hyrëse kanë për qëllim që t'i ofrojnë mundësi çdo punonjësi të marrë pjesë në të gjitha trajnimet relevante për kryerjen e detyrave administrative në prokuroritë. Qëllimi kryesor i trajnimit hyrës është të sigurojë trajnimin për të gjithë pjesëtarët e sapo emëruar të administratës, duke u fokusuar në fushat më të rëndësishme për ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të tyre profesionale si anëtarë të administratës prokuroriale.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë lidhur me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor;
- ⇒ Njohin parimet dhe detyrat kryesore në kryerjen e detyrave administrative në kuadër të sistemit;
- ⇒ Nxitja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga pjesëtarët e administratës.

Përmbajtja

Moduli 1:

- Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale dhe Qasja në informacion, konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit të klasifikuar, si dhe mbrojtja e të dhënave (aktet përkatëse ligjore, aspektet praktike);
- Hyrje në planifikim, menaxhim, menaxhimin e kohës dhe stresit, Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm, puna në ekip, Koncepti i "Shërbimeve të Orientuara në Cilësi " dhe në shërbim të qytetarëve;
- Hyrje në sistemin prokurorial të Kosovës, parimet dhe rregulloret Kushtetuese (Kapitulli 7), legjislacioni dhe institucionet relevante dhe Hyrje në administratën prokuroriale, legjislacioni përkatës, funksionet dhe përgjegjësitë.

Moduli 2:

- Hyrje në punën e prokurorive; struktura, organogramet; kategoritë e stafit administrativ dhe të drejtat e detyrimit e tyre, Specifikat e punës në çështjet civile, çështjet penale dhe çështjet administrative; llojet e rasteve, aktet gjyqësore dhe seancat gjyqësore;
- Rregullat dhe rregulloret kryesore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve (lëndëve);
- Procedurat gjyqësore dhe detyrat përkatëse të personelit administrativ, dërgimi i thirrjeve, afatet dhe Prezantimi i llojeve të regjistrave dhe dokumenteve të mirëmbajtura nga stafi administrativ; rregullat dhe mostrat.

Metodologjia

Trajnimet do të realizohen përmes prezantimeve, diskutimit interaktive si dhe ushtrime praktike.

Përfituesit

Pjesëtarët e sapo-emëruar të administratës së prokurorive dhe stafi me më pak se 6 muaj përvojë në pozitën përkatëse.

Kohëzgjatja

Trajnimi nga Modul 1, do të zgjatë tri (3) ditë

Trajnimi nga Modul 2, do të zgjatë tri (3) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

2. Organizimi, struktura dhe kompetencat e sistemit prokurorial të Kosovës

Sistemi prokurorial është kategori kushtetuese dhe ligjore. Në kuadër të sistemit prokurorial hyjnë trupat administruese të tyre si: Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit. Mandati, struktura dhe kompetencat e këshillit dhe prokurorive janë të përcaktuara me ligje të veçanta. Qëllimi kryesor i këtij trajnimit është që përmes temave konkrete të njoftojë stafin administrativ të prokurorive me kompetencat, strukturën organizative, mandatin dhe kornizën ligjore të sistemit prokurorial.

Në kuadër të trajnimit do të trajtohen edhe zhvillimet aktuale rreth punës së këshillit dhe vendimet më të rëndësishme të tyre, aktet normative kryesore dhe politikat e ndryshme për administrimin e sistemit. Gjithashtu sfidat në ushtrimin e mandatit të këshillit, dhe prokurorit të shtetit do të jenë pjesë e diskutimeve në trajnimet e këtij moduli.

Objektivat

⇒ Njohin strukturën, organizimin dhe kompetencat e sistemit gjyqësor / prokurorial;

⇒ Zbatojnë aktet normative dhe politikat e Këshillit.

Përmbajtja

- Korniza ligjore e sistemit prokurorial;
- Organizimi i sistemit prokurorial;
- Kompetencat e sistemit prokurorial.

Metodologjia

Gjatë mbajtjes së trajnimeve do të përdoret metodologjia si në vijim: prezantim i shkurtër i temave përmes teknikave moderne trajnuese, diskutime interaktive me pjesëmarrës.

Përfituesit

Stafin administrativ prokurorial.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

3. Menaxhimi i proceseve të punës në administratën e sistemit prokurorial

Sistemi prokurorial përbënë njërën nga shtyllat kryesore të pushtetit shtetëror. Korniza ligjore aktuale është e veçantë dhe ka themeluar trupa administruese, kjo kornizë ligjore po ashtu ka rregulluar edhe strukturën e prokurorive. Në kuadër të trupave të prokurorive funksionon administrata e cila ka status, strukturë organizative dhe kompetenca specifike. Kjo administratë përfshinë kategori dhe profile të ndryshme të stafit, në varësi të strukturës organizative dhe detyrave të punës. Ky trajnim do të trajtojë aspekte të menaxhimit dhe udhëheqjes, planifikimit, vendimmarrjes dhe punës së përditshme, përfshirë por pa u kufizuar në efikasitetin dhe llogaridhënien e stafit administrativ.

Objektivat

- ⇒ Aplikojnë standardet adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes;
- ⇒ Hartojnë plane për një punë të suksesshme dhe marrin vendime të arsyeshme;
- ⇒ Krijojnë ambient për një punë kreative, efikase dhe efektive;
- ⇒ Menaxhojnë situatat stresuese dhe punës me presion.

Përmbajtja

- Menaxhimi dhe udhëheqja;
- Planifikimi dhe vendimmarrja;
- Proceset e brendshme dhe të jashtme të punës;
- Efikasiteti dhe llogaridhënia e stafit administrativ prokurorial.

Metodologjia

Trajnimi do të realizohet duke përdorë metodologji të ndryshme përfshirë diskutime interaktive, pune në grupe dhe trajtimi i rasteve nga praktika.

Përfituesit

Administratorët e prokurorive.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

4. Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore

Trajnimi shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore ka për qëllim të ndihmoj stafin administrativ prokurorial në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale për të dhënë vlerësimet e duhura më rastin e pranimit të kërkesave për fillimin e procedurave të ndryshëm ligjore, për të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale lidhur me përgatitjen e fazave pasuese të procedurës dhe për të hartuara aktet/vendimet e ndryshme varësisht nga përfundimi që është arritur si rezultat procedurës përkatëse. Me fokus të veçantë në kuadër të këtij trajnimi do të shtjellohen teknikat e hulumtimit ligjor, shkrim dhe arsyetimi ligjor si parakushte për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në zbatimin e kompetencave gjyqësore dhe prokuroriale për trajtuar me kohë dhe në mënyrë profesionale çështjet e ngritura. Ky trajnim është hartuar për të dhënë udhëzimet teorike dhe praktike lidhur me shkathtësitë e hulumtimit ligjor, shkathtësitë e trajtimit të rasteve dhe shkathtësitë për shkrimin dhe arsyetimin ligjor, sipas metodave dhe standardeve që garantojnë objektivitet, siguri, cilësi dhe efikasitet.

Objektivat

- ⇒ Avancimi i njohurive rreth teknikave të hulumtimit ligjor;
- ⇒ Zbatojnë kompetencat për shqyrtimin e rasteve dhe përgatitjen e fazave pasuese të procedurës;
- ⇒ Të njohin procesin dhe parimet e shkrimit të mirë ligjor;
- ⇒ Zbatojnë në mënyrë efektive metodën IRAC;
- ⇒ Të hartojnë në mënyrë të pavarur vendimet gjyqësore dhe aktet akuzuese.

Përmbajtja

- Teknikat e hulumtimit ligjor;
- Shqyrtimi paraprak i rasteve dhe ndërmarrja e veprimeve për përgatitjen e fazave pasuese në procedurë;
- Procesi dhe parimet e të shkruarit mirë ligjor;
- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor përmes metodës IRAC;
- Struktura dhe përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit.

Metodologjia

Trajnimi do të zhvillohet në një ambient interaktiv bashkëbisedimi dhe diskutimi me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke dhënë kontributin e tyre.

Përfituesit

Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarë ligjor.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK\

5. Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun

Stafi administrativ prokurorial janë të përfshirë vazhdimisht në forma të ndryshme të komunikimit. Natyrisht, shkathtësitë e komunikimit janë të rëndësishme në të gjitha mjediset e punës. Megjithatë, nuk ka dyshim se komunikimi efektiv është absolutisht jetik për funksionimin e suksesshëm të prokurorive. Konteksti i komunikimit ndryshon, por duket se hyn në dy kategori themelore, komunikimi i brendshëm dhe komunikimi i jashtëm.

Objektivat

⇒ Avancimi i komunikimit brenda administratës dhe fokusimi në aspekte e rregulla të ndryshme, dhe në praktikatat e mira për komunikim më të mirë .

Përmbajtja

- Komunikimi dhe politikat standardet te aplikueshme;
- Komunikimi i brendshëm: rrjedha e informacionit, hierarkia, puna ekipore dhe shkëmbimi i informacionit, konfidencialiteti i të dhënave dhe informatave, dhe sjellja dhe etika profesionale;
- Delegimi i detyrave, monitorimit dhe mbikëqyrjes;
- Planifikimi, vendosja e prioriteteve dhe caktimi i detyrave;
- Raportimi, përdorimi i TI-së në komunikim;
- Praktikatat, format dhe procedurat standarde uniforme.

Metodologjia

Prezantime, raste studimore, simulime, ushtrime praktike.

Përfituesit

Administratorët e prokurorive dhe zëvendësit e tyre, zyrtarët për marrëdhënie me publikun, stafi i zyrës së pranimit dhe të gjitha kategoritë e tjera të stafit administrativ që ka ndërveprim me qytetarë, palë dhe institucione të ndryshme.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

6. Integriteti dhe Kodi Etik

Qëllimi i administratës së shtetit prokurorial në Kosovë, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paanësia, pavarësia, konfidencialiteti, shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia.

Trajnimi është hartuar në atë formë që përmes shpjegimeve të pjesshme teorike dhe diskutimeve interaktive, të trajtojë rregullat e përcaktuara të sjelljes etike dhe profesionale, duke ofruar bazën ligjore dhe shembuj praktik për pjesëmarrësit.

Objektivat

- ⇒ Dallojnë sjelljet e etike brenda dhe jashtë zyrës;
- ⇒ Zbatojnë në mënyrë të drejtë Kodin e Etikës dhe parimet e tij;
- ⇒ Identifikojnë rastet kur kemi të bëjmë me shkelje etike.

Përmbajtja

- Parimet dhe normat e sjelljes etike;
- Sjellja brenda dhe jashtë zyrës dhe
- Ndërgjegjësimi social dhe përgjegjësia.

Metodologjia

Gjatë këtij trajnimi do të aplikohet metodologjia e kombinuar me shpjegime teorike, përmes PowerPoint dhe diskutime interaktive.

Përfituesit

Stafi administrativ prokurorial.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

7. Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin prokurorial

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është që nëpërmjet prezantimit të koncepteve dhe parimeve të menaxhimit të rrjedhës së rasteve, pjesëmarrësit të njoftohen dhe të përgatiten me shkathtësi për identifikimin, fillimisht të problemeve të menaxhimit të rasteve dhe më pas për të zhvilluar dhe zbatuar një planë për menaxhimin e rrjedhjes së lëndës.

Objektivat

- ⇒ Avancojnë njohuritë për menaxhimin e rasteve;
- ⇒ Respektojnë parimet e menaxhimit të rasteve;
- ⇒ Demonstrojnë teknikat e menaxhimit të rasteve;
- ⇒ Avancojnë njohuritë lidhur me parimet dhe metodologjinë e CEPEJ.

Përmbajtja

Regjistrat e prokurorive;
Organizimi i rrjedhës së punës dhe zhvillimit të lëndës;
Mbledhja e të dhënave statistikore dhe raportimi;
Menaxhimi efikas i lendeve bazuar në metodologjinë CEPEJ;
Digjitalizimi i procesit të punës në prokurori.

Metodologjia

Realizimit të trajnimit do ti kontribuojnë metodat e prezantimit përmes PowerPoint, punës në grupe dhe përdorimi i rasteve praktike.

Përfituesit

Administratorët, ndihmës administrator, shefi i ZML-së, referentët, zyrtarët e statistikave, zyrtarët ligjor, sekretarët juridike, zyrtarët e informimit, njësi për vlerësimin e performances së prokurorëve.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

Temë e identifikuar nga:

- Dokument i politikave të trajnimit dhe plani i nevojave për trajnimin e prokurorëve të shtetit dhe stafit administrativ për vitin 2025 – KPK

8. Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve

Qëllimi i trajnimit është trajtimi i çështjeve të ndërlidhura me mbrojtjen e sinjalizuesve, përforcimi i njohurive në raport me të drejtat e sinjalizuesve si dhe krijimi i njohurive të reja në raport me zhvillimet e fundit në fushën e sinjalizimit në Kosovë, rajon dhe në Evropë. Përmes trajnimit mëtohet të trajnohen stafi administrativ si dhe zyrtarët përgjegjës për sinjalizimin në gjithë regjionet e vendit.

Objektivat

- ⇒ Njohin standardet ndërkombëtare e vendore për të drejtat e njeriut që lidhen me punën e sistemit prokurorial;
- ⇒ Zbatojnë praktikatat më të mira në fushën e lirisë së shprehjes dhe fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve.

Përmbajtja

- Standardet ndërkombëtare e vendore për të drejtat e njeriut që lidhen me punën e sistemit prokurorial;
- Parimet, institucionet, proceset dhe praktikatat në fushën e lirisë së shprehjes në përgjithësi, dhe në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve në veçanti.

Metodologjia

Metoda specifike të trajnimeve për profesionistë ligjorë do të aplikohen për këtë trajnim. Do të përdoren ushtrime për shkrirjen e akullit, prezantime në PPT, raste studimore, ushtrime në grup, debate të nxitura nga trajnuesit e specializuar në fushën e lirisë së shprehjes, provime vlerësimi.

Përfituesit

Zyrtarët administrativ të prokurorive dhe zyrtarët për sinjalizimin në prokurori.

Kohëzgjatja

Trajnimi do të zgjatë një (1) ditë.

PLATFORMA E MËSIMIT NË DISTANCË / E - MËSIMI

E-mësimi

Mësimi në distancë ose e-mësimi është të mësuarit interaktiv nga distanca duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike online, jashtë një sallë tradicionale të trajnimit. Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar platformën E mësimi e cila përmbushë kërkesat për trajnime. Përparësitë e E-mësimit janë kursimi i kohës dhe buxhetit të Akademisë, ulja e shpenzimeve që krijojnë pjesëmarrësit. Mësimi në distancë realizohet përmes kurseve trajnues të cilat përmbajnë module trajnues, incizimeve audio dhe videove.

Platforma e mësimit në distancë do të jetë në dispozicion të përfituesve të Akademisë së Drejtësisë me synim rritjen e njohurive dhe zhvillimin profesional të të gjitha kategorive përfituese të Akademisë, si dhe rritjen e efikasitetit të trajnimeve.

Përmbajtja

Në kuadër të platformës E-mësimi, gjatë vitit 2026 synohet të zhvillohen kurset trajnues si:

- Etika dhe sjellja profesionale për gjyqtarë
- Etika dhe sjellja profesionale për prokurorë
- Dënimet që shqiptohen ndaj të miturit

PLATFORMA E KURSEVE HELP

Platforma për edukimin e profesionistëve ligjor për liritë dhe të drejtat e njeriut - HELP kurset online

Platforma HELP e Këshillit të Evropës është një platformë e mësimit në distancë e zhvilluar nga Sekretariati i Këshillit të Evropës me qëllim të lehtësimit dhe ofrimit të trajnimeve sa më profesionale për profesionistët ligjorë. Kurset online HELP janë interaktive dhe vizuale. Ato mbulojnë tema të ndryshme që lidhen me të drejtat e njeriut, duke reflektuar fusha të ndryshme të punës së Këshillit të Evropës.

Objektivi kryesor i Programit të Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionistët Ligjor (HELP) është të rrisë kapacitetin e gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve, në të 46 vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë, për të zbatuar standardet evropiane të të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme. Kjo bëhet përmes kurseve online HELP që mbulojnë një sërë temash të të drejtave të njeriut.

Nr.	<i>Kurset e zhvilluara në gjuhën shqipe në platformen HELP</i>
1.	Qasja në drejtësi për gratë
2.	Kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të paraqitura në GJEDNJ
3.	Masat alternative ndaj ndalimit
4.	Alternativë për ndalimin e imigracionit
5.	Antidiskriminimi
6.	Azili dhe të Drejtat e Njeriut
7.	Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut
8.	Drejtësi miqësore për fëmijët
9.	Mbrojtja e të dhënave dhe të drejtat e privatësisë
10.	Etika për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët
11.	Liria e shprehjes
12.	Krimet e urrejtjes
13.	Gjuha e urrejtjes
14.	Hyrje në KEDNJ dhe GJEDNJ
15.	Arsyetimi Gjyqësor dhe të Drejtat e Njeriut
16.	Masat mbrojtëse procedurale në procedurën penale dhe të drejtat e viktimave
17.	Ndalimi i keqtrajtimit
18.	Të drejtat pronësore
19.	Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve
20.	Parandalimi i radikalizimit
21.	Fëmijët Refugjatë dhe Emigrantë
22.	Dhuna ndaj Grave
23.	Efikasiteti dhe kualiteti i punës me CEPEJ
24.	Të drejtat e njeriut dhe mjedisi
25.	E drejta për liri dhe siguri/ Neni 5 i KEDNJ

Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. Murat Mehmeti 1-3, Prishtine

Tel:+383 38 200 68 000